

Gago Kollumbi
(Yeka)

BIBLIOTEKA
SHTETIT

314-9

K 8

Bij të
maleve

814-5

12 85

GAQO KOLLUMBI (YRKA)

BIJ TË MALEVE

(Kushtuar Heroit të Popullit Teki Kolaneci)



SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

DY FJALË LEXUESIT

Sa larg kanë mbetur ato vite! Sa kohë ka kaluar që atëhere! Mëgjithatë kujtimet e ditëve të luftës, që ruhen thellë në kujtesën tonë, të mallëngjëjnë sa s'thuhet.

Kanë kaluar tri dekada që atëherë kur, nën udhëheqjen e Partisë, gjëmuan për vite malet shqiptare dhe sot gjithçka ka ndryshuar e ndryshon me ditë në atdheun tonë. Por neve na i ka ënda të kujtojmë rrugën që ka kaluar vendi ynë përpara syve tanë. Kjo ia vlen, sepse nuk duhet të shikojmë vetëm përpara, por edhe prapa. Përndryshe, me çfarë do t'i krahasojmë rezultatet e arritura?

Janë të freskëta në kujtesë ngjarjet e paharruara dhe emocionuese të atyre ditëve të vështira të Luftës Nacionalçlirimtare. Ne nuk do t'i harrojmë kurrë vendet nga kemi kaluar, ku secili prej nesh ka lënë një copë të vetëvetes, ku toka është ende e ngrohtë nga gjaku dhe djersa jonë. Ngado që hedhim sytë, ne shikojmë male të njohura, male të lidhura sup më sup, të cilat i kemi shkelur pëllëmbë për pëllëmbë dhe ku kanë rënë shokët tanë.

Atëhere na dukej se më e vështira ishte që të dilnim fitues nga lufta dhe se të tjerat do të qenë më të lehta. Por më e vështira erdhi pastaj. Eh,

ç'punë e madhe na u desh të merrnim përsipër!
Kudo dukeshin gjurmët e luftës që sapo kishte
mbaruar. Shtëpi të djegura, ura të prishura, ara që
ende nxirrnin tym dhe ne ishim fare pa përvojë.
Por ne nisëm rindërtimin e vendit dhe pastaj ndër-
timin duke mbajtur armët gati, se armiqtë asnjë-
herë s'na u ndanë. Dhe ne qëndruam e qëndrojmë
vigjilentë dhe të gatshëm.

Të gjithë ata që nuk e kishin ndërgjegjen e
qetë, dridheshin nga frika. Liria e popullit u kallte
tmerrin kundërshtarëve, sabotatorëve, armiqve. Dhe
kishin të drejtë të dridheshin, sepse, shpejt a vonë,
do t'i zinin ashtu siç i zumë për zverku. Ata hel-
monin ajrin dhe miqtë e tyre çirreshin nga jashtë
se pështjellimi, shkatërrimi i ekonomisë, mungesa
e specialistëve e të tjera pallavra si këto do të
sillnin detyrimisht pakënaqësinë dhe shthurjen poli-
tike. Por populli iu përvesh punës bashkë me parti-
zanët që u kthyen nga malet. Revolucioni ynë socia-
list, që ishte vepër e këtyre njerëzve me Partinë në
krye, përmbysi malet. Uniteti moralo-politik, marrë-
dhëniet e shëndosha, mendimi dhe veprimi i për-
bashkët: Popull-Parti-Enver, flasin me plot gojën
për këtë të vërtetë.

Tani, kur shikon prapa dhe kur mendon, të duket
si çudi që ne t'i kemi bërë të gjitha këto. Ngado
shikojmë atdheun e përtëritur. Kështu koha ikën
përpara dhe vitet na sjellin fitore të mëdha. Shqipëria
jonë në këto vite të Partisë u bë një vend me pres-
tigj dhe autoritet të lartë që na e kanë zili e gjithë
bota.

A u t o r i

SHKËNDIJAT E PARA

Në orët e vona të një nate marsi të vitit 1942, katër njerëz ecnin duke shkarë rrëzave nëpër rrugët e errëta të Korçës, që kishin rënë në gjumë dhe në një heshtje të thellë. Kohë pas kohe, ata kthenin kokën prapa dhe vështronin se mos i ndiqte njeri. Dhe ku kështu? Në qytetin e tyre, ku kishin ndarë vuajtjet dhe gëzimet, ku gjer dje çapisnin me trupin drejt. . . Mirëpo atë natë u duhej të hidhnin këmbët me kujdes, të fshihnin trupin që të mos binin në sy, të flisnin me zë të ulët apo të heshtnin atëherë kur zemra thërriste e vinte kujën për ditët e mynxyrës së zezë që kishte pllakosur vendin.

Rreth e përçark ishte qetësi e plotë. Ata largoheshin duke lënë prapa qytetin që i përcillte bijtë e tij besnikë me përkëdheljen e ngrohtë e të heshtur. Ecnin në heshtje drejt fushës së Korçës. Pëshpërisnin vetëm kur kishin diçka për t'i thënë njëri-tjetrit. Sa më shumë që i largoheshin Rrëzës së Korçës, aq më shumë afroheshin drejt shkëmbinjve krenarë të maleve të mbuluara anembanë me borë.

Po gdhihej. Qielli i errët po zbardhonte. Ata vazhdonin të ecnin dhe, para se të arrinin në kodrën e Kolanecit, lanë rrugën më të majtë e kaluan në një monopat. Befas dëgjuan një zhurmë dhe u ndalën. Mos u koll kush?

— Jam unë, Tekiu, — u dëgjua një zë i ndrydhur por i sigurt. U doli përpara, me maliher në dorë e me gjerdanin e fishekëve ngjeshur për mesi, një djalë i ri, që i kishte kaluar të njëzet e pesë vjetët, me shtat mesatar, me trup të fortë, të zhdërvjellët e të hedhur, me krahëror e shpatulla të gjera, që të jepte përshtypjen e një njeriu plot gjallëri. Ky bir fshatari quhej Teki Kolaneci.

— Po ju prisja, — u tha dhe i përqafoi me radhë.

Cilët qenë ata të tjerët? Ishin bij të klasës punëtore, nga ilegalët e parë të qarkut të Korçës, komunistë që i dërgonte Partia në gjirin e fshatarëve për të çuar zërin e saj, kushtrimin e luftës për liri...

Dhe agimi i asaj dite i gjeti këta djem të rinj — mësuesin, bojaxhinë, shoferin, rrobaqepësin dhe fshatarin — në atë sheshin e vogël rrethuar nga drurët e heshtur të pyllit, duke biseduar se nga duhej ta fillonin punën që u kishte ngarkuar Partia.

Atë kohë, lidhjet e Partisë me fshatin ishin të dobëta. Komunistët kishin shkuar vetëm në fshatrat rreth qytetit për shpërndarjen e shtypit ilegal, por nuk ishin futur në krahinat e thella të qarkut, nuk kishin trokitur në portën e fshatarit, për të qarë hallet e jetës, për t'i zgjuar besimin në vetëvete, ndjenjën e bashkimit, si dhe për t'i treguar rrugën e shpëtimit. Kjo gjendje i shqetësonte këta djem, të cilët bisedonin për ngritjen e bazave të luftës, për njohjen e vendit, për njerëzit, si do të vepronin me fshatarët, për ta mbajtur gjithmonë të gjallë ndjenjën e urrejtjes për armiqtë si dhe besimin e sigurt në fitoren e Luftës Nacionalçlirimtare.

Gjatë gjithë bisedës, Tekiu dëgjonte me vëmendje të përqëndruar, pa pohuar asgjë dhe pa shfaqur

asnjë mendim. Fytyra e tij kishte një pamje të qetë. Sytë ngjyrë hiri kishin një shprehje urtësie shumë të thellë, një shprehje nga ato që kanë njerëzit që dijnë të bluajnë mirë në mendje fjalët që dëgjojnë. Ishte një nga ata njerëz te të cilët që në vështrimin e parë ndjen sinqeritetin, thjeshtësinë e pastërtinë e shpirtit. Më në fund foli dhe ai për kushtet e vështira në të cilat ndodheshin dhe e mbylli bisedën me këto fjalë:

— Unë kam ca miq dhe të njohur që u shkon fjala në këto anë. Njoh edhe ca të rinj me ide përparimtare dhe disa të tjerë që kanë dezertuar nga ushtria ose që s'kanë pranuar të shkojnë ushtarë. Ja, me këta duhet filluar puna... Pastaj, shohim e bëjmë.

Mësuesi, një djalë zeshkan, me trup mesatar, me sy të qeshur dhe me pamje që të ndillte simpati, tha plot gaz:

— Shohim e bëjmë! Bukur e the, o Teki! Gjithmonë është më lehtë të punosh kur e ke parë çdo gjë me sytë e tu, kur e ke peshuar vetë mirë çdo gjë dhe nuk ke dëgjuar vetëm fjalë që i merr era.

Pllakosi heshtja. Por atë e prishi shoferi me flokë kokoridhe, të ashpër e të dendur, me ca dhëmbë të bardhë e të shëndoshë, i cili ia priti me një zë të fortë:

— Jam në një mendje me Tekiun, veçse duhet të zgjedhim ata më të sigurtit, më të vendosurit dhe më të aftët për luftë.

Rrobaqepësi, më i riu nga të gjithë, me një trup të hollë e të hedhur, shtoi:

— Dhe secilit t'i flasim sipas gjuhës së tij. T'i themi hapur, sy ndër sy, të vërtetën e rrezikun, sepse vetëm kështu do të kuptojnë shumë gjëra...

Bojaxhiu, ky punëtor me flokë të zez, që i binin mbi sytë e tij të thellë e të menduar dhe që i kursente fjalët, sidomos kur ishte çështja për gjëra me rëndësi, u ngrit nga vendi dhe foli me një zë të qetë e të matur që të ngjallte forcë e besim:

— Nuk e di se kur do të na vijë radha që të luftojmë. Por tani për tani jemi të detyruar të punojmë me fjalë dhe me mend në kokë. — Dhe, si u kollit, shtoi mengadalë: — Sot ne jemi të detyruar të fshihemi, por nësër mjerë gjahu fashist që do të na bjerë në dorë...

*

* *

Një erë e fortë i zgjoi shokët e njësitit partizan nga gjumi i thellë që i kishte zënë. Ata natën ecnin, ndërsa ditën flinin, diskutonin dhe bënë stërvitje me pushkë.

— Teki, nuk fjete? — pyeti mësuesi.

— Njëri nga ne duhej të bënte roje; — iu përgjegj Tekiu duke qeshur.

Në kohën kur doli të bënte roje një nga shokët, u dëgjua një zhurmë e madhe makinash nga fusha kënetë e moçalishte e Maliqit, ku ziente zëri i bretkocave. Mbi rrugë ishte një komunë, një postë-karabinerie dhe një bunker në qoshen e urës ku qe strukur armiku. Kjo nuk i shqetësonte shokët që qëndronin në sheshin e vogël të korijes «Hija e Korbit», nga ku dukeshin mirë rrugët e fshatit Kolanec. Në qoftë se vinin së andejmi karabinierë e milicë, ata i shikonin së largu dhe kishin kohë të merrnin masa, por s'kishte përse të shqetësoheshin kur vinte një njeri i vetëm dhe madje pa armë, ashtu si një fsha-

tar nga Vloçishti, i cili u trondit pa masë kur e vuri roja përpara.

— Ç'të fryu era këtej, o Adil? — e pyeti Tekiu dhe e ftoi të ulej. Ai, me të njohur Tekiun, u qetësua, u ul pranë tij, dhe i tha:

— I rashë më të prerë, o Teki, por lemë sa ta marr pak veten.

— U trembe?!

— Oj të trembur...

— Po pse?

— Ka dhe kusarë tani, mor vëlla!

— Nga ne a ke frikë?

— Pse të kem? Ju nuk jeni vjedhës...

— Jo, s'jemi të tillë... Po nga komunistët a ke frikë?

Para se t'i jepte përgjegje pyetjes së Tekiut, ai i hodhi sytë rreth e rrotull, i vajti më pranë dhe i pëshpëriti në vesh:

— Edhe nga komunistët kam frikë, o Teki!

— Pse? — e pyeti Tekiu. Adili ia nguli sytë një çast pa folur, pastaj me bindjen e patundur të fshatarit shtoi: — Kam frikë edhe nga ata, se kam dëgjuar se janë njerëz pa familje, gratë e tyre janë mall i të gjithëve. Larg prej tyre! Këtë ta dish nga unë. Ndërsa bolshevikët i dua dhe prej tyre s'dua t'ia di fare. Ata janë patriotë. Kaq di unë...

Teki u qeshi me zë, ua tregoi shokëve ato që i kishte thënë fshatari dhe të gjithë zunë vend përreth tij.

— Të kanë thënë, — e pyeti mësuesi, — se komunistët i detyrojnë njerëzit të jetojnë të gjithë së bashku, të hanë dhe të pinë në të njëjtin kazan dhe se i janë shitur të huajit e të tjera si këto?

— Edhe këto m'i ka zënë veshi, — u përgjigj

pa të keq fshatari dhe vazhdoi: — Unë nuk kuptoj aq shumë, nuk merrem me pulitikë, veçse ato që tregojnë për ata, duhet të jenë të vërteta! S'di si të them! I kam dëgjuar nga mjaft njerëz me mend në kokë dhe unë s'jam nga ata që i marrin punët shkel e shko.

Djemtë filluan t'i flisnin Adilit për Partinë Komuniste Shqiptare, për Bashkimin Sovjetik, për Ushtrinë e Kuqe, për Stalinin dhe për shumë gjëra të tjera. Mirëpo, në këtë bisedë të gjatë ai më shumë s'besonte. Megjithatë, në fund dyshonte edhe në të tija dhe nuk është e pakët që njeriu të lëkundet në pikëpamjet e veta të ngulitura e të rrënjosura thellë nga propaganda borgjeze. Pinte duhan me veshtrim të ngulitur në një vend dhe dëgjonte i heshtur e i habitur. Më në fund ua qepi sytë dhe donte t'i kuptonte mirë këta njerëz që i thoshin se kishin dalë malit për të luftuar fashizmin e ngulnin këmbë se duhej të rroknin armët të gjithë ata që e donin atdheun, që e urrenin armikun, sepse liria nuk vjen vetiu por fitohet me pushkë dhe me gjak. . .

— Ç'po mendohesh, o Adil? — e pyeti Tekiu. — Sot jeta ka kuptim vetëm për ata që mundohen t'i këputin zinxhirët nga trupi. Prandaj nuk duhet të vrasësh shumë mendjen që t'i kuptosh këto fjalë.

— Duhet rrahur e peshuar mirë të gjitha këto që dëgjova, o Teki, sepse kanë ardhur kohëra të vështira. Sot njeriu duhet të jetë i matur dhe të mendohet mirë para se t'i hyjë një pune të tillë.

— Mirë e ke, — ia priti mësuesi. — Ti nuk duhet të bësh asgjë pa e kuptuar përse e bën. . .

— Dëgjo këtu, — ndërhyri Tekiu. — Nuk di si të të përgjigjem, por vetëm një njeri që s'ka sy për të parë dhe zemër për të ndjerë, mund të tërhiqet më-

njanë dhe të mos çajë kokën. Ne jemi miq të vjetër me njëri-tjetrin dhe s'më vjen mirë të jesh ndërdyzaj në këtë çështje.

— Kam frikë, mor vëlla, të marr zotime që ndoshta nuk do të jem në gjendje t'i mbaj.

— Mirë. Bëj si të duash, veçse pa sakrifica nuk fitohet lufta dhe liria.

— Do ta plëqëroj këtë punë me veten time, shtruar, pastaj do të vendos dhe do të të përgjigjem. Tani, mirupafshim.

Kur fshatari u largua, bojaxhiu iu drejtua të tjerëve:

— Sa gjë e madhe është t'i afrosh njerëzit njëri me tjetrin, t'i bësh të ndjejnë dhe të mendojnë njësoj!

— Ai lëkundet, — foli mengadalë Tekiu, — por do të bindet dhe do ta gjejë rrugën e vërtetë. Për këtë jam i sigurt, se e njoh mirë. Është djalë Kolaneci dhe me të vëllanë kam qenë bashkënxënës në shkollën e fshatit.

— Sa shkollë ke bërë, ti Teki? — e pyeti një nga shokët.

— Filloren.

— Nuk vazhdove më tutje?

— Jo. Në vitin 1929, atëherë kur filloi kriza e madhe ekonomike botërore, shkova për të punuar në Argjentinë...

— Ku more, në Argjentinë!? Ç'punë bëje? — e pyetën me një zë të gjithë bashkë.

Kujtimet sikur ia sollën edhe një herë para sysh Tekiut si një vegim të largët atë jetë pa preheje e qetësi dhe në luftë për bukën e gojës. E përfytyroi veten në rrugët e Buenos-Airesit duke kërkuar punë dhe pastaj i dolën para sysh ndodhi të ndryshme, gjithë ato ngjarje të shëmtuara të jetës që kishte parë e jetuar vetë.

— Atje, — u përgjigj ai, — në fillim brodha për të kërkuar punë, mirëpo si unë kishte me dhjetëra mijëra punëtorë që ishin hedhur në rrugë. Në të gjithë vendin që përhapur një valë grevash, kështu që prapa mureve të shtëpive të shkretuara të të varfërve, luhej një tragjedi e tmerrshme dhe nuk mund të përshkruhej hidhërimi, vuajtja, mjerimi e dëshpërimi. Gjithçka më dukej pa shpresë, pa gëzim dhe e ndyrë. Një natë ecja dhe mendoja: Ku të shkoj? Ç'të bëj? Përpara meje qëndronte një botë tjetër, ku s'ta vinte veshin njeri. Më në fund, gjeta punë në një fabrikë qelqi. Më paguanin aq sa të mbaja shpirtin gjallë. Familjen nuk e ndihmoja dot. Isha i vogël, vetëm gjashtëmbëdhjetë vjeç dhe e fillova herët jetën e pavarur, plot mundime dhe punë. Atje njoha shtypjen, shfrytëzimin kapitalist dhe jetën e mjerë të punëtorëve. Kudo shihja synimin për të mashtruar njeriun, për ta grabitur e për ta zhveshur, për ta shtrydhur dhe për të nxjerrë prej tij sa më shumë fitime. Fjalët më duken të pafuqishme. E, megjithatë, kam shumë dëshirë për të shprehur ato që ndjej...

Tekiu u skuq në fytyrë, shtrëngoi nofullat dhe mbylli e hapi grushtin pa e kuptuar, sikur të ishte duke qëlluar ndonjë njeri të urryer, të cilit donte t'ia nxirrte shpirtin.

— Fillova të mendohem, — nisi përsëri Tekiu. — Të mendohem natë e ditë dhe të kuptoj se puna rraskapitëse në fund të fundit do të më katandiste në një kafshë për ngarkesë, sepse i tillë ishte fati i atyre që punonin për pronarët. Për këtë isha i bindur... Më mori malli për nënën, familjen, shokët, farefisën, për gjithë fshatarët, dhe për rrugët e shtëpitë e fshatit, saqë shumë herë më vinte të nisesha më këmbë dhe të vija këtu.

Pushoi pak. Ai kishte një përvojë të madhe, një rezervë të pasur përshtypjesh nga ngjarjet e jetës së kaluar, të cilat vite me radhë i kishin mbetur të kyçura prapa buzëve memece, ndërsa tani po derdhe-shin me vrull si ujët e një përroi të rrëmbyer.

— Pas dy vjetësh mërgimi, aty nga fundi i vitit 1931, u ktheva i lodhur, i vrarë, me qesen e zbrazët dhe fizikisht i dërmuar. Mirëpo, si gjithnjë, jetë e mjeruar, jetë e rëndë. Njerëzit vuanin për bukë. U mora me punë bujqësie dhe, kur shpërtheu kryengritja e Fierit, më morën ushtar.

— Duket që ke vuajtur, — i tha mësuesi.

— Megjithatë, kam përfituar shumë. Kam mësuar. Nuk mund të them se kam hequr më shumë se të tjerët, të cilët madje kanë lënë edhe kockat. . . Mërgimi për mua ishte një shkollë e vërtetë, që më njohu me jetën dhe që njëkohësisht edhe më forcoi. Prandaj do të luftoj ashtu siç na mëson Partia jonë, për të ndryshuar këtë botë të padrejtë, të ndarë më dysh, në të pasur e të varfër, dhe për këtë nuk më vjen keq të jap edhe jetën.

— Ke të drejtë, o Teki! — e ndërpreu bojaxhiu. — Po të mos kesh shijuar të hidhurën, nuk mund të çmosh të ëmblën. Ndryshe është ta marrësh me mend hidhërimin me të dëgjuar poshtë e lart dhe ndryshe ta ndjesh vetë

*

*

*

Nga xhadeja qenë larguar me kohë. Ecnin udhëve anësore, monopateve, larg rrugës së zakonshme dhe bënin çmos që të shmangnin kalimin pranë ba-

nesave, për të mos hasur patrullat e armikut. të cilat kishin shkelur fshatrat e grabitnin popullin.

Të ftohtit u thante fytyrën. Përpara shtrihej errësira dhe diku larg dukeshin disa drita, por natën largësia nuk përcaktohej me saktësi. Ata ecnin. Tekiu u printe përpara. Atë vend ai e njihte mirë.

Ngjitën një të përpjetë të gjatë, pastaj morën një të tatëpjetë dhe pas gjysmë ore u gjendën pesëdhjetë metra larg shtëpive të një fshati, nga dritaret e të cilave vinte një dritë e venitur si e kuqe. Në heshtjen e natës dëgjoheshin pëllitjet e mbytura të lopëve.

— S'bën të shkojmë drejt, më mirë t'i biem anës, — pëshpëriti Tekiu dhe, si lanë rrugën, morën më të djathtë duke i ardhur rrotull fshatit nja tri-dhjetë metra larg. Ecnin ngadalë dhe hapat e tyre s'ndiheshin fare. Në një vend, Tekiu qëndroi dhe u dha shenjë të tjerëve të mos lëviznin. Vetë vazhdoi përpara, kaloi te një shtëpi, u ndal te porta dhe trokiti lehtë. Që andej dikush iu përgjigj. Ai tregoi emrin dhe dera kërciti në qetësinë e natës. Tekiu hyri vetëm, kurse të tjerët e ndoqën me sy.

Kështu kaluan dy-tri minuta.

— Hyni, vetëm qetë-qetë, — u pëshpëriti Tekiu kur u kthye.

Të gjithë kaluan përmes të çarës së ngushtë të derës dhe, nëpërmjet një korridorit të vogël, u futën në dhomë. I zoti i shtëpisë i priti thjeshtë dhe me përzemërsi. Kjo i bëri që të afroheshin me të që në fjalën e parë. Kur u shtrua darka, u ulën bashkërisht në sofër.

— Nuriut, Besimit dhe xhaxhait tënd ua dëgjojnë fjalën në fshat dhe mund të na ndihmojnë.

Si mendon ti, Ibrahim, a mund të vijnë ata sonte këtu? — pyeti Tekiu.

— S'e di, po do të mundohem t'ua mbush mendjen, duke nxjerrë ndonjë shkak të fortë.

Dhe i zoti i shtëpisë, pasi hoqi sofrën nga vendi, shkoi për t'i thirrur. Pas pak, hynë në dhomë tre fshatarë me moshë të kaluar. Ata hapën sytë, por nuk u turbulluan kur panë përveç Tekiut edhe katër djem të panjohur, të armatosur me kobure në brez dhe pranë dritares pushkët e tyre. U përshëndetën dhe, pa nxjerrë zë, zunë vend rreth vatrës ku zjarri i oxhakut luante me hijet në mur.

Plaku që u ul në krye të këndit, qëndroi rëndë-rëndë, me duart përpara, me syrin të mbërthyer te djemtë, herë duke i vrënjtur vetullat e herë duke u kollitur ngadalë. Së fundi e prishi qetësinë e foli:

— Të dredhim nga një cigare. — Nxori kutinë prej teneqeje me duhan, e lëshoi përpara mysafirëve dhe pyeti:

— Hë, Teki, si i keni punët andej?

— Keq! — iu përgjigj Tekiu.

— Si keq!?

— Ti e di vetë, o xha Kajmak. Uria na kërcënon për vdekje dhe qeveria jep si për t'u tallur nga një kg misër të hidhur farmak për çdo njeri në 3-4 ditë.

— Ashtu, ashtu është! — foli plaku duke pshe-rëtitur. — Uria është ulur këmbëkryq në vatrën tona. Armiku mendon se populli ynë është mësuar të ngopet me lugë të zbrazët.

— Mirëpo, para kësaj gjendjeje ne rrimë me duart mbërthyer dhe heshtim, — iu përgjigj Tekiu dhe vazhdoi: — Me përlulje asgjë s'kemi për të fituar. Sa më shumë të japim, aq më shumë do të na kërkojnë.

— Po nga t'ia mbajmë?

— Dy duar për një kokë janë më së fundi. Erdhë koha t'u tregojmë fashizmit e larove të tij se ne dimë ta mbrojmë nderin tonë, atdheun tonë me pushkë në dorë, pa u trembur as nga vdekja.

Mënyra e thjeshtë dhe e çiltër me të cilën foli Tekiu, i pëlqeu plakut, i cili ia ktheu:

— Kur je i ri, të gjitha punët të duken të lehta, mor bir. Po a më dëgjon një fjalë? Kur bëjmë muhabet, s'kemi nevojë për shumë dritë. Zgjate pak dorën dhe ulë ca fitilin e llambës, sepse vajguri bashkë me vajin e sapunin janë zhdukur nga defteri. Përveç kësaj, mos na verë re bota se kemi pasur dritë gjër natën vonë. Për ne s'ka rëndësi, por për këta djem që nuk i dimë se nga i kemi, mund të mos jetë mirë.

— Më falni, xha Kajmak, që nuk ua paraqita që në fillim, — u përgjigj Tekiu. — Këta i kam shokë, janë punëtorë nga qyteti, ndërsa ai afër teje është mësues. Siç e shihni, kanë lënë shtëpitë e tyre dhe kanë dalë malit të luftojnë fashizmin dhe tradhtarët e vendit.

Plaku vështroi me kureshtje fytyrat e djemve dhe iu kujtuan kohët kur kishte qenë vetë i ri. Tekiu, duke ia lexuar mendimet në sy, nuk e la të fliste dhe vazhdoi:

— Armiku që na ka pushtuar vendin dhe na ka grabitur lirinë, vërtet erdhi këtu, po ai s'bëhet dot zot. Ashtu si erdhi, ashtu edhe do ta këpusë zverkun. Ne do të luftojmë. Do ta mbrojmë Shqipërinë. Do ta mbrojmë flamurin, për të cilin ke luftuar edhe ti, xha Kajmak, sepse zemra e rinisë sot është po ajo zemër e etshme për liri si ajo e kohës së djalërisë

tënde. Fara nuk vdes, ajo përtërihet më e shëndetshme në kallirin e ri.

Plakut i ndriti fytyra nga një buzëqeshje e ëm-bël! Ai i vështroi të gjithë me dashuri dhe iu drejtua Tekiut:


— Ke hak, o bir! Atë flamur të parët e tu e kanë mbajtur lart dhe e kanë dorëzuar brez pas brezi e dorë më dorë. Por hasmi është dinak, i sertë dhe vetëm s'ia dilni dot. . . — Nuk e mbaroi dot fjalën se njëri nga djemtë iu përgjigj:

— Fjalë me vend. Jo vetëm që nuk ia dalim dot, por është dhe e pamundur. Rreth e qark nesh ka me mijëra njerëz që psherëtijnë, rënkojnë dhe ankohen. Midis tyre do të gjenden patriotë, të gatshëm për të dhënë edhe jetën. Pra, ne nuk jemi vetëm. Bashkë me ne, me kohë, do të vijë i gjithë populli.

— Dushmani është forcë e madhe, mor djalë, dhe ai zjarr nuk shuhet me një pikë ujë, — murmuriti plaku dhe një kollë e fortë e shkundi të gjithë.

— Fashizmi, xhaxha, nuk është zjarr. Si pika e ujit, siç the zotrote, tani për tani jemi ne. Por pika e ujit gërmon gurin dhe mos harro se pikat e bëjnë shiun, e shumë herë shiun që bie me stomna. — Djaloshi vuri re se nga kjo fjalë e tij e vërtetë e shprehur me gjithë zemër, zunë të sheshoheshin rrudhat në fytyrën e plakut dhe në buzë nisi t'i lodronte një buzëqeshje e gëzuar. Tekiu vështroi fshatarët e tjerë që dëgjonin me vëmendje shokun e tij që po fliste. Ata e shikonin në fytyrë, pa bërë asnjë lëvizje, i përpinin fjalët e tij si toka e tharë vesën e korrikut. Papritur, njëri nga ata u hodh e tha:

— Barbarët e larot tradhtarë mundohen të na shkombëtarizojnë, të pështyjnë zakonet e bukura të popullit, gjuhën amtare e atdhedashurinë, ndershmë-



rinë e trimërinë, por ne nuk do të lëmë që të përlyhet emri i shqiptarit, sepse traditat e mira dhe burrëria e popullit tonë s'janë shuar, ne s'kemi vdekur ende dhe s'jemi plehë të na shkelin fashistët. Ne do të ndjekim rrugën e lavdishme të stërgjyshërve tanë, të cilët kanë luftuar gjithmonë për lirinë e atdheut...

Plaku ndjeu t'i rrihte me forcë zemra në krahëror. Dhe tha:

— Bukur flisni, mor djem! Fjalët tuaja më hynë mu në zemër dhe ndjej një gëzim që s'e shpreh dot me gojë. — Nga zëri dhe nga mënyra e të folurit shihej se ishte i mallëngjyer. Si heshti pak, vazhdoi:

— I riu është më afër së vërtetës... Më shkundët nga plogështia dhe po më ripërtërimi. Ju lumtë!

Fytyrat e djemve u gjallëruan nga fjalët e atij plaku që dinte edhe të pyeste, edhe të dëgjonte, edhe të thoshte fjalë me vend. Kështu zunë të kuvendonin njëri pas tjetrit, me fjalë të thjeshta. Nuk ishin shumë të gojës, por, sidoqoftë, faktet kryesore i vinin mirë në dukje, duke ndriçuar nga çdo anë arsyen e vuajtjeve dhe rrugën e shpëtimit.

Fshatarët, me atë zakonin e tyre për të gjykuar të gjitha punët matur e ngadalë, i vinin veshin secilit, dëgjonin me durim njëri-tjetrin gjer në fund që t'ua blinin mirë mendjen dhe heshtnin, sadoqë kishin kaq e kaq gjëra për të pyetur! Sa më shumë rrinin me ta, aq më fort bindeshin, por thellë në shpirt nuk besonin se këta të rinj do të ishin të zotët ta bënin me vete popullin për të luftuar fashizmin e armatosur gjer në dhëmbë.

Ndaj të gdhirë Tekiu shikoi orën.

— Erdhi koha të nisemi, — tha ai.

— Po, — iu përgjigjën shokët dhe u ngritën në këmbë.

— Sa keq më vjen që po shkoni! — ia priti xha Kajmaku. — Po dilni dhe tjetër herë këtej nga ne, se më gëzoni kur ju shoh e kur ju dëgjoj të flisni për Shqipërinë. . .

— E mira është të qëndroni, — foli njëri nga fshatarët, — por, meqë kini punë, do t'ju përcjell unë. Tani për tani s'ka patrulla në fshat, por sidogoftë. . .

— E po, udhë të mbarë dhe dalçi faqebardhë! — u tha xha Kajmaku duke vënë buzën në gaz dhe i rroku djemtë në qafë me dashuri. Ashtu bënë edhe fshatarët e tjerë. Secili ndjente një kënaqësi të fshehtë, një ndjenjë miqësie e mirënjohjeje ndaj atyre që ishin shkëndijat e para të flakës që do të shpërthente vrullshëm shumë shpejt. . .

ÇETA E PARË PARTIZANE E GORËS

Lëvizja partizane, në fillim e dobët dhe e padukshme, po shkonte dita-ditës duke u rritur, sepse drita e ideve të Partisë depërtonte në masat e popullit dhe ca nga ca i zgjonte dhe i tërhiqte ato në gjirin e saj. Kështu, rreth bërthamës së komunistëve ilegalë u grumbulluan djem trima e të vendosur nga qyteti i Korçës dhe nga fshatrat e Gorës: punëtorë, bujq e studentë. Fjala për formimin e çetës së parë partizane në qarkun e Korçës që mbante emrin e krahinës së Gorës, me komandant Teki Kolanecin, u përhap me shpejtësi të madhe.

Çeta, pas krijimit të saj, u porosit nga Komiteti Qarkor i Partisë që, për të kapërcyer vështirësitë e fillimit, t'i kushtonte një kujdes të veçantë organizimit dhe edukimit të partizanëve me shpirtin sulmues, me një dashuri të madhe për popullin, me një urrejtje të patreguar për shtypien e skllavërinë.

Për të plotësuar këto porosi, çeta e Gorës kaloi në Dushar të Oparit, në pyllin e Bofjes me ahe të gjatë e të trashë që gërshetoheshin lart njëri me tjetrin, duke krijuar kështu një çati të dendur që as dielli nuk e shponte. Edhe në piskun e vapës, atje ishte gjysmerrësirë dhe bënte fresk, pasi ajri ishte i mbushur me një lagështi që nuk thahej kurrë. Ky

pyll u bë kamp e fushë stërvitjeje ushtarake e politike për partizanët e çetave të Gorës, Mokrës dhe Skraparit. Filluan përgatitjet e stërvitjet. Partizanët më të vjetër i stërvitnin shokët e tyre të rinj për përdorimin, zbërthimin, mbërthimin e pushkës dhe për përdorimin e bombave të dorës. U mësonin mënyrën e vrapimit, të shtrirjes, të lëvizjes barkas, të zgjedhjes së vendit, të maskimit dhe, përveç këtyre, u bënë edhe qitje taktike.

Teki u kalonte nga njëri grup te tjetri, tregonte mënyrën si mund të kryhej më mirë qitja.

Në kohën e pushimit, pas stërvitjeve ushtarake dhe punës politike, partizanët merreshin me detyra të ndryshme: kush çante dru, kush sillte ujë, kush vështronte kazanin, hidhte shkarpa në flakën e zjarrit që zbehej në dritën e mbrëmjes, ndërsa të tjerët, që nuk e kishin radhën e shërbimit, pastronin armët, arnonin, lanin ndërresat ose bisedonin grupe-grupe duke pirë duhan. Në një nga këto grupe, katër partizanë ishin ulur këmbëkryq dhe kuvendonin:

— Plumbat e malisherit të tij asnjëherë nuk shkojnë kot.

— Mirë fole, o shok! Unë atë e kam bashkëfshatar. Që kur ka qenë i vogël, ka qëlluar me armë. E ka patur qejf gjahun, dhe në kohën e lirë atë e gjeje duke gjuajtur. Kjo jo vetëm që e ka bërë shënjuer të shkëlqyer, por ia ka kalitur edhe trupin në mënyrë të tillë që të mund të përballojë çdo vështirësi që t'i dalë përpara. Nuk e shikoni?! Si sorkadhe i ngjitet malit përpjetë dhe asnjëri s'ia del dot në të ecur.

— Ashtu, vërtet! Si div është. Ja, ku po vjen.

Kështu bisedonin partizanët për komandantin e tyre, të cilin e donin, e nderonin dhe e dëgjonin.

Teki nuk kishte kryer ndonjë shkollë ushtarake.

Kur e caktuan komandant, partizanët u gëzuan pa masë, pasi në të vërtetë ai kishte qenë një lloj komandanti edhe më parë. Kishte kohë që po kryente, pa ditur dhe vetë, detyrat e komandantit, por Partia, që njohu cilësitë e tij të mira si dhe dëshirat e shokëve të tij, me të drejtë e caktoi atë komandant të çetës së parë partizane në qarkun e Korçës. Celula e Partisë së çetës, me krijimin e saj, në mbledhjen e parë e pranoi në gjirin e Partisë dhe ai në çdo hap që hodhi u mundua të justifikonte me vepra vlerësimin e drejtë të saj.

Në mbrëmje, partizanët, të mbledhur rreth zjarrit, dëgjonin zërin e komisarit që kumbonte me ëmbëlsi:

— Ne duhet të mësohemi se si të luftojmë jo vetëm me pushkë, por edhe me fjalën e ëmbël. të jemi të zotët që të kuptojmë qëndrimin e Partisë në çdo rast dhe për çdo gjë dhe pastaj t'ua shpjegojmë mirë të tjerëve dhe t'i mobilizojmë ata për realizimin e vijës së saj në luftën kundër armikut. Por a do të jemi të aftë? Duhet të jemi!

Zakonisht komisari e ndërpriste bisedën duke u bërë partizanëve ndonjë pyetje dhe, papritur, përgjigjej vetë. Pastaj pak e nga pak kuvendonin edhe të tjerë.

— Për të folur me njerëzit unë s'jam i zoti. Më duket vetja si në gjemba dhe nuk di të rrah një çështje, — tha një djalë fshatari, i cili sa herë fliste mundohesh me të gjitha forcat t'i radhiste mendimet në kokën e vet, mirëpo nuk ia dilte dot. Ato i shfaqeshin të ngatërruara, jo të plota dhe ngryste ballin i pakënaqur.

— Nuk është punë e lehtë të dish t'u flasësh nje-

rëzve. — ia priti Tekiu. — Edhe unë në fillim e kisha vështirë.

— Për të folur me njerëzit, — ndërhyri komisari, — në radhë të parë duhet të kemi parasysh se me cilin kemi të bëjmë. Por nuk mjafton vetëm kaq. Ashtu si theksoi edhe Tekiu, duhen zgjedhur fjalët që do të shprehim, të mos ligjërojmë kurrë për diçka të huaj, të panevojshme, po për kryesoren, për atë që shqetëson fshatarët dhe që lidhet me interesat e tyre. Detyra jonë kryesore është që t'ua bëjmë të qartë atyre se lufta e armatosur është i vetmi mjet për çlirimin e atdheut nga pushtuesit, t'u vemë në dukje politikën demagogjike të armikut, luftën e popujve sovjetikë, të ardhshmen e Shqipërisë. Vetë jeta do të na mësojë si të diskutojmë e të punojmë.

Kështu e mbylli bisedën komisari, i cili në orët e punës politike i sqaronte partizanët për situatën e brendshme e të jashtme, për rolin e Partisë Komuniste Shqiptare si udhëheqëse e Luftës Nacionalçlirimtare si dhe për çështje të tjera.

Gjatë kësaj faze përgatitjeje, komunistët e kësaj çete zhvillonin me partizanët një punë të madhe politiko-edukative. Ata kujdeseshin shumë që e gjithë çeta të konsiderohej si një grup edukativ, pasi këta njerëz kaq të ndryshëm njëri nga tjetri nga origjina, kultura, zakonet, por jo nga moshë, i lidhnin cilësi të çmueshme, qëllime e mendime fisnike, dashuria për Partinë e atdheut.

Çdo njëri prej tyre përfitonte dhe mësonte nga cilësitë e mira që vërente te shokët. Po t'i merrje të gjithë së bashku ishin si një familje. E çfarë familje se! Shoqëria e miqësia e tyre kishte për bazë idealin, sinqeritetin. Gabimet, të metat dhe dobësitë pohoeshin haptazi, ndër sy: s'kishin të fshehta midis tyre

dhe e shikonin njëri-tjetrin në dritën e syrit. Asnjë nuk ia thyente zemrën tjetrit, veçse qeshte lirisht me të dhe e thërriste me emrin e dashur «shok». Secili nga ata e ndjente pranë vetes supin e fortë e të sigurt të shokut. Dhe sa e rëndësishme ishte kjo!

Anëtarët e Partisë të çetës, në mbledhjen e dytë të celulës së tyre diskutuan shumë probleme të ndryshme dhe një nga detyrat që doli ishte zhvillimi i një pune më të madhe politike që duhej bërë me partizanët dhe veçanërisht me masat fshatare, në mënyrë që lidhjet e zbeta, më shumë me karakter miqësor e personal, të zëvendësoheshin me një punë më të organizuar dhe më të thelluar, pasi që shtuar ndikimi i komunistëve në popull.

Për të zbatuar këtë detyrë, u bë një ndarje pune. Partizanët e çetës së Gorës dhe ata të çetës së Mokrës e të Skraparit, gjatë kohës së qëndrimit të tyre në pyllin e Dusharit, kaluan në mjaft fshatra të Oparit si në Lavdar-Opar, Karbanjos, Lekaj e gjetkë, për të ngritur në këmbë popullin që të ishte zot në shtëpinë e vet dhe jo shërbëtor i të tjerëve. Këto lëvizje rreth atyre fshatrave ranë në sy të postkomandës së vendit që ishte në Lavdar-Opar, por ajo nga frika heshti. Më vonë, nga presioni i partizanëve, situata për të u bë e rëndë dhe, për t'i shpëtuar rrezikut që i kërcënohej, u detyrua të largohet në panik.

Kjo gjendje që u krijua në këto fshatra të largëta të Oparit, i alarmoi fashistët e veglat e tyre, të cilët, për t'i bërë ballë Lëvizjes Nacionalçlirimtare, dërguan një repart ndëshkëtor të udhëhequr nga tradhtari Filip Toma¹, për të rrethuar parti-

1. — Filip Toma — kapiten i karabinierisë fashiste.

zanët në Dushar dhe për të shpërthyer një valë terrori në atë krahinë.

Partizanët u njoftuan me kohë për ardhjen e atij reparti dhe zunë prita në mënyrë të tillë që «kapadainjtë» të binin të gjallë në duart e tyre. Prisin gjithë vëmendje dhe në tension, por nuk e dinin me saktësi orën kur do të urdhëronin «miqtë». Koha ecte ngadalë. Shiu, që kishte filluar që para katër ditësh, binte pa pushim.

Teki kishte zgjedhur një vend mbi një përrua dhe shikonte përpara. Por s'mund të shihte gati asgjë. Nga shiu që binte me rrëmbim, dita ishte bërë si natë. Bubullimat buçisnin të zgjatura dhe të dendura.

— Shpërtheu artileria qiellore, — tha një student që ishte ulur me pushkën shtrënguar fort pas vetes.

Si përgjegje e këtyre fjalëve, në qiell u ndez flakë një vetëtimë e madhe. U lëkund dheu nga gjëmimi i llahtarshëm i bubullimës, por partizanët me vullnet të paepur, gjysmë të uritur, të veshur e të mbathur keq, dukej sikur thoshnin: «Ti mund të tërbohesh sa të duash furtunë, në s'na shku dot prej vendit!».

Fashistët nuk guxuan të vinin deri atje, sepse Maliq Dushari¹, armik i betuar i popullit, i kishte njoftur me kohë se partizanët ishin në dijeni dhe u kishin zënë të gjitha shtigjet. Ky pinjoll i tradhtisë, që e njihte mirë dinakërinë, bëri çmos që partizanët të largoheshin nga pylli, gjoja se kështu i jepnin shkas qeverisë fashiste që të digjte fshatin.

1. — Më vonë u bë eksponent i «Ballit Kombëtar» e komandant çete.

Në mbrëmje shiu pushoi dhe partizanët u kthyen në pyll. Ndezën zjarr. U ngrohën, thanë rrobat dhe pastaj u ulën të hanin me oreks të madh. Kur lugët prej druri filluan të takonin fundin e vorbave, Tekiu u tha duke qeshur:

— Kot mundoheni, vorba u zbraz shpejt.

— Vërtet kot, — ia priti një nga partizanët. — Gjithë këtë millet s'ka kuzhinë që e ngop.

— Unë u ngopa, — tha një tjetër. — Kjo darkë sikur më «dembelosi». Nuk më bëhet të ngrihem, të lëviz. . .

Të gjithë qeshën, sepse pasi hëngrën ato pak fasule të mrekullueshme, zunë të ndjenin një uri të vërtetë. Atyre gjithmonë u dukej se kishin harruar se kur kishin ngrënë për të fundit herë. Mirëpo tani ishin mësuar me këtë gjendje. Kishte raste kur s'e vinin re fare dhe madje u dukej që kështu kishte qenë gjithmonë. Këta djem ishin nga ata njerëz që dinin ta kthenin në festë dhe ta kalonin të gëzuar vuajtjen, urinë dhe skamjen më të madhe, sidomos në fund të pranverës kur fshatarët nuk mund të bënin më tepër për t'i ndihmuar, sepse edhe rezervat e tyre kishin marrë fund.

Herët në mëngjes, kur porsa kishte filluar të zbardhëllente, ata hodhën pushkët në sup dhe u nisën për rrugë. Ecnin pa u nxituar nëpër shtegun përmes pyllit. Kur dolën nga hieja e pyllit, filluan të binin pikat e para. Pas pak ia plasi një shi i hollë me erë. — Ja dhe shiu! S'shpëtuam dot.

Çeta e Skraparit u nis për në krahinën e saj, kurse ajo e Gorës dhe e Mokrës, të dyja së bashku, morën për nga Gora. Ecnin jo drejt rrugës së zakonshme, po nëpër ca shtigje, sepse fashistët sa herë që

merrnin vesh lëvizjet e tyre, dërgonin forca dhe zinin pusi në vende të ndryshme.

— Rruga është e vështirë dhe duhet të ecim ngadalë, — tha një partizan nga Voskopoja, i cili ishte nga ata të paktë njerëz në ato anë që e njihnin këtë shteg të padukshëm që humbiste nëpër shkurre. Pas tij, Tekiu dhe pararoja ecnin nëpër një monopat të ngushtë, ku mund të kalohej vetëm varg njëri pas tjetrit, kështu që zinxhiri partizan u bë i gjatë. Ngjitnin një të përpjetë thikë, me kthesa të ngushta që dukeshin si të varura nëpër gremina. Zhurma e hapave të tyre përzihej me zhurmën e shiut që binte ngadalë dhe me fërshëllimën e erës. Më në fund ata arritën në pyllin e Voskopojes. Shiu kishte pshuar.

Partizanët ndezën një zjarr të madh në një vend të hapur brenda në pyll, nën një pishë. Degëzat kërcisnin duke u djegur. Të gjithë ishin ulur rreth e përqark zjarrit për t'u tharë dhe dëgjonin me vëmendje fjalët e një fshatari thatanik, i cili qëndronte më këmbë e tregonte:

— Ka një orë që kanë ardhur në fshat karabinierët e milicët, të cilët zunë pritë në Bode dhe ishin të bindur e të sigurtë se ju do të kalonit andej. Ata çuditeshin se nga kini kaluar, pyesnin fshatarët nëse dinin ndonjë rrugë tjetër, po të gjithë përgjigjeshin se nuk kishte rrugë tjetër, përveç asaj që zbret nga Bodeja.

Fjalët e këtij fshatari vërtetuan plotësisht tradhtinë e kurdisur nga ai gjakpirës që kishte grabitur vite me radhë fshatarësinë e varfër të Oparit, të Gorës e të pjesës së Skraparit dhe që kishte grumbulluar një pasuri të madhe në kurriz të tyre.

— Do të vijë koha t'i lajmë llogaritë edhe me

Maliq Dusharin, — tha komisari, ndërsa partizanët shikonin flakën dhe heshtnin.

Pas pak u err dhe, përmes reve të vogla dhe të bardha, hëna e qetë notonte ngadalë. Lodhja po bënte të vetën dhe së shpejti, njëri pas tjetrit, partizanët ranë të flinin, mbi degë lisash të prerë, në dyshekun e tyre të gjelbër.

Çeta çlodhej, pasi kishte vënë roje në çdo anë...

ÇETA E GORËS NË AKSION

Sipas udhëzimeve të Partisë, çeta në bashkëpunim me njësitet guerrile, aksionin e parë e kreu natën e 24 korrikut, duke prerë e shkatërruar linjat telefonike e telegrafike të Gorës dhe të fushës së Korçës.

Të nesërmen e asaj nate sulmi, njerëzit pëshpërisnin me gëzim: «U paralizua ndërlidhja. U bë shkrumb e hi fashioja dhe depoja e fabrikës së birrës. Komunistët po ia bëjnë fora». Këto bisedime komentoheshin fshehtazi. Armiku, që ishte tronditur nga këto ngjarje, s'kishte ditë, shpesh edhe natë, që të mos i torturonte të dy të arrestuarit, Midhi Kostanin e Kiço Greçon, që i vunë zjarrin ndërtesës së fashios.

Çeta partizane kishte një javë të tërë që vigjëlonte në pritë për të goditur makinat që do t'i shpinin në Tiranë dy të arrestuarit, të cilët i kishin vënë flakën folesë së plehërave të fashizmit gjakatar.

Atë ditë një pikëllim i thellë kishte mbuluar qytetin, sepse populli, kur pa dy djemtë e tij më të mirë të varur majë trikëmbëshve, të cilët e porosisnin t'u merrte hakun, u përvëlua nga zemërimi i heshtur. Në lamtumirën e fundit nga zemra e tij dolën fjalët: «Fashistët do t'i paguajnë të gjitha!» dhe varret u mbuloi fshehtazi heronjve me kurora lulesh të freskëta.

Kur çeta mori vesh lajmin e kobshëm, u largua

me hidhërim të madh. Natën kaloi nëpër fshatrat e fushës së Korçës e të Gorës dhe shpërndau traktin që i drejtoi popullit Komiteti Qarkor për varjen e dy filizave të rinj të Partisë, të cilët kishin dhënë jetën duke thirrur: «Të rrojë Partia! Të rrojë populli!» Ky trakt shtoi edhe më tepër urrejtjen kundër shkelësve të huaj. Mirëpo, kjo gjendje i alarmoi fort fashistët, të cilët, me ndihmën e tradhtarëve të vendit, shpërthyen një valë të re terrori, duke kryer kontrollë banesash, arrestime dhe burgime për të shtypur qëndresën popullore antifashiste që rritej pa pushim me zgjerimin e veprimtarisë së komunistëve.

Sipas të dhënave, armiku kishte vendosur të internonte në kampet e Italisë një radhë komunistësh dhe patriotësh të tjerë, që ndodheshin në burgjet e Korçës. Për këtë, Komiteti Qarkor i Partisë mori vendim e urdhëroi çetat e Gorës e të Mokrës të godisnin autokolonën në afërsi të Grabovicës dhe të çlironin të burgosurit.

Forcat e bashkuara të të dyja çetave, nën komandën e përbashkët të Teki Kolanecit e të Reshit Çollakut, duke gdhirë 23 gushti mbërritën në vendin e caktuar. Atje takuan pojakun e fshatit, të cilin e porositën të mos hapte gojë dhe të largohej sa më parë nga ai vend.

Të dy komandantët organizuan pritën më së miri, në një vend të përshtatshëm, të pyllëzuar, afër rrugës automobilistike Korçë-Pogradec.

— Do të flasësh me shokët? — pyeti Tekiu.

— Patjetër, — iu përgjigj Reshiti. — Pa ejani, djema, grumbullohuni këtu! — u thirri ai partizanëve dhe nisi t'u fliste për aksionin që i priste, duke i paralajmëruar se sukcesi varej nga shpejtësia e veprimeve dhe befasia. Pastaj, bashkë me Tekiun, i cak-

tuan secilit vendin dhe detyrën. Dy shokë i lanë të ruanin rrugën, njërin në drejtim të Maliqit dhe tjetrin në drejtim të Podgories, që të jepnin sinjalin e ardhjes së makinave.

Dita qe e bukur. Frynte një erë e lehtë, e ngrohtë. Qielli ishte i pastër dhe i kthjellët. Asnjë lëvizje. Edhe syri më i mprehtë nuk mund të zbulonte asgjë të dyshimtë përreth. Koha ecte ngadalë dhe Tekiu, që kishte zgjedhur për vete një vend rreth dhjetë metra larg rrugës, disa herë e afronte orën në vesh për t'u siguruar në punonte apo kishte mbetur. Nganjëherë i dukej sikur të gjitha këto pregatitje ishin kot dhe se aksioni do të dështonte. Por ja, kur akrepat po i afroreshin orës 10, u ndie krisma e parë e pushkës, e cila qëlloi kundër patrullës, me një marshall në krye, që kishte ardhur për të kontrolluar vendin. Në atë kohë, kamionat u ndalën para se t'i afroreshin pritës dhe karabinierë e milicë zbritën nga makinat në të dyja anët e rrugës automobilistike, iu qepën brinjës përpjetë, rreth pozicioneve partizane.

Komandantët e të dyja çetave, pa kuptuar shkakun e këtij manevrimi, vendosën të vepronin, dhe qafa e Grabovicës u ndez flakë tejprtej.

Armiku përparoi me kujdes, në këmbë, u përhap në varg dhe shtiu me pushkë e automatikë mbi rrugë.

Partizanët, të maskuar nëpër dushqe, vazhdonin të qëllonin. Mirëpo, pas pak, kur nga çdo anë buçiste e kërciste, ata e zhvendosën zjarrin nga një shteg në tjetrin dhe mbajtën me ngulm çdo pëllëmbë tokë.

Ja, ky ishte fillimi... Gënjen ai që thotë: «Unë jam i qetë në luftë ose në çastet para se të fillojë lufta». Në luftë, cilido qoftë, në fillim do të ndjejë një gjë të çuditshme, sado i rrahur e i mësuar të jetë...

Dhe kjo ishte beteja e parë në jetën e këtyre djemve të rinj.

Fashistët afroheshin duke lëvizur herë ngadalë e herë me shpejtësi, qëllonin dëndur dhe sidomos posa shikonin të ngrihej ndonjë kokë.

Tekiu e Reshiti qëndronin në krye.

Duke ndjekur me vëmendje zhvillimin e ngjarjeve, ata e kuptuan edhe më mirë se aty nuk mund të rezistohej për një kohë të gjatë. Kundërshtari kishte epërsi disa herë më të madhe, por vetëm guximi si dhe pozicioni shumë i përshtatshëm u dha dorë partizanëve që të mos asgjësoheshin. Komandantët urdhëruan tërheqjen e forcave partizane pa arritur objektivin kryesor të goditjes — çlirimin e të burgosurve politikë.

Në breg të Grabovicës, çetat u ndanë dhe morën drejtime të ndryshme, njëra për në Gorë e tjetra për në Mokër, duke pasur të vrarë dëshmorin e parë të Gorës, luftëtarin e ri Tafil Pirgun, i cili një ditë më parë ishte hedhur në rreshtat partizane. Armiku pati të vrarë një karabinier dhe disa të plagosur.

Si aksion i parë i përleshjes me fashizmin, kjo goditje pati rëndësinë e saj. Partizanët e të dyja çetave fituan një farë përvoja për luftimet e mëvonshme. Nga ana tjetër, siç u zbulua më vonë, ata nxorën një mësim të mirë nga gabimi që lejuan të largohej prej vendit të pritës pojaku i fshatit Petrushë, i cili lajmëroi postën e Çeravës dhe armiku mundi të diktonte priten në qafën e Grabovicës. Por ai spiun, që u vu në shërbim të të huajit, nuk kishte mundësi të fshihej në asnjë vend dhe kudo që të ishte do të vdiste si tradhtar i popullit. Pas disa muajsh, ai u ekzekutua me vendim të gjyqit partizan.

Natë. Një heshtje e thellë sundonte në dhomë.

Teki, si dhe gjithë të tierët, duke filluar që nga më i madhi në moshë, e duke mbaruar deri te më i riu, qëndronin të dëshpëruar. E kuptonin se fjalët ishin të tepërta, të pavlefshme. Heshtja shprehte më mirë se çdo gjë tjetër ndjenjat e tyre.

Nënë Lija hyri në dhomë, ngriti kokën e mbuluar me shaminë e saj të zezë dhe u çudit me fytyrat e djemve që ishin pikë e vrer.

— Pse rrini kështu? — pyeti ajo.

— ...

— Pse s'flisni?

— Ashtu kot, — u përgjigj Teki. — Mendohemi.

— Mendoheni për ata që nuk i shpëtuat dhe për shokun që u vra sot? — tha nëna dhe tundi kokën në shenjë qortimi. — E shoh se ju dhemb dhe ju thër humbja e parë, po s'më vjen mirë t'ju shoh në këtë gjendje. I ka lufta këto... Për lirinë derdhet edhe gjak, mor djem.

— Kjo është e vërtetë, moj nënë, — ia ktheu komisar. — S'ka luftë pa gjak, veçse vdekja është e hidhur.

— Ka diçka tjetër, mor bir, që është më e hidhur se vdekja: robëria dhe turpi. Turpi përpara mëmëdheut. Të ngordhësh si qen, si krimb, kësaj duhet t'i trembesh. Kur vritesh për vendin tënd, kjo ka një kuptim dhe e vlen barra qiranë. Ai djalë pëlqeu më mirë vdekjen me nder se sa nënshtrimin. Prandaj ju duhet të hakmerreni për të dhe jo t'i dorëzoheni dëshpërimit.

Tekiut mendiu mor fryma. I hodhi sytë me dashuri e me mburrje nënës së vet dhe fytyra e tij dukej sikur thoshte: «Eh, ç'nënë që kam!». Të tjerët e vështruan me admirim dhe ia përpinë fjalët që

nxori ajo nga goja. Ndërsa komisari e vërejti me habi nënën, që qëndronte midis tyre, buzëqeshi ëmbël dhe tha:

— Nënë, na fal për këtë çast dobësie, për këtë ligështim që na zaptoi zemrat tona ende të paregjura dhe faleminderit për fjalët që na the, sepse ato ishin për ne armë e mburojë.

Ai deshi të shprehte edhe diçka tjetër, por në dhomë hyri Lutfiu, i vëllai i Tekiut, që ishte tre vjet më i madh. Pasi bëri një përshëndetje me kokë, ai vështroi nga e ëma dhe bashkë me të u largua, me sy të thatë e me fytyrë të dëshpëruar ku vërehej edhe dhemshuria e madhe, edhe vuajtja e madhe.

Tekiut vështroi andej nga shkuan ata dhe brenda një çasti e përshkuan ndjenja dhe mendime që kishin të bënin me jetën e të vëllait. Iu kujtua Lutfiu kur ishte në shkollën mbretërore ushtarake, pastaj burgimi, torturat, degradimi nga nëntoger në ushtar të thjeshtë dhe internimi në fshatin e tij Kolanec, si njeri i padenjë edhe për ushtar në kohë mobilizimi. Dhe të gjitha këto, sepse i vëllai, si njeri me vullnet të pathyeshëm, me njohuri të thella, me një kuptim të qartë mbi jetën, ishte vënë me guxim e haptazi kundër çdo ndyrësie morale që nxirrte fitime nga mjerimi. Me pikëpamjet e tija revolucionare, ai ndikoi te Tekiu, te shokët, miqtë, të afërmit e tij, të cilët i tërhoqi në lëvizjen kundër shtypjes e padrejtësive të regjimit feudal në fuqi. Dhe aktiviteti i tij ra në sy. E cilësuan si element të kuq, e arrestuan, e torturuan keq. Megjithëse forca e durimi i tij ishin të çuditshme, ai pati një krizë nervash dhe pas disa kohësh ndodhi diçka e pandreqshme, që i la pasoja deri në fund të jetës së tij. Nuk ishte në gjendje të plotë mendore.

Shokët që ishin përreth Tekiut, vunë re dhimbjen e dëshpërimit që lexohej në fytyrën e komandantit të tyre. Komisari, duke u munduar t'i jepte zërit një ton të gëzuar e të natyrshëm, e prishi heshtjen:

— E po, flemë, o shokë? Si thua, komandant?

Teki u përmend dhe, pasi vështroi një copë herë dyshtemenë, u përgjigj me zë të ulët.

— Mirë, si të doni.

*
* *
*

Me kalimin e kohës, jeta e fjetur, e qetë, e ngadalshme dukej se kishte ndryshuar. Brendapërbrenda ziente një luftë e ashpër, jo e hapur, që tregonte se njerëzit nuk e kishin kërrusur kokën ndaj pushimit të huaj.

Prej kohësh flitej se partizanët ishin parë në Kolanec, Zvirinë dhe gjetkë. Fshatarët, kudo që ndodheshin, bisedonin midis tyre për lëvizjet dhe punët e çetës. Por ndër ta kishte dhe njerëz të mashtruar, të cilët për një kohë s'mundën t'i shpëtonin propagandës dhe demagogjisë fashiste e reaksionit të brendshëm: «Ç'i gënjen mendja! Një grusht kalamanësh pandehin t'i bëjnë luftë Italisë së Duçes! A e dini se kjo qeveri është e madhe? Mos e harroni këtë!».

Por koha bëri punën e vet. Ditët u bënë muaj dhe vështirësitë e fillimit u kapërcyen. Çeta e Gorës, ende e vogël nga numri dhe rëndësia e saj luftarake, nisi të lëvizte hapur. Fshatari, duke shikuar dita-ditës fytyrën e pastër të partizanit, duke i zënë më tepër veshi fjalën «Parti», filloi të ndryshonte dhe s'ishte më si më parë, si në gjumë. Sytë po i hapeshin, por

nuk dinte ç'të bënte. Mendja e pushtuar nga paniku e mashtrimi e urdhëronte të mbyllte derën fort, kurse fjalët fuqিদhënëse, që i flisnin zemrës, i tingëllojnë në gjalla në veshët e tij, e nxisnin t'i hapte të dy kanatat dhe ta linte çliruesin, mbrojtësin, shokun e brengave, vëllanë, të hynte brenda. Këtë ndryshim po e bënte vetë lufta e Partisë, fjala e zjarrtë e shtypit luftarak të saj. Me etje të madhe e lexonte atë i madh e i vogël, sepse i prekte atje ku u dhimbte dhe bëhej shkas për biseda të zjarra:

— Mbrëmë Partia na hodhi letra dhe e mbushi fshatin nga të gjitha anët!

— Na e vaditi shpirtin me fjalët e së vërtetës!

— Ahmet beut nuk i pëlqejnë këto gjëra. Një ditë, kur u ktheva nga Moglica, i tregova një letër si ato që na hodhën mbrëmë. E pa dhe u zemërua shumë: «Leri, Ali, — më tha, — mos u merr me këto marrëzira që i nxjerrin ca të fandaksur. Me këto, ata duan të turbullojnë ujin kot, ta futin popullin në rrugë të gabuar dhe t'i venë kazmën Shqipërisë. Po vazhdove t'i lexosh, do të marrësh veten në qafë, se burgu e internimi të pret. . .» Ja, kësh-tu më tha.

— Gazeta, mor vëlla, bën punë, u hap sytë njerëzve.

— Mirëpo bejlerëve nuk u pëlqen! Mua më është mbushur mendja top se beu mban anën e fashizmit.

— Jo more! Po pse? — pyeti me kureshtje një mesoburrë.

Adili nga Vloçisht, që ishte futur me kohë në veprimtarinë e çetës, së cilës i shërbente edhe si ndërlihdës, iu përgjigj prerazi:

— Akoma çuditësh ti e bën pyetje që i di dhe

bufi? — Pastaj u drejtua nga të tjerët dhe u tha: — Pa le, na hiqet për patriot beu, gjoja i digjet shpirti për vatanë. . .

— Dreqi e merr vesh! Të shohim si do t'i vejë filli kësaj pune!

Çeta e Gorës, duke i rënë krahinës poshtë e lart, takonte e bisedonte me dhjetëra fshatarë në lëmenj e në ara duke mbartur me ta duajt me grurë.

*

*

*

Nën qiellin e kaltër, ku dielli i gushtit përvë-lonte gjithçka, fshatarë e partizanë rrinin në një arë, rreth hijes së një peme, duke dëgjuar me vëmendje Tekiun, i cili po e përfundonte bisedën me këto fjalë:

— . . . Fashizmi, përveç të tjerave, ka dhjetë-fishuar taksat dhe e ka shtuar xhelepin. Këto ua kanë zënë juve frymën dhe ju lot mendja kur mendoni se si do t'i paguani... Mirëpo durimi e kaloi ku-finë. Duhet të fshehim bereqetin dhe të mbrojmë me armë në dorë bukën e prodhimet e tjera që i keni fituar me një mijë mundime.

— Drejt e ke, o Teki! — iu përgjigj një fshatar i moshuar. — Por kjo mund të arrihet vetëm po pranuan të lidhin fjalë të gjithë fshatarët, ndryshe s'bëhet gjë.

— Ashtu është, — ia rrëmbeu fjalën Tekiu, — dhe kështu porositi Partia: të bashkoheni jo vetëm brenda fshatit, por dhe fshat me fshat. Ne do të shkojmë dhe në fshatrat e tjera përreth, që fshatarët të bëjnë edhe atje të njëjtën gjë, sepse derisa të mos jemi të lidhur ngushtë e t'i luftojmë të gjitha dre-

dhitë e ulkonjës fashiste, ne nuk do të çlirohemi kurrrë nga skllavëria...

Partizanët ngjiteshin në një rrugë gjarpëruese drejt fshatit, të ndjekur nga një grumbull fëmijësh të lekosur, të cilët pa dyshim i kishin parë nga larg.

Kur hynte çeta në fshat, fillonin përshëndetjet: «Vdekje fashizmit, liri popullit!». Sytë e të rinjve fshatarë shndrisnin nga gëzimi. Nga afër partizanët dukeshin pothuaj të një moshe me ta: me fytyra të rrahura nga era, të nxira nga dielli dhe plot gaz e shëndet. Veshjet e tyre të shumëllojshme dhe armët e ndryshme, nuk e shëmtonin aspak pamjen trimërore, madje jepnin një tablo shumë të larme, që të sillte ndër mend oshëtimat e luftërave heroike të stërgjyshërve që shekuj me radhë luftuan kundër shtypësve.

Djemtë i rrethuan partizanët dhe u miqësuan shumë shpejt me ta. Të gjithë flisnin dhe bënë ashtu si u thoshte zemra... Pranë tyre, te një mullar me bar, disa fshatarë ishin ulur dhe bisedonin me Tekiun.

— Ku e ke djalin, o Kadri? — pyeti Tekiu një burrë rreth të pesëdhjetave, që tërë jetën e kishte kaluar në mjerim.

Fshatari, me sa dukej, nuk dinte si t'i përgjigjej pyetjes së Tekiut. Lëvizi si një njeri i zënë ngushtë e kërkoi t'i bënte bisht vështrimit të tij. Donte t'i thoshte diçka, por nuk gjente fjalët e duhura. Por Tekiu nuk i la kohë dhe vazhdoi:

— Ne s'na vjen mirë që Vasfium të veshë rrobat e milicist fashist dhe për pesë napolona të marrë vulën e tradhtisë, të fëlliqë emrin, nderin, burrërinë e familjes tënde..., të bëhet armik i atdheut, vegël

gorre e fashizmit, e njerëzve të shitur që mundohen të hedhin midis nesh farën e keqe të grindjes, të përçarjes, të intrigës dhe të luftës vëllavrasëse.

Fjalët e Tekiut ndiqeshin me vëmendje të madhe. Ato goditnin si sopatë, dhe Kadriu dukej si ndonjë degë e kalbur e rrëzuar përdhe. E plagosën thellë, shumë thellë ato fjalë që dëgjoji, madje iu duk se po e qëllonin shumë keq me kamxhik. Mbeti ashtu i shtangur, me fuqi të prera. Vështrimi i tij i fikur dukej sikur thoshte: «Të gjitha i kam duruar: urinë, skamjen, të gjitha. Varfëri, varfëri, po ama faqebardhë kam jetuar. Ja ku jam sot! Por vetëm një gjë më ka mbetur e çmueshme dhe e pacënuar: Nderi. Kurse tani të dëgjoj se djali im është i padenjë për emrin që mban!? Të mos ketë sy t'u dalë përpara njerëzve!? Një turp i tillë s'mund të ndodhë në familjen time, që s'i është skuqur kurrë faqja...»

Kaluan disa minuta në heshtje. Secili ra në mendime. Njerëzve të tillë u pëlqente fjala e vërtetë, e thënë deri në fund. Tekiu e dinte këtë, prandaj i vështroi me radhë fytyrat e fshatarëve që kishin marrë një pamje qetësie të gurosur. Drodhi një cigare dhe, pasi e ndezi, vazhdoi bisedën që kishte filluar:

— Ata mobilizojnë djemtë tanë në ushtrinë italiane, për të lënë kokën në vendet e huaja, ku të mos u dihet as nami as nishani. Mbledhin milicë, xhandarë e policë, u japin armë që të bëhen vrasës të vëllezërve të tyre, të partizanëve që sot japin jetën për të mbrojtur gjënë më të shtrenjtë, lirinë dhe vatanin.

Befas Kadriu u largua nga trangu ku qe mbështetur, bëri një hap, u ndal dhe pyeti me një zë të mekur që i dridhej nga fuqia e paktë:

— Vasfiu kundër jush do të luftojë?!

— Po si kujtove ti? — i tha Tekiu i ngrysur.
— Ata po na mbysin me duart tona. Kjo është e keqja!

Kadriu u drodh. Ndenji pak i menduar dhe pastaj tha:

— Më thuaj, ç'të bëj, o Teki?

— Dërgoji fjalë, sa është në kohë të ndreqë gabimin që ka bërë. Të largohet prej radhëve të milicisë fashiste. Nesër do të jetë shumë vonë.

— Të falemnderit për këshillën, vëlla. Do të shkoj vetë ta marr, qoftë edhe të vdekur... — u përgjigj Kadriu dhe me sytë e tretur vështroi larg, pastaj futi kokën brenda në supe dhe u përgatit për të ikur. Por Tekiu nuk e la të largohej ashtu. Ai i tha mjaft fjalë të ngrohta, e kapi për krahu dhe bashkë me fshatarët e tjerë u drejtua për nga grumbulli i njerëzve që vinte duke u zgjeruar.

Dielli ishte në të perënduar dhe frynte një fllad i lehtë.

— S'ka gjë më të keqe për njeriun, — thoshte komisar, — se sa kur i rrëmbejnë e i vjedhin kafshatën e gojës dhe ai bën sehir e nuk i del për zot... Egërsira, sa më tepër të të shohë me kokë ulur, aq më shumë hazdiset. Duke 'i kundërshtuar armikut, do t'i prisni hovin grabitjes së tyre, përndryshe, gjithë vitin do t'ju këndojnë zorrët.

— E drejtë! — e mbështeti një fshatar me zë të lartë.

Komisari vështroi njerëzit në sy, shkëmbeu me Tekiun një vështrim të shpejtë dhe e mbylli bisedën me këto fjalë:

— Për t'i kthyer vendit tonë lirinë dhe nderin e marrë nëpër këmbë, duhet të luftojmë me pushkë kundër kalbësirës fashiste. Kjo është e vetmja rrugë

për të shpëtuar nga jeta e dëshpëruar. — Dhe, kur ai mbaroi së foluri, malet filluan të ushtonin nga kënga:

*Sot lipset me flamurë,
Malit të dalimë,
Përmbi shkëmbinj e gurë,
Lirinë të ngjallimë.*

Partizanët u futën nëpër shtëpitë e fshatarëve dhe rreth e rrotull sofrës së rrumbullakët u shtrua bujarisht buka e misrit e fasulet, që djemve u duke-shin si mjaltë, sepse u jepej nga djersa, zemra dhe shpirti i fshatarit. Biseda e tyre vazhdoi me zemër të hapur me orë të tëra.

Të nesërmen, dita ishte e bukur. Dhe përsëri filluan përsëritjet. Çeta mori me vete vullnetarë të rinj, armë e municione të mbetura nga lufta italo-greke dhe u largua duke lënë prapa gjurmët e saja, përshtypjet që ndriçonin shpirtrat e fshatarëve për të fituar të drejtat e grabitura.

*

* *

Kur dëgjuan moton kreshnike, «Vdekje fashizmit!» partizanët ngritën kokën, vështruan një hop Adilin e Vloçishtit e dy shokët e tjerë që nderonin me grusht, u përgjigjën «Liri popullit!», pastaj u përsëritën me ta dhe i ftuan të uleronin.

Tekiu, si mbaroi së lexuari letrën që i sollën ata, i pa mirë fytyrat e dy djemve të rinj, të cilët

kishin zënë vend pas shpinës së Adilit dhe e ndjenin veten të lumtur e të gëzuar.

— Ç'kemi andej nga Korça? — i pyeti ai dhe ata shkurtimisht treguan se fashistët, krahas politikës së shtypjes, terrorit e shfrytëzimit, e kishin vështirësuar edhe më shumë gjendjen e furnizimit të popullsisë.

Partizanët, megjithëse shumë gjëra i dinin, dëgjonin me vëmendje: Çmimet e sendeve të nevojës së parë kishin hipur në stratosferë, banknotat binin si fletët e pemëve, jetesa ishte shtrenjtësuar shumë dhe papunësia kishte marrë përpjesëtime të mëdha.

— A kanë burgosur shumë njerëz? — i ndërpreu komisari.

— S'ka ditë të mos bëhen arrestime, — iu përgjigj njëri nga ata. — Mbrëmë erdhën milicët në një shtëpi afër nesh, kontrolluan deri në mëngjes dhe kur ikën morën me vete një punëtor.

Biseda vazhdoi gjatë. U vërtit e u vërtit paresh-tur, duke shkëmbyer përshtypjet dhe duke përmendur njerëz që i njihnin. Pastaj u shtrinë për të fjetur. I zoti i shtëpisë i fryu fitilit të llambës, e shoi fare dhe, kur doli nga dhoma që kishte mbetur në të errët, nuk dëgjoji as lëvizjen më të vogël.

Drutë e njoma që kërcisnin në zjarr lëshonin flakë dhe drita e tyre i binte Tekiut në sy. Megjithëse e ndjente veten të lodhur, ai nuk flinte. Kur vuri re se edhe shoku që ishte pranë tij rrinte me sy hapur, e pyeti:

— Pse nuk fle?

— S'më zë gjumi.

— Fli.

— Pa më trego, o Teki, ç'punë bëre pasi u li-

ruam nga ushtria? Ç'është e vërteta, unë diçka kam mësuar për ty, por, me sa duket, pak.

Tekiu ishte në një gjendje të tillë shpirtërore, që njeriu, pas një qetësie, kërkon t'i çelë zemrën të tjerëve.

— Ishte muaji nëntor i vitit 1936 kur u liruam nga ushtria, — ia filloi Tekiu. — Unë hyra në një kurs dymujor për infermier veteriner dhe, kur e mbarova, më dërguan në Delvinë. Pas 3-4 muajsh më arrestuan dhe në maj të vitit 1937 më dënuan me 15 vjet burg. — Heshti një copë herë, pastaj ia nisi të fliste më nge e me zë të ulët, duke u ndalur herë pas here.

— A të kujtohet kur ishim ushtarë sa herë kemi biseduar bashkë, jo faqe të tjerëve, por kokë më kokë? Pra, ashtu si me ty, edhe në Delvinë gjeta një shok të tim vëllai, të Lutfiut, një nëntoger nga Shëngjergji i Tiranës që punonte në rekrutim. Me të kuvendonim vazhdimisht për gjendjen ku ishte kandidateur vendi ynë. Mezi prisnim të vinte dita e përleshjes me forcat qeveritare. Mirëpo na mbërthyen dhe u gjendëm në kthetrat e xhandarëve. Në burgun e Gjirokastrës më mbajtën rreth katër muaj dhe prej andej më dërguan në atë të Korçës... Nga shkurti i vitit 1939, atje u njoha me disa komunistë, të cilët kishin rrahur një fashist dhe i kishin shkatërruar farmacinë. Që në takimin e parë, ata më bënë për vete, më rilindën shpresat e tulatura, më ndezën urrejtjen kundër padrejtësisë, shfrytëzimit dhe më ndriçuan rrugën e lirisë. — Pushoi pak, pastaj me zë të qetë vazhdoi:

— Në burg unë kisha fituar besimin e të burgosurve dhe, kur hyri Italia fashiste në Shqipëri, u vura në krye të tyre. Shpërthyem dyert dhe prej

andej shkova në fshat ku jetova më shumë se tre muaj si gjysmëilegal, derisa u bë amnistia për falje dënimi. Por, që t'i biem shkurt, pushtimi i Shqipërisë dhe humbja e pavarësisë më forcuan më tepër ndjenjën e dashurisë për atdheun si dhe urrejtjen ndaj pushtuesit. Formimi i Partisë Komuniste Shqiptare më ngriti për luftë. Pra, duke qenë nën ndikimin e komunistëve, në muajin mars dola partizan. Të tjerat ti i di mirë.

Shoku e dëgjonte dhe mendonte. «Ç'djalë trim dhe sa i thjeshtë!».

Atë natë, të dy i zuri gjumi vonë.

SHKËMBI I BELLOVODËS

Mëngjes. Një grusht partizanë mbërritën rrëzë një kodrine në afërsi të Bellovodës së Vithkuqit.

— Më në fund arritëm. Tani çlodhuni, — u tha Tekiu shokëve. Ata u ulën dhe filluan të vështronin grykat, pyjet e malet, ku mund të ngriheshin prita të shkëlqyera. Tekiu e dinte mirë se çdo luftëtar kishte tjetër peshë e mund të luante një rol shumë më të madh në këtë terren të thyer se sa në fushë të hapur. Suksesi këtu varej shumë nga lufta e secilit. Prandaj ai s'mund të çlodhej si të tjerët, por filloi të kontrollonte vendin nga të dyja anët e rrugës, caktoi zonën e pritës, shtigjet e tërheqjes si edhe sinjalet e fillimit e të mbarimit të goditjes.

Pas pak, ata zunë pritë në disa shkëmbinj afër një kthese të fortë, mbi rrugën automobilistike dhe pranë fshatit. Vendi kishte çuka të vogla të mbuluar me shkurre të dendura, rreth dy metra të larta. Në të majtë, kur shkon për në Korçë, u vendos çeta prej 9 vetësh e Gorës dhe në të djathtë zunë vend 3 veta të njësitit të Kolonjës. Në xhade u la një partizan, jo vetëm për të dhënë sinjalin me hedhjen e granatës, por edhe pse e njihte në fytyrë kriminelin me damkë, për të cilin Qarkori i Partisë kishte aprovuar zhdukjen nëpërmjet pritës.

Me sa dukej, asgjë nuk e rrezikonte suksesin. Çdo veprim u krye me fshehtësinë më të madhe.

Agoi dita e parë e vjeshtës së dytë, 1 tetor 1942.

Një orë pas lindjes së diellit, fshati dukej si i shkretë. Të gjithë kishin shkuar në punë. Vetëm pak gra, plaka e pleq, dukeshin tutje-tëhu në rrugë. Më në fund, kur dielli kishte hipur në zenit dhe dukej sikur nuk lëvizte më, edhe kjo lëvizje u shua dhe mbeti vetëm një plakë që rrinte ulur nën hijen e strehës së një shtëpie. Më vonë, dielli eci drejt perëndimit dhe djemtë, të mbështetur pas gurëve me sy të lodhur, shikonin sendet që qëndronin të palëvizura në natyrë. Dita u dukej jashtëzakonisht e gjatë dhe minutat sikur s'kishin të mbaruar.

Ora pesë pasdite. Rreth e rrotull çdo tingull dhe zhurmë dëgjohej fare qartë. Papritur, nga larg, Te-kiut i zuri veshi një zhurmë, që mezi ndihej.

— A e dëgjon? — pyeti ai shokun që kishte pranë, më tepër për t'u siguruar. Jo, s'kishte më dyshim. Zhurma po bëhej përherë më e qartë. Jehona e saj, në fillim e mbytur, po përhapej grykave. Të gjithë i mbajtën veshët ngritur. Kudo i ndjenin të rrahurat e zemrës, edhe në gishtat e duarve, kaq fort i shtrëngonin pushkët.

Dy kamiona «Ventisei» pa mbulesë, me rreth pesëdhjetë fashistë, zbrisnin ngadalë gjatë rrugës me kthesa të pjerrëta nga Vithkuqi për në Korçë. Nëpër stolat e vendosur anash dhe në mes, rrinin lirshëm karabinierë e milicë italianë, me pushkë në dorë.

Qarkkomandanti i karabinierisë fashiste, Filip Toma, që organizonte njërin pas tjetrit operacione ndëshkimore në zonën e Vithkuqit e të Oparit kundër çetave partizane dhe bazave të luftës, pritej të

vinte me një veturë «Ford». Por ai, si njeri me përvojë e dinak, kishte vendosur të hipte në kamionin e parë, pranë shoferit.

Minutat e fundit ishin shumë munduese. Partizanët në pritë kishin drejtuar grykat e pushkëve dhe me gishtin në këmbëzë, nuk lëviznin, sytë i kishin ngulur në xhade dhe prisnin çastin vendimtar, hedhjen e granatës.

Te kthesa, u duk makina e parë. Më në fund mund të dalloje lehtë fytyrën e çdo fashisti. Partizani që ishte në rrugë, e njohu kapitenin dhe, mbas disa sekondash, ajrin e përshkoi gjëmimi i granatës. Makina e parë ndaloi dhe pas saj edhe e dyta që kishte hyrë brenda pritës.

— Zjarr!.. — thirri Tekiu dhe si top u dëgjua krisma e pushkës së këtij qitësi të shkëlqyer. Sinjalëve iu përgjigjën batore të forta nga e djathta dhe e majta, që u kryqëzuan mbi të dy makinat.

Kapiteni me revole në dorë, pa dalë mirë nga kabina, u përplas menjëherë për tokë dhe u zvarrit si krimb, për të mos u ngritur më kurrë.

Një hutim i papërshekruar pushtoi fashistët. Të trullosur e të tmerruar, ata kërcenin nga makinat, binin, vraponin tutje-tëhu si të tërbuar, shtriheshin barkas, zvarriteshin rrëzë shkëmbit e pas përroit të thatë me gurë, duke mos ditur se ku të futnin kokën. Thirrjet e tyre përziheshin me krismat e pushkëve që era i shndërronte në oshëtima të thella, ndërsa pylli e shkëmbinjtë u përgjigjeshin atyre me një jehonë të pareshtur. Dukej sikur edhe vetë malet luftonin dhe i dilnin zot vendit. Në mes të kësaj rrëmuje, fashistët mundën të fshiheshin prapa shkurreve dhe nuk dihet nëse dëshpërimi u dha fuqi që të hapnin zjarr.

Gjysmë ore kishte mjaftuar. Epërsia e befasisë ishte shfrytëzuar e tëra. Qëllimi i aksionit u arrit. Së bashku me agjentin e regjur të fashizmit italian, mbetën të vrarë e të plagosur edhe shumë armiq të tjerë. Nga çeta e Gorës u vra vetëm partizani trim Sotir Tërova.

Me t'u dhënë sinjali i tërheqjes, njësitë e Kolonjës u hodh nga ana e Qarrit dhe çeta e Gorës u drejtua për nga Polena.

Sipër në majat e maleve të murme po perëndonte dielli. Nëpër kthesat e qafave tërë çeta dukej si një zinxhir. Përpara printe Tekiu.

Lajmi i vrasjes së Filip Tomës, të këtij njeriu që urrehej për vdekje, si dhe jehona e luftës në shkëmbin e Bellovodës, u përhapën anembanë. Në ato kohëra të vështira, kjo ngjarje preku shpirtrat e njerëzve të etur për hakmarrje.

*

*

*

Sapo kishte filluar të agonte kur në Kolanec hynë rreth pesëdhjetë milicë, të cilët si çakej rrethuan shtëpinë e Tekiut. Toger Sali Piluri¹ e Sade Dërsniku² bashkë me disa «trima» u futën brenda. Atje gjetën nënë Lijen që kishte qëndruar në mes të dhomës, duke ua ngulur sytë milicëve me urrejtje.

— Ku i ke djemtë, moj plakë? — i foli Saliu.

1. Sali Piluri — toger milicie.

2. Sade Dërsniku — më vonë u bë komandant «Balli».

— Vetëm Lutfiun kam. Ta kisha të shëndoshë, do të isha e lumtur që edhe ky të mos ishte këtu, po në mal si dy të tjerët.

— Ashtu, ë! Po a e di se do të t'i vras djemtë?

— Po munde t'i gjesh, vriti.

— Ti mendon se është e vështirë të gjesh Tekiun maleve dhe grykave? Ai vërtet është stërvitur t'i humbasë gjurmët e veta, por nuk mund të qëndrojë i fshehur përgjithnjë. Do të vijë dita që do ta braktisë domosdo strofullën e tij dhe do të dalë.

— Im bir dhe shokët e tij nuk kanë dalë maleve për t'u fshehur, — iu përgjigj nëna duke e vështruar ashpër si më parë. — Ata gjenden kudo, ngrej në popullin në këmbë dhe ua mbyllin gojën spiunëve.

— E paske gjuhën brisk moj plakë, po ç'do të thuash kur të të djegim shtëpinë?

— Ç'prisni!! Digjeni, por këtu do t'i lani të tëra...

— Kush do të guxojë?

— Bijtë e popullit!

— Ejani djema, filloni nga kontrolli, — u tha Saliu milicëve.

— Ju s'kini as turp as zemër, — foli nëna me zë të mbytur nga mallëngjimi.

— Leri fjalët dhe shko na pregatit drekën.

— Nga dora ime asgjë s'do të kini, përveç farmaq.

Nëpër fshatrat përreth fjalët morën dhenë:

— E, ç'dëgjohet? Nuk kapën njeri?...

— Jo, s'kemi dëgjuar gjë!

— E bastisën?

— S'lanë vend pa kërkuar. Shtëpinë e bënë
lesh e li.

— Të isha atje, do ta kisha vrarë në vend pa
u drojtur një njeri që sillet si shtazë e egër kun-
drejt një nëne pa mbrojtje.

— Mos ki merak se edhe Sali «kapedani» do ta
gjejë si ai që u qërua pardje...

KËSHILLAT NACIONALÇLIRIMTARE

Në një dhomë të madhe të mbushur me tym duhani nuk ishte e lehtë të shikoje se sa njerëz ishin mbledhur. Fshatarët prisnin me padurim të dëgjonin.

— Më duket se janë mbledhur të gjithë, — foli Tekiu. Disa zëra thirrën: — Dëgjoni, se dikush do të flasë. — Bisedimet pushuan në çast.

— Atëherë mund të fillojmë, — tha një djalosh thatim, i cili nisi të fliste:

— Shokë fshatarë! Me porosi të Partisë, unë do t'ju flas për një konferencë që është mbajtur në Pezën e Tiranës më 16 shtator të muajit të kaluar. — Të gjithë ngritën sytë për të parë djalin që ua dërgonte Partia, i cili, pasi u foli për Frontin Antifashist dhe për këshillat nacionalçlirimtare që do të ishin bërthamat e qeverisë së re, e ngriti zërin:

— Sa vjet ka që kryepleqtë, komonet, postkomandant e qeveria na dërmojnë, na poshtërojnë dhe na rrëmbejnë çdo gjë? Ç'të mira kemi pasur nga këta? Asnjë të mirë, asnjë ndihmë, veçse u jemi bindur verbërisht për të na pirë gjakun.

Fshatarët në heshtje të plotë dëgjonin fjalët që sikur u kishin gjetur zemrën.

— Por tani erdhi koha t'i shkatërrojmë dhe t'i qërojmë këta. Pema e thatë do sopatën në rrënjë...

Dhe për këtë jemi mbledhur këtu. Është e drejta juaj që të zgjidhni ata njerëz që doni. Mund të largoheni për t'u menduar më mirë.

Askush nuk luajti nga vendi. Aty prapa, një fshatar, u përgjigj për të gjithë:

— Ne, o shok, i njohim mirë njerëzit në fshat dhe nuk kemi nevojë të merdohemi dy herë...

*
* *

Prej andej, partizanët të ndarë në grupe, sipas porosisë së qarkorit të Partisë, kaluan në Kolanec, Vinçan, Bulgarec, Vloçisht, Rëmbec, Sovjan, Zvirinë, Pirg, Pëndavinj, e gjetkë, për të ngritur këshilla të reja dhe për forcimin e atyre që ishin formuar që në verën e atij viti.

Këta djem të rinj pa ndonjë përgatitje të veçantë, futeshin nëpër shtëpi, shpinin vijën e Partisë në masat e thjeshta dhe zgjonin shpirtrat e tyre të mpira nën barrën e përpjekjeve për krodhen e bukës. U flisnin fshatarëve si do të ishte çdo gjë mbas luftës e u shpjegonin se pushtet popullor do të thotë që populli të jetë zot i vendit dhe të verë ligje që të jenë njëlloj për të gjithë. Mirëpo këto fjalë nuk u pëlqenin njerëzve të kolonës së pestë, si Riza bej Moglicës¹, i cili u takua me Tekiun në bazën e një fshati ku kishte vajtur si mik shtëpie. E filluan shtruar, po dalëngadalë biseda u trash:

— Djemtë na marrin më qafë se nuk dinë nga

1. Riza bej Moglica — spiun në shërbim të pushtuesit.

politika, — i tha Riza beu të zotit të shtëpisë dhe pastaj iu drejtua Tekiut:

— Ju kujtoni se i dini të gjitha, por ju mungon përvoja. Kapeni pas degëve të pemëve dhe jo nga rrënja siç jam i lidhur unë. Më i forti e ha më të dobëtin. Këtë s'ka zot që ta ndryshojë...

— Më i forti, — ia ktheu Tekiu, — nuk është ai që ka në duar armët, por ai që jeton në zemrën e popullit dhe ato rrënjë, që the zotrote, i ka ngrënë krimbi e shkulen lehtë-lehtë sikur të mos kishin qenë kurrë.

— Mua nuk ma mbushni mendjen me këto fjalë dhe ju them të hiqni dorë nga politika. Le të merren zotërinjtë e avokatët me to... — iu përgjigj beu dhe pas pak shtoi: — More, ku i kini autoritetet tuaja? A e di se ne kemi njerëz të zotë si Faslli Frashërin e Kolë Tromarën me shokë, udhëheqës të kombit në qarkun e Korçës dhe patriotë që mendojnë për Shqipërinë?

Teki u vështroi në sy dhe tha me krenari:

— Ne partizanët jemi të lumtur që në radhët tona s'kemi njerëz faqezinj si ata që ti i quan udhëheqës të kombit, të cilët janë vënë që në fillim në shërbim të Italisë fashiste.

— Ju shikoni ëndrra me sy hapur. Jeni bolshevikë dhe ju heq për hunde Moska, — tha me inat beu dhe u ngrit.

— Ja ç'dua të të them, — iu drejtua beut i zoti i shtëpisë. — Zakoni ynë i mikpritjes më shtrëngon të duroj edhe poshtërsinë e mysafirit tim... por me kusht, që kjo të mos përsëritet. Më mirë ta lëmë këtë muhabet.

Në dhomë ra heshtja. Ajo tregonte mbarimin e një miqësie. Me kokën të strukur midis shpatullave,

beu u largua mengadalë. Te praku i derës u ndal, u kthye pas sikur donte të bënte ndonjë pyetje, por pastaj hapi derën dhe doli jashtë.

Nën dritën e llambës, të zotin e shtëpisë mund ta përcaktoje se ishte pesëdhjetë e kusur vjeç. Kish-te një vështrim të sinqertë, plot besim dhe fliste me zë të ulët e sikur e maste çdo fjalë përpara se ta thoshte.

— Nga bejlerët e agallarët kurrë nuk mund të dalë punë e pëlqyer. Larg nga zotërinjtë, o Teki! — Dhe me bindjen e patundur të fshatarit, shtoi: — Ke për ta parë. Tani ai do të vërsulet të të kafshojë si i tërbuar.

— E kam të qartë, — u përgjigj Tekiu. — Sa më i dobët të jetë kundërshtari, aq më i poshtër bëhet.

Dhe fjalët u vërtetuan. Riza beu shkoi në Korçë e njoftoi padronin e tij. Pas pak u kthye me disa fshatarë të gënjyer që i kishte marrë me vete. Gjatë rrugës, në kokë i tingëllonin pa pushim vetëm këto fjalë: «Të eci shpejt se, derisa të vinë forcat, mund të largohen nga fshati ata djaj që nuk i merr vesh se ku venë dhe nga shkojnë!» Ndaj të ngrysur arriti deri në përruan midis Kucakës e Nikollarës së Gorës, ku pushka partizane ia preu rrugën dhe e përplasi për tokë...

Në vjeshtën e tretë fshati është shumë i mër-zitshëm. Fletët e mollëve që kanë rënë përdhe dergjen të lagura nga bryma e natës dhe mbushin tokën e braktisur. Kudo baltë. Fryn një erë e fortë sa askujt nuk i shkon mendja të dalë e të shikojë se ç'ka përjashta. Dhe as që ka se ç'të shohë...

Kur dita ishte në të thyer, drejt Zboqërisë vinte

një tabor i madh milicësh me Sali Pilurin në krye, i cili, si një korb i zi, ishte turrur të copëtonte dhe të gllabëronte zogun në fole. Por njësitë e fshatit Babien e diktoi sulmin e papritur dhe ata pak partizanë të çetës së Gorës që ishin në fshat, dolën një nga një, kur tradhtarët filluan të qëllonin.

Një fërshëllimë... Edhe një tjetër. Mandej shumë të tjera. Një plumb i ftohtë vjen së largu, godet në qafë një luftëtar dhe e plagos lehtë.

Në mbrëmje, partizanët u gjendën në Qenckë dhe të nesërmen, pasi u takuan me komandantin e tyre e shokët e tjerë, u hodhën në fshatrat Grybec, Strelcë e gjetkë. Në to ngritën këshillat nacional-çlirimtare, organizuan e zhvilluan mbledhje për të festuar 7 Nëntorin — 25-vjetorin e Revolucionit të madh Socialist të Tetorit si dhe 8 Nëntorin — kur Partia Komuniste Shqiptare mbushte një vit jetë nga dita e themelimit të saj.

* * *

Tekiu pothuajse s'pinte kurrë. Jo për «virtyt», po sepse s'ia kishte qejfi. Me të pirë dy gotat e para, i mbylleshin sytë dhe s'e ndjente veten mirë.

— Ç'bën, o Teki, pse nuk e ngrë gotën?

— Unë s'di të pi, o miq. Po bashkë me ju, për nder të këtyre dy fiseve, në shtëpitë e të cilëve nuk dëgjoje veçse gjëmë e rënkime, mund të pi edhe vajguri.

— Na rrofsh... Bromp!

— Ta pimë për Partinë që na çliroi nga pesha e rëndë e gjakmarrjes dhe na bashkoi për të rrokur armët kundër armiqve e tradhtarëve, të cilët e kanë

ngacmuar e ushqyer zakonin e keq të gjaqeve, me qëllim përçarjeje, — tha Tekiu.

— Të lumtë goja! Me fund ta pimë, ta pimë për Partinë, o shokë! — thirrën miqtë e njerëzit e të dy shtëpive që ishin në hasmëri, me të cilët Tekiu kishte biseduar shumë herë për të thyer kokëfortësinë dhe papërkulshmërinë e tyre dhe më së fundi ia kishte arritur.

Ky lajm i gëzuar u përhap kudo dhe fshatarët për herë të parë shikonin te partizanët jo vetëm luftëtarët e lirisë, por edhe mbrojtësit e jetës e të pasurisë së tyre. Çeta e Gorës, kur ia sillte rasti, ndërhynte në çështjet e brendshme të fshatit për të zgjidhur çdo keqkuptim e ngatërrësë që mund të sillte përfundime të këqija. Nga ana tjetër, fshatarët panë karakterin thellësisht popullor të Luftës Nacionalçlirimtare kur partizanët hapën kosheret me misër të spahinjve e ua shpërndanë popullit, i cili, duke pasur ndihmën e tyre e të njësiteve guerrile, jo vetëm preu çdo marrëdhënie me armikun e veglat e tija, por kundërshtoi në mënyrë të hapur ose të maskuar, pagimin e taksave të shumta si vergji, xhelep, të dhjeta e të tjera.

Si pasojë e këtyre veprimeve, një ndjenjë pasigurie kapi autoritetet e vendit. Ata e kishin ndjerë me kohë se fshatari ishte ftohur, nuk qe më i pari dhe bisedonin midis tyre: «Vegjëlisë i është rritur mendja dhe s'flitet me gojë». Dhe për këtë kishin të drejtë. Fshatarët rrinin larg tyre, i shikonin me sy të dyshimtë dhe në fytyrë u lexohej urrejtja.

ÇLIRIMI I KRAHINËS SË GORËS

Aktiviteti i çetës së Gorës dhe i njësiteve guerri-rrile të fshatrave bëri të pamundur qëndrimin e postkomandës në Kucakë. Në fund të nëntorit ajo u largua se pati frikë të rrinte në atë fshat ku do të festohej 30-vjetori i shpalljes së pavarësisë.

Njerëzit drejtoheshin për në Kucakë, se kishte ardhur dita që flamuri i Ismail Qemalit të ngrihej edhe më lart dhe të valonte si dikur më 28 Nëntor 1912, madhështor e krenar, i lirë e i papërlyer.

Në sheshin e fshatit, në një atmosferë të gëzuar, u organizua një mbledhje. Në zërin e komisarit, që dukej sikur kumbonte e vinte nga larg, ringjallehin ngjarjet e kalonin njëra pas tjetrës luftërat e përgjakshme të të parëve tanë, përmendeshin emrat e heronjve të Rilindjes, të cilët zgjonin në zemrat e dëgjuesve shpresa, besim të patundur. Fshatarët e dëgjonin me gojë hapur atë që u fliste dhe fjalët e tija sikur u jepnin krahë. U kënduan këngë patriotike dhe më në fund fshatarë e partizanë hodhën valle e kënduan deri natën vonë. Atë ditë rreth njëzet djem të rinj e të gëzuar nga Korça e fshatrat përreth u bashkuan me çetën e Gorës. Të nesërmen, çeta u drejtua për në Strelcë, shqeu dyert e depove dhe ua shpërndau bereqetin fshatarëve, se atje ku jeta e varfër rrëzohej, çante rrugë e ngrihej si bar i njomë, jeta e re.

Koha ishte shumë e përshtatshme: frynte një erë e fortë dhe e ftohtë. Rruga që mbushur me borë. Atje, pas kurrizit të malit, kur po zbardhte dita, çeta e Gorës u vërsul si dragua për të shfarosur këmi-shat e zeza e tradhtarët që bënë ende qëndresë në Gorë. Partizanët rrethuan postkomandën e Moçanit. Ajo që ndodhi ishte aq e papritur për karabinierët e milicët, sa që shumë prej tyre u detyruan të dorëzoheshin më parë se të kuptonin se ç'ngjiste. Kjo fitore i bëri me krahë luftëtarët. Të njëjtat ndjenja kishin prekur, siç dukej, edhe banorët e fshatit, të cilët ishin çliruar nga robëria fashiste dhe këndonin e kërcenin si në festë...

Në malet e Gorës e të Oparit nuk mbeti më këmbë fashisti. Gjatë muajve nëntor e dhjetor në këto dy krahina u formuan edhe gjashtë çeta të tjera. Në fund të vitit 1942, në qarkun e Korçës gjëmonte hapi çlirues i njëmbëdhjetë çetave të rregullta partizane, të cilat nuk linin vend pa mbjellëfarën e luftës antifashiste.

VEPRIMI I PARË DHE I MADH LUFTARAK NË VOSKOPOJË

Zgjerimi i Lëvizjes Nacionalçlirimtare në të gjitha aspektet e saj, sidomos në atë ushtarak, kishte krijuar mundësinë për një zhvillim më të madh të luftës së armatosur. Për t'iu përshtatur kushteve të reja që vetë koha i kërkonte, Komiteti Qarkor i Partisë, në fillim të muajit janar të vitit 1943, udhëzoi të ndërmerreshin aksione më të guximshme edhe më të gjera për të asgjësuar formacionet e mëdha të armikut të përqëndruara në postën e avancuar të Voskopojës, që hynte si pykë e pengonte ndërlidhjen e manevrimin e lirë të forcave partizane në vendet e çliruara, nga Gorë-Opari për në zonën e Vithkuqit dhe të Kolonjës.

Për të kryer këtë porosi, disa çeta partizane bashkë me njësitet guerrile të fshatrave, marshuan në drejtime të ndryshme për të mbërritur në fshatrat Dolan dhe Zvarisht të Gorës.

Në mbrëmjen e 14 janarit, partizanët u pritën me përzemërsi nga fshatarët. Bisedimet kalonin nga një ngjarje te tjetra dhe sillnin me vete gëzimin në çdo shtëpi. Fëmijët e vegjël nuk thërrisnin e nuk qanin ashtu siç e kishin zakon: rrinin urtë pranë partizanëve dhe vështronin me habi armët e tyre, duke pritur me durim se mos ua jepnin në dorë.

Jo vetëm ata, por edhe më të rriturit atje i kishin sytë.

Në një dhomë të madhe ku qenë mbledhur komandantët dhe komisarët e gjashtë çetave partizane të Gorë-Oparit u lexua vendimi i Komitetit Qarkor të Partisë, u caktuan çetat që do të merrnin pjesë dhe u komunikua shtabi i drejtimit të luftimeve. Pastaj e mori fjalën Tekiu, i cili propozoi ndarjen e forcave, vendet nga do të fillonin grupet e sulmit, objektivat e goditjes dhe detyrat e mëtejshme të veprimeve luftarake.

Të gjithë sa ishin atje dëgjonin në heshtje dhe me vëmendje. Kur ai mbaroi së foluri, filluan diskutimet, sipas të cilave ata hartuan planin e veprimeve midis tyre me celulën e Partisë në Voskopojë e njësitin guerril dhe morën masa të tilla që fashistët, po të mbroheshin, ta shisnin shtrenjt dorëzimin e një vendi me kaq rëndësi.

— Hajde djema, merrni një sy gjumë, sepse çdo gjë do të shkojë mirë... — tha njëri nga pjesëmarrësit.

Kur shokët ranë për të fjetur, Tekiu doli jashtë në natën e errët.

Nëpër borën e dendur, ai shkonte përpara me fytyrë të ngrirë nga thëllimi dhe me duart në xhepa për të kontrolluar rojet që bënë shërbimin. Në fshat u kthye vonë. Shtëpitë qenë të heshtura dhe s'kishin dritë. U fut në dhomë, gjeti një vend të vogël, u shtri midis shokëve dhe me zor e zuri gjumi.

Të nesërmen, rrugët e fshatit kishin lëvizje të madhe. Dita e 15 janarit kaloi me përgatitje deri në natën vonë. Në dhomën e shtabit operativ, flaka e zjarrit hidhte një dritë të paktë. Të gjithë flinin dhe

atje nuk dukeshin veçse ca hije të ngatërruara. Papatmas Tekiu u zgjua, pa orën, dhe, si njeri që i pëlqente shumë përpikmëria, ngriti shokët.

— O burra të ngrihemi, se për pak gdhahet, — u pëshpëriste shokëve ëmbël, kur shikonte sytë e tyre që mezi hapeshin nga gjumi.

Urdhri për t'u nisur u dëgjua nga të gjitha anët. Partizanët dolën jashtë në rrugë dhe u dha komanda për marshim. Ecnin në varg njëri pas tjetrit, duke shkelur mbi gjurmët e pararojës që shkonte përpara me hapa të rëndë, nëpër rrugë të ngushta. Këto vende ata i njihnin, por shpesh këmbët u fundoseshin gjer në gjunjë në borë.

Iu afruan Voskopojës tamam në kohën kur errësira e mëngjesit po ia linte vendin një agimi të zbetë, ku mund të dalloje vetëm degët e pishave që fëshfërinin me një zhurmë të shurdhër. Më vonë, dalëngadalë, drita i përçau retë si me përtim dhe, kur dita e 16 janarit zbardhoi, u duk fshati i përgjumur.

Gjithçka ishte mbuluar me borë. Sipas planit të veprimit, partizanët ishin vendosur midis Shën-Prodhomit, në veri, kodrave deri te Çezma e Floririt, malit të Kostë Mandos në jug, duke u shtrirë gjer tek Ura e Kovaçit në lindje të fshatit, që lidhte rrugën automobilistike Korçë-Voskopojë.

Ishte qetësi. Tufani dhe bora kishin pushuar. Asgjë nuk lëvizte. Luftëtarët prisnin me padurim sinjalin. Kur u dëgjuan tri të shtëna të pushkës, me shpejtësi rrufeje ata u hodhën në sulm, duke kaluar midis blloqeve me gurë dhe pa e pasur mendjen as te cikma e vrazhdët, as te këmbët e ngrira në opingat që u fundoseshin nëpër borën e ftohtë e të ngrirë.

Në këtë kohë, shokët e celulës së Partisë e një-

siti guerril i fshatit dolën nga shtëpitë, u bashkuan me partizanët dhe, sipas detyrave që kishin marrë, u ndodhën përreth ndërtesave të komunës, të karabinierisë e milicisë dhe breshëria e zjarrit u përqëndrua kryesisht kundër kazermave.

— Po na sulmojnë! Po vijnë partizanët! — gjëmoi kjo fjalë ndërmjet 80 milicëve që, të kapur nga paniku, u nënshtroan dhe u çarmatosën. E njëjta gjë ndodhi dhe me karabinierët italianë, të cilët, megjithëse i kishte zënë frika, u lëshuan drejt telefonit për të kërkuar ndihmë nga Korça, por vija ishte prerë që në agim. Ndërkohë, dëgjuan një zë që i ftonte të dorëzoheshin. Çaste të vështira për ta. Çfarë të bënin? T'u hapnin krahërorin plumbave... Jo! Fashisti nuk bënte kurrë ashtu. Duhej kursyer gjaku. Për të, e vetmja rrugë shpëtimi ishte dorëzimi. Dhe kështu u bë. Porta u hap dhe të gjithë u çarmatosën.

Të tjerë partizanë rendnin për nga godina e burgut. Hapën dyert dhe nxorën 14 të burgosur politikë.

«Shokë, dilni, dilni shpejt!»

Të burgosurit u hodhën në qafë të partizanëve dhe disa s'i mbanin dot lotët.

Në fshat filluan të përplaseshin dyert dhe njerëzit vraponin nëpër rrugë.

— Shyqyr që na erdhi kjo ditë!.

— Shyqyr vërtet... erdhi koha të qërohen.

— Tanët ndoshta janë në kazermë, se pushkët po rrallohen.

— Mundet!

— Atëherë, si thua, a shkojmë? — i tha një plak shokut të vet. Me të dalë në rrugë, takuan një djalë nja 12 vjeç.

— Pa na thuaj, mor bir, a u dorëzuan?

— Posi, — tha djali me një zë gazmor... —
Tërë fshati atje është mbledhur, kurse ju akoma nuk e dini!

Të dy pleqtë u vështruan në sy dhe njëri prej tyre, që quhej Miti, u mundua t'i përgjigjej djalit si me të qetë për t'i vënë fre kureshtjes së tij:

— Ajo s'të hyn në punë ty, o djalë, po ikë, — i tha i vendosur dhe, pasi i thirri Ligorit ta ndiqte, shkoi përpara si ndonjë njeri fodull që shet nga pak mend.

Voskopoja buçiste nga vallet, këngët, të qeshurat dhe britmat. Ajo festonte fitoren. Rrugët zienin nga njerëzit që i binin fshatit poshtë e lart, duke shprehur gëzimin e madh që ndjenin. Fëmijët u dilnin përpara partizanëve, i nduknin nga rrobat, ndërsa fshatarët i ngjatjetonin, i përqaфонin, u shtrëngonin duart, sikur t'i njihnin me kohë.

Kur pleqtë iu afruan qendrës së fshatit, u çuditën dhe mbetën me gojë hapur nga ajo lëvizje aq e madhe, jo e zakonshme. Atje s'të zinte syri veçse njerëz me veshje të ndryshme: pallto arna-arna e xibunë, binza e xhaketa të holla tepër të vjetëruara, kësula e kapela me yll, bohçe e trasta prej leshi të dhirtë, shajaku e kanavaceje të hedhura në sup, rripa, vezme e gjerdanë fishekësh, këpucë e opinga me lëkurë lope ose kau dhe pushkë të çdo lloji. Një përzierje e çuditshme veshjesh ushtarake e civile.

«More, more! Sa shumë qenkan!» — foli Ligori me vete dhe bëri përpara, se Miti ishte afruar te kangjellat e postkomandës e po shikonte me vërejtje katër partizanë që bisedonin në krye të shkallëve.

— Po ata, o Miti, kush janë? — pyeti Ligori.

— Partizanë janë, pse ç'pandeh të jenë?

— Jo kot... po Tekiu ku do të jetë, vallë?

— Ku do të jetë, thotë!.. Ta merr mendja, brenda do të jetë bashkë me komisarët, — ia priti prapë Miti që nuk priste ta pyesnin dy herë. Ligori e vështroi me bishtin e syrit, duke u çuditur se sa mirë i kuptonte ai punët e komandantëve dhe i tha:

— Jo, more! Po çfarë kurdisin, vallë? — Mirëpo nuk priti përgjegje se pranë i kaloi një partizan, të cilin e pyeti:

— O shok, ku është Tekiu?

— Pse, nuk e njihni?

— Namin ia kemi dëgjuar, por...

— Ai që është në krye të shkallëve...

— S'është e mundur, — kundërshtoi Miti. — Kapedan ky dhe të mos ketë as mustaqe, pa lere mjekër!..

Partizani vuri buzën në gaz dhe si i çuditur u largua nga pleqtë, të cilët e vështruan me pakënaqësi.

— More, Miti! — foli Ligori — Ai duhet të jetë.

— ...

— Tani nuk jemi në kohën e Çerçizit dhe të Mihalit kur ishe edhe ti komit me fustanella, xhamadanë, gjerdanë e tirqe të gjata.

Miti, që i kishte hipur gjaku në kokë, nuk e la të vazhdonte, por iu përgjigj me inat:

— Mos më trego ti atë kohë. E di mirë unë se veshje si ato, mjekër e flokë të lëshuar mbi supe, sot nuk ka... por të paktën të kishte mustaqe dhe jo kështu... — Ktheu kokën, e soditi mirë e mirë atë trup kapedani me veshjen e tij të thjeshtë që nuk shquhej aspak nga të tjerët dhe, kur Tekiu hyri brenda, u përmend e foli:

— Megjithatë, o Ligor, i paska hije pushka në dorë këtij kapedani dhe jo llafe!

— Demek, ta mbushi syrin, ë!

— ...

— Shqipëria për njerëz të pushkës nuk vdes kurrë, o vëlla.

Miti, kur dëgjoi këto fjalë, ngriti kryet lart, vështroi nga malet dhe me një zë që i doli nga shpirti tha:

— Ashtu është, o Ligor. Lind trima ky vatan! Dhe, si drodhi njëherë mustaqet e thinjura, i ra kraheve Ligorit dhe të dy shkuan të kënaqur për në shtëpi. Rrugës takuan bashkëfshatarë që kalonin grupe-grupe ose dy nga dy, me bereqet ndër duar dhe me fytyra që u shkëlqenin nga gëzimi.

— Shkoni nga depot e dhjetarëve, — u thirrën ata dhe pleqtë, kur arritën atje, panë disa djem nga fshati e nga të këshillit që u shpërndanin fshatarëve drithë, sipas frymëve e gjendjes ekonomike të tyre. Kjo pamje i preku aq tepër, saqë në heshtje qeshnin, tundnin kokën, gëlltisinin lotët e s'ngopeshin së shikuari.

*

* * *

Në kazermë ishte qetësi. Milicët dhe karabinierët prisnin me kureshtje se ç'do t'u thoshte komisari, i cili ia filloi me këto fjalë:

— Disa nga ju kanë thënë se janë të gatshëm të luftojnë me ne, por me kusht që t'u jepet rrogë, pasi janë nevojtarë... Të tillë njerëz Partia jonë i përbuz. Në radhë të parë, ajo kërkon që çdo njeri të kuptojë mirë se kush luftohet e kush mbrohet, se çfarë do të zhdukë dhe çfarë do të sjellë kjo luftë



për vendin tonë. Ne, që kemi lënë çdo gjë dhe kemi rrokur pushkën, luftojmë se s'duam të durojmë pushtues, kusarë e maskarenj në shtëpitë tona. — Shumë nga ata e dëgjonin me vëmendje dhe interesim. Këtë e shihje në fytyrat e tyre dhe në vështrimin e çakërdisur. Komisari u ndal pak dhe pastaj vazhdoi:

— Në luftë shkohet me ndërgjegje të pastër. Ata shqiptarë që presin t'u jepen të holla për të luftuar kundër pushtuesve e tradhtarëve të vendit, bëjnë tregti me jetën e tyre dhe me lirinë e popullit. Në këtë mënyrë ata përuhin dinjitetin jo vetëm të vetvetes, por edhe të atdheut, sepse gjaku i njeriut nuk shitet, veçse jepet me vetëdije kur është puna për shpëtimin e kombit. . . Mendohuni mirë. Në pastë midis jush burra të guximshëm, të ndërgjegjshëm, mbrojtës të vërtetë të popullit, jo për sy e faqe, por njerëz të vendosur për të luftuar krah për krah me ne, le ta thonë. Ne nuk i largojmë kurrë ata që, si dhe ju, kanë qenë gënjyer nga fashistët. Ja, tani ua shpjegova të gjitha. Sa për të tjerat, bëni si dini vetë. . .

Kur mbaroi së foluri, shumë milicë, me komandantin e tyre në krye, u bashkuan me forcat partizane dhe më vonë s'u penduan aspak që u hodhën në rreshtat e lavdishme të Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Të tjerët dorëzuan armët, duke u zotuar se nuk do ta përsëritnin gabimin që kishin bërë. Midis tyre bisedonin:

— Hajde të folur!

— Për besë!

— Unë do të shkoj njëherë në shtëpi, t'i shikoj ata të mitë si janë andej, pastaj duke parë e duke bërë. . .

* * *

Gjithë materiali që u kap, u transportua me kafshë në thellësi të krahinave të çliruara, kurse aktet e administratës u dogjën.

* * *

Lajmi se partizanët pushtuan Voskopojën, siç dukej, e egërsoi aq fort komandën fashiste në Korçë saqë aty për aty nisi me të shpejtë rreth 200 ushtarë, milicë e karabinierë, nën komandën e një majori italian dhe oficerit të milicisë Sali Pilurit. Këta, pasi erdhën me makina deri në Voskop, vazhduan rrugën në këmbë. Terreni i tokës shumë i thyer i ndihmoi ata që, pa u diktuar, të mbërrinin nga mesdita në krye të kodrave në fushë të Voskopojës, midis Urës së Kovaçit e Çezmës së Kuqe. Kur u duk te kthesa e rrugës pararoja e tyre, sytë e mprehtë të skuadrës vrojtuese partizane e panë dhe e pritën me zjarr.

Në Voskopojë çetat ishin shpërndarë për të ngrënë drekë, por me të dëgjuar të shtënat e para, rrëmbyen armët, dolën nga shtëpitë dhe u derdhën nga të gjitha anët për në qendër të fshatit. Ndërkohë të shtënat u shtuan më tepër e dukej sikur ato qenë përqëndruar në një pikë të vetme dhe vinin nga përpara. Mirëpo edhe mitralozi i Naumit buçiste me një zhurmë të mprehtë.

— Skuadra është e gjallë dhe po e mban rrugën. Fashistët s'po e kursejnë municionin për të shpër-

ngulur dhjetë vetë, — i tha Tekiu shokut që kishte pranë dhe, pa humbur kohë, dërgoi dy çeta në drejtim të Shipckës e Krushovës për të mbrojtur krahët nga ndonjë sulm që mund të vinte nga ana e Lozhanit. Pastaj, pa pritur të tjerët, me një pjesë të shtabit operativ dhe me partizanët që ishin mbledhur, u nis në ndihmë të shokëve që kishin filluar një luftim të pabarabartë. Lufta sa vinte ashpërsohej. Kur kapërcyen urën e parë më të dalë të Voskopojës, një borë e imët filloi të shkëputej nga retë dhe era dukej sikur ndryshonte: herë frynte nga përpara e të merrte frymën e herë anash dhe, si duke u tallur, përllante shtëllunga bore që u zinte gojën e hundët. Më së fundi mbërritën pranë skuadrës që ishte ngulur në atë kodër dhe nuk tundej. Tekiu u thirri:

— Guxim, guxim, o shokë! Mos shtini veçse kur të vijnë pranë.

Sa të bën mirë në këto minuta të vështira një fjalë që të jep zemër! Ata ishin të qetë. Tekiu ishte me ta. E shihnin, e dëgjonin dhe ishin të sigurtë se puna kishte për të shkuar mirë.

Armiku, i fshehur anës rrugës dhe pranë ledheve me gurë, filloi të afrohej duke u mbrojtur nga të shtënat e mitralozave të rëndë.

Pađurimi e shtynte Naumin të hapte zjarr, po e mbante veten. Duke ndjekur me sy çdo lëvizje të fashistëve, i dukej sikur dëgjonte zërin e Tekiut që i thoshte: «Prit! Prit! Leri të afrohen». Kur rreshtat e para shpejtuan hapin, atëherë breshëria e plumbave të mitralozit të lehtë italian si dhe pushkët partizane, lëshuan një batare zjarri që kaloi si stuhi mbi kryet e tyre. Në rrugë u dukën lëvizje të çrregullta.

Në këtë kohë, nga Voskopoja mbërritën të tjerë partizanë. Tekiu, duke parë se vendi ishte tepër i ngushtë, kufizonte pamjen e fushës së qitjes dhe nuk lejonte vendosjen e forcave, bisedoi me shokët për t'u shpërndarë në të dy krahët, nga jugu e veriu dhe, kur ai të hapte zjarr nga kodra e Çezmës së Kuqe, atëherë ata të hidheshin në sulm. Propozimi u pëlqeu edhe anëtarëve të shtabit dhe ata menjëherë u vunë në lëvizje.

Tutje në veri, në kyçet e udhëve e të qafave, pranë përroit nga ana e Shën-Prodhomit, atje ku ishin në varg e larg njëra-tjetrës 6-7 çuka me gurë të mëdhenj si edhe nga krahu tjetër, në jug, ku terreni ishte me rrëzime, partizanët vraponin me të katra për të zënë pozicione të përshtatshme luftimi dhe për t'i marrë krahët armikut. Këtë manevrim po bënte edhe kundërshtari. Pas pak, nga të dyja anët u dëgjua një shkëmbim i fortë zjarri.

Tekiu bashkë me tre partizanë të tjerë ecte shumë shpejt përpara, drejt lindjes, në rrugën këmbësore që gjarpëronte gjatë derdhjes së përroit të Lavdarit. Këmbët i hidhte me lehtësi dhe të tjerët, njëri pas tjetrit, i vinin pas. Kur mbërriti rrëzë kodrës, djersët i shkonin çurk, por shkoi me zemër drejt majës, duke e kuptuar se nga qëndresa e tij varej tani përfundimi i kësaj lufte. Ndërkohë, edhe nga ana e kundërt e kodrës ngjitnin të përpjetën për të arritur në majë disa milicë e karabinierë. Në krye të tyre printe Sali Piluri, i cili vraponte me grahmë dhe me gulç. Kush, vallë, do të mbërrinte i pari në kodër nga të dyja palët? Dukej sikur edhe pak minuta dhe tmerri i vdekjes do t'i rrëmbente ata që pothuajse kishin arritur pranë majës. Më tej jeta ishte vetëm punë sekondash.

Dhe në krye të kësaj kodre me lartësi mbi 1 200 metra, i pari arriti Tekiu. Ai nuk mundi të qëndronte sado pak as për të marrë frymë, sepse përpara, në anën tjetër të kodrës, jo shumë hapa larg, pa një trup të kërrusur fashisti me një mitraloz të lehtë, që ecte me gojë hapur, me shikim nga maja e kodrës dhe dukej se për pak do t'i pëlciste zemra. E njohu oficerin fashist dhe nuk vonoi ta shënonte. Krisma e pushkës oshëtiu shurdhër ndërmjet ma'leve dhe një flakë e bardhë vetëtiu para syve të fashistit, i cili u rrëzua përdhe duke lëshuar një ulërimë të tmerrshme. Plumbi i kaloi përtej gojës, pa i dëmtuar asnjë dhëmb. Pas tij, i nipi u bë gati të qëllonte, por nuk mundi dot, se dhe ai mbeti i vrarë në vend. Të tjerët i ktheu prapa tmerri i vdekjes dhe ua mbathën këmbëve duke braktisur komandantin e tyre të vrarë.

I hedhur e i shkathët, Tekiu rrëmbeu nga duart e banditit mitralozin, e vendosi në një gropë pranë partizanëve që kishin zënë pozicione dhe hodhi sytë në rrugë. I pa fashistët oë ishin rreth 200 metra larg nga kodra dhe thirri:

— Zjarr!

Krisma të tmerrshme shpërthyen njëherësh nga kodra. Armiku u godit befasisht nga një largësi tepër e vogël. Shpërthyen ulërimat. Para dhe anash zjarr. Pas shpine zjarr, pas shpine vdekje. Në çaste të tilla të gjithëve u tronditen nervat. Kjo është një goditje psihike. Goditje në tru, në shpirt! Vështrimet u ngulën mbi këtë kodër që nuk ishte kodër, por vdekje për armikun, i cili për një çast u hutua, u shtang në vend, u gozhdua pranë ledheve me gurë dhe nuk pati mundësi të ngrinte as kokën. Më vonë, i përçarë dhe i frikësuar, armiku u fut nën urën e ma-

dhe të Çezmës së Kuqe e në përrrenjtë e Gurit të Zi, të Shelgut e të Mustafallarit. Një kthesë të tillë të luftës asnjëri s'e priste.

«S'është vështirë të luftosh kur fitorja atje larg të buzëqesh, — thoshin partizanët. — Lufta atëherë të rrëmben vetvetiu».

Në këtë betejë Tekiu u tregua luftëtar i vërtetë, trim dhe inteligjent. Nuk ishte punë e lehtë t'i afroheshe fshëhtazi armikut, të kërkoje çastin e përshatshëm dhe t'i hidheshe në shpinë...

Tani ishte e qartë se fashistët nuk do të qëndronin gjatë në rrugë. Zjarri u dobësua së tepërmi, u bë më i rrallë dhe, kur dita ishte në të sosur, u shua fare. Po të rrinin akoma, armiqtë do të vriteshin të gjithë, prandaj nuk u mbetj tjetër veçse të kthenin krahët duke lënë të vrrarët e të plagosurit dhe të iknin si bagëtia, ku sytë këmbët, drejt Korçës ku mund të gjenin shpëtim.

Paniku është një sëmundje ngjitëse. Të rrëmbyer, të hutuar dhe të lemeritur kaluan gjatë rrugës duke shtyrë njëri-tjetrin. Gjithkush shikonte veten e tij. Këmbët vraponin si makinë dhe, të shtyrë nga frika, braktisnin armatimet e municionet. Ikë të ikim! Nuk kishin veçse një dëshirë: të shpëtonin sa më shpejt nga vdekja që i ndiqte hap pas hapi.

— Mos i lini të ikin! Mos i lini! — thërrisnin partizanët duke rendur pas tyre, por nuk shikonin asgjë, sepse ishte errësirë dhe rruga ishte plot kthesa. Me fytyra të lagura e të ngrira nga të ftohtit, partizanët u kthyen në fshat duke vënë përpara 20 robër që ecnin me sy të ulur, si një bandë kusarësh.

Armiku, përveç të plagosurve, në këtë luftë që zgjati rreth tri orë, la 18 të vrrarë, midis tyre koman-

dantin e operacionit major Romeon dhe xhelatin faqezi Sali Pilurin. Forcat partizane patën dy të plagosur, nga të cilët Sami Gopeshin, i cili vdiq më vonë nga plagët e rënda.

Të nesërmen në mëngjes, pushtuesit dërguan aeroplanë, të cilët bombarduan fshatin, duke shkaktuar viktima në popull dhe dëme në banesa.

Pas kësaj lufte, çetat e Mokrës, të Gorës e të Oparit, asgjësuan edhe postën e Snosmit të Gramshit dhe më 2 shkurt 1943 shpartalluan një fuqi armike prej 200 vetësh që erdhi në ndihmë të saj. Gjatë luftimeve të ashpra, që zgjatën 4-5 orë, përveç të vrarëve e të plagosurve, u kapën 170 ushtarë e oficerë fashistë si dhe një sasi e madhe materiali ushtarak. Nga forcat partizane mbetën të vrarë dy luftëtarë.

Me këto luftime, Lëvizja Nacionalçlirimtare në qarkun e Korçës hyri në një fazë të re të zhvillimit të saj, sepse në luftë kundër armikut vepruan forca të bashkuara partizane, të cilat manifestuan guximin e trimërinë e partizanëve si dhe inisiativën e aftësinë e shtabeve komanduese. Por suksemi ishte shumë më i madh e më i rëndësishëm, sepse këto fitore ngritën moralin e popullit.

*

* *

Pas disa ditësh, Tekiu bëri me partizanët një mbledhje, në të cilën analizoi gjendjen e çetës. Ai foli për anët pozitive të betejave si dhe për të metat e gabimet që ishin vënë re. Midis të tjerave, ai tha:

— Inisiativa sa vjen e zhvillohet, po ashtu edhe shpirti sulmues, mirëpo kujdesi për shokët e rinj

nuk është në masën që kërkohet. Njerëzve në çdo kohë duhet t'u mësojmë taktikën e luftës: kur duhet të jenë të matur dhe kur të hidhen me guxim përpara, pa harruar për asnjë sekondë shokët e tjerë. Shokët duhet t'i ruajmë.

Tekiu tregonte kujdes të madh për partizanët e rinj. Ata i printe në aksione, u zhvillonte shpirtin sulmues, të guximit e të sakrificës dhe bënte përpjekje për t'u frymëzuar besimin në fitore. Nga ana tjetër, nuk harronte detyrën e tij si politike edhe ushtarake dhe nuk interesohej vetëm për njërën duke lënë mënjanë tjetrën, po kujdesej për të dyja në mënyrë të plotë.

Pas tij e mori fjalën i deleguari i Komitetit Qarkor të Partisë, i cili u kufizua vetëm në çështjet kryesore të gjendjes politike të brendshme e të jashtme, mbasi dita po mbaronte, bënte ftohtë dhe ato që do të thoshte nuk mund të lireshin për herë tjetër. Ai filloi të tregonte për shërbëtorët e qeverisë kukull që ndërroheshin me të tjerë, Merlikët me Eqerem bej Libohovët, për pavarësinë e luftën e popullit tonë që e kishin njohur të tri fuqitë e mëdha aleate dhe pastaj foli për ndryshimet që kishte sjellë ai fillim viti në botë. Midis të tjerave ai tha:

— Ballkani është bërë një vullkan i zjarrtë. Në të katër qoshet e Evropës kërcet pushka partizane. Në të gjitha frontet e luftës boshllit po i merren mendtë dhe po ha grushte të forta. Në tokën e Leninit e të Stalinit kuçedra fashiste ka ndeshur në hekur e në barut dhe mezi merr frymë. Përpara Stalingradit ka marrë goditje aq të rënda, saqë e ka shpënë në varr pjesën më të zgjedhur të ushtrisë së saj.

Çeta e Gorës i dëgjonte me vëmendje këto laj-

me të gëzuara, i merrte me vete për t'i shpënë fshat më fshat dhe për t'ua treguar njerëzve, se po afrohej dita që kishte për të shënuar fillimin e një epoke të re.

Në mbrëmje shokët u futën brenda njëri pas tjetrit. I deleguari i çarkorit kishte zënë vend dhe ishte zhytur në bllokun e tij të shënimeve: «Një nga detyrat kryesore që theksohen në Rezolucionin e Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar është problemi i gjaqeve, plagë e vërtetë shoqërore». Në këto pak radhë që lexoi, ai solli ndër mend bisedën që kishte bërë dikur me Tekiun dhe fjalët e tij i kumbuan ende në vesh: «... Dy muaj para lindjes sime, në një han të Korçës, një djalë më vrau me «hata» babanë. Siç thonë, ai ishte paguar nga Pasho Kolaneci. Dhe përse? Për arsye cmire, mërie, se njerëzit silleshin mirë dhe me respekt ndaj tim eti». — Ngriti kokën, vështroi nga Tekiu dhe mendoj: «Në këtë rrugë që s'është aq e lehtë, edhe ky ka kaluar çaste të vështira dhe është i gatshëm për të kryer çdo detyrë që t'i ngarkohet, duke përballuar çdo vështirësi!»

— Shokë, fillojmë, — tha sekretari i celulës dhe, kur zhurma e zërave pushoi mengadalë, e hapi mbledhjen me pak fjalë. Sipas rendit të ditës, të gjithë diskutuan për punët që kishin bërë. Midis tyre edhe Tekiu vuri në dijeni shokët si kishin shkuar bisedimet me Pasho Kolanecin¹.

— Në takimet që kemi bërë, — tha ai, — unë

1 — Më vonë Pasho Kolaneci u bë komandant i një çete balliste.

kam përshtypjen se Pashoja është i pavendosur e lëkundet. Hesht. Dhe, kur flet, bën shumë dredhira. Ai na tha: «Në kapelë dua zhgabë e jo yll, sepse atë shenjë e mbajnë komunistët». Ne iu përgjigjëm që të mbante pushkën, të luftonte armikun dhe po të donte të mos vinte asgjë në kokë, se në radhët tona ka gjithfarë njerëz, po ajo që na bashkon është lufta e përbashkët në të cilën secili zë vendin e vet. Këto fjalë e bindën disi, por aty për aty na e ktheu dhe tha: «Unë dua të bisedoj me të mëdhenjtë, me autoritetet tuaja dhe pastaj do të vendos».

— U takuat përsëri? — pyeti sekretari.

— Po. Në shtëpinë e Bajramit¹ në fshatin Goçë, u mbledhën përveç tre shokëve të ardhur nga Korça edhe rreth dyzet burra nga Gora, Opari dhe Rrëza. Atje u bisedua gjatë dhe nga mëngjesi, kur të gjithë vunë nderin e atdheut mbi gjithçka, Pashoja u ngrit më këmbë e para flamurit u betua: «Kush ktheftë, e vraftë Abaz Aliu». Në dhomë u dëgjua një zë: «Amin».

— Pranoi?

— Pranoi, por, në mos gaboj, kjo marrëveshje nuk do të sjellë asnjë përfundim, sepse edhe kësaj here na shkau si ngjala dhe kërkoi një takim tjetër në fshatin Këmbëthekër.

— Si shumë po e zgjat Pashoja, — thanë disa shokë.

Pas diskutimit të Tekiut, sipas porosive të Partisë, mbledhja e celulës vendosi:

a) T'i kushtohet rëndësi e madhe forcimit të

1 — Bajram Goça shkoi pas Pasho Kolanecit dhe formuan çetën e «Ballit» në ato anë.

lidhjeve me shtresat e varfëra të fshatit që janë baza, burimi e forca kryesore e Luftës Nacionalçlirimtare dhe të mos hiqet dorë nga përpjekjet për të tërhequr elementët patriotë.

b) Të demaskohet veprimtaria armiqësore e bandave balliste dhe të mënjanohen masat e popullit nga influenca e tyre.

NJË VIT JETË NË ÇETËN E GORËS

Sa bukur që këndonin! Zienin këngët e luftës dhe këngët popullore... Njëri ia merrte, një tjetër ia thoshte, ndërsa të tjerët mbanin zë. Fshati ishte në festë, sepse çeta e Gorës mbushte një vit nga dita e formimit të saj.

— Thirrja, vëlla, thirrja, — bërtisnin me krenari e entuziazëm partizanë e fshatarë, se askush nuk i këndonte me aq thjeshtësi, me aq zjarr e dashuri këngët popullore që flisnin për trimërinë e asaj çete që me pushkë në dorë kaloi nga aksioni në aksion, goditi kudo, pareshtur e me tërbim armikun e tradhtarët e vendit.

— Hapeni vallen, o shokë, — dëgjoheshin zërat.

Kënga buçiste. Vargu filloi të lëvizte dhe të hidhte këmbët. Të gjithë këndonin e hidhnin valle në këtë ditë të shënuar për çetën dhe popullin e kësaj krahine...

Kaloi një vit. Të paktë qenë ata partizanë që mbushnin një vit në çetën e Gorës. Disa kishin ardhur më vonë, të tjerë para pak kohe, por asnjëri s'i quante më shokë të rinj. Duke ka'uar javët e muajt, ata u mësuan me njëri-tjetrin, u afruan, hoqën çdo dallim midis tyre dhe së bashku u rritën me çetën e u bënë pjesë e saj e pandarë. Gjatë luftimeve të fundit, çdo njeri prej tyre pati rastin të tregonte trimëri

dhe të përballonte çdo detyrë e vështirësi. Pra, nuk qenë më të rinj. Ishin bërë të pjekur dhe kishin fituar një përvojë të mirë. Midis tyre ishte dhe Tekiu, që kishte dalë malit ndër të parët, atëherë kur lëvizja partizane ishte në lindje. Dhe Tekiu me krenari shikonte një nga një shokët e çetës së tij, Maqin, Mefailin, Dhosin, Xhavitin, Naunin, Raqin, Shabanin. Sa mirë i njihte ato fytyra të shtrenjta! Sa shumë i donte! Për të ata qenë shokë me kokë, besnikë, të sigurtë e të sprovuar në zjarr. Me ta e lidhte ideali i Partisë, ndjenja e respektit, e dashurisë, e miqësisë, sepse kishin bërë bashkë një rrugë të gjatë, të vështirë dhe ishin afruar njëri me tjetrin në luftë. Por edhe ata e donin si sytë komandantin e tyre. Duke dhënë vetë shembullin i pari, duke shkuar vetë në ballë, të gjithë shkonin pas tij. E quanin për nder të madh kur i merrte me vete për të kryer ndonjë detyrë sado të vështirë. Këtë Tekiu e dinte, prandaj mendohej njëloj për të gjithë, që asnjëri prej tyre të mos mbetej i fyer. Dhe në luftim ai e ndjente në çdo hap se sa me kujdes ndiqnin ata çdo lëvizje të tij e sa të gatshëm ishin t'i vinin në ndihmë, në rast se i kanosej një rrezik sado i vogël. Ai ishte për ta një nga shokët më të dashur. Tërë çeta e donte Tekiun dhe mburrej me të.

— Ju lumtë goja, o djema! — thoshin fshatarët. — Na gëzuat fshatin dhe na përtëritë shpirtin me këto këngë të bukura. Gjithmonë kështu ju pafshim, me këngë në gojë!

*
* *

Filladi i rrëmbyer i asaj pranvere mbante erë tym e zjarr. Si pasojë e aksioneve të pandërprera të çetave e të njësiteve guerrile, pushtuesit fashistë ndërtuan një rrjet të gjerë fortifikatash rreth kazermave, në objektet ushtarake dhe gjatë vijave të komunikacionit, sepse nuk e ndjenin më tokën poshtë këmbëve të tyre. Në qytete nuk ishin të qetë dhe jashtë tyre udhëtimet u bënë të rrezikshme, për të mos thënë të pamundura. Çdo ditë që kalonte ishte një disfatë për ta dhe Duçja, për të ruajtur sundimin e tij në Shqipëri, hodhi letrën e fundit në këtë lojë të çmendur. Mëkëmbësin e tij, Jakomonin, e zëvendësoi me gjeneral Parianin, me xhelatin që dinte të bisedonte vetëm me «gjuhën e zjarrit, të bajonetës».

Në këtë situatë të re, edhe reaksioni shqiptar u kryesua nga «Balli Kombëtar». Kriminelët e aventurierët që ishin në krye të çetave balliste, filluan me forcë e me të holla të rekrutnin njerëz në krahinat e Gorës e të Oparit. Fshatrat si Dushari, Moglica, Goça e Këmbëthekri ballistët i shndërruan në çerdhe të tyre, për të penguar e shkatërruar këshillat nacionalçlirimtare edhe në fshatrat e tjera, duke i vënë çdo shtëpie një «vulë» partizane ose balliste.

Pra, ishin pjekur kushtet për të vepruar pa vonesë dhe për të përfituar kohë.

Çeta e Gorës filloi të lëvizte me shpejtësi dhe mbas disa orë udhëtimi arriti në fshatin Plovisht. Para se të hynte në fshat, Tekiu bëri një mbledhje të shkurtër me partizanët, të cilëve u foli për kuj-

desin që duhej të kishin në rast se ndesheshin në ndonjë provokim nga njerëzit e «Ballit», të cilët kishin ngritur «këshillin» e tyre.

Ndër baza partizanët ndoqën me shumë vëmendje gjithçka që dëgjuan. Vunë re mirë përçarjen e fshatit më dysh si dhe «tarafet» e ngritura nga ndikimi i Bajram bej Goçës e Pasho Kolanecit, që së bashku kishin dalë në mal në krye të një bande prej 20 vetësh për të krijuar kaosin e anarkinë.

— S'ke ç'bën, — tha plaku i shtëpisë. — Kur rrokulliset një gur nga mali, shkrepat e grykës thërmohen dhe guri kushedi ç'heq me vete në humnerë.

— Koha, o xhaxha, — ia ktheu Tekiu, — do t'i mësojë njerëzit, dhe asnjëri nuk do të bjerë në kurthin e tyre.

— Ku ta dish, mbase ata hidhen me partizanët... — u hodh një nga fshatarët, por një tjetër ia preu fjalën dhe foli me të ashpër:

— Duhet të kemi kujdes. Njerëzve si Bajrami e Pashoja nuk u zihet besë.

— Ç'bela na gjeti! Po sikur të merremi vesh, more Teki? — pyeti fshatari që quhej Sali. Por Tekiu iu përgjigj:

— Ne mund të merremi vesh me njerëzit e «Ballit» vetëm në qoftë se ata luftojnë e gjakosen kundër armikut.

Dhe ata biseduan gjer natën vonë. Të nesërmen, në sheshin me plepa pranë vakëfit, partizanët dhe djemtë, burrat e fëmijët e fshatit ishin mbledhur e dëgjonin komisarin e çetës. Ai u tregonte se Partia në Konferencën e Parë të Vendit kishte vendosur që prej njësiteve partizane vullnetare të organizohej Ushtria Nacionalçlirimtare e rregullt, e cila do të luftonte me tërbim armikun dhe tradhtarët që ki-

shin marrë përsipër t'i jepnin ndihmë pushtuesit për të shtypur Lëvizjen Nacionalçlirimtare.

Fshatarët dëgjonin me vëmendje. Duke përfunduar, komisar i tha:

— Shokë fshatarë! Megjithëse shumë gjëra ju nuk i dini, përsëri nuk mund të mos ndjeni se cilët janë me ne e cilët kundër nesh. Armiqtë përpiqen të prishin këshillat nacionalçlirimtare, organet e pushtetit tonë popullor. Me daljen në shesh të çetave balliste, kanë filluar krimet, vjedhjet, çrregullimet, frikësimet për të dorëzuar të dhjetat e taksat si dhe rekrutimet me forcë e me të holla. Ballistët bredhin poshtë e lart nëpër fshatra, e kudo që venë hedhin farën e grindjes, të përçarjes, ndajnë njerëzit në dy pjesë kundërshtarë dhe çdo ditë mbjellin panik. Por hesapet i kanë bërë pa popullin e Partinë e tij, të cilët i kanë vënë në shenjë si pushtuesit ashtu dhe krerët e tradhtisë dhe mbi të gjitha kanë vënë nderin e atdheut. Prandaj edhe ju sot duhet të gjeni rrugën që nuk bie në kundërshtim me ndërgjegjen tuaj, kur është puna për atdheun. Në këtë rast lidhjet kombëtare janë më të forta se lidhjet personale, madje edhe të farefisit. . .

Fjalët e tij ndikuan te fshatarët. Kur mbaroi së foluri, u ndjenë zëra aprovimi dhe më në fund u zgjodh këshilli nacionalçlirimtar. Të rinjtë ishin të qeshur e të gëzuar, kurse më të moshuarit buzëqeshnin me drojtje. Vetëm një vëzhgues i mprehtë, mund të vërente se fytyrat e tyre nuk do të ndërrojnë sa herë që ndërrohte moti.

Si gjithë çetat e tjera partizane, edhe çeta e Gorës kishte mbi supet e saj detyra me rëndësi, të cilat duhej t'i kryente me kujdes të madh.

Dule Alarupi¹ me bashibozukët e tij u takua me çetën e Gorës dhe me një pjesë të çetës së Moravës në fshatin Osnat, ku kishte ardhur edhe Rrahman Zvarishti² si dëshmitar i «besëlidhjes» së 15 fshatrave të zonës së Malit të Thatë, që me forcë e mashtrime e kishte organizuar Dulja dhe e kishte bindur për të mos pranuar partizanë. Po fshatarët e Podgories, kundër urdhërave të tij, strehuan e ushqyen partizanët e çetës së Moravës dhe në mbledhjen para shkollës së fshatit, madje në prani të «parive» të fshatrave që solli ai vetë, rrëzuan «këshillin» që kishte bashkëpunuar me të, e zgjodhën një këshill të ri nacionalçlirimtar me elementë të vendosur. Për të gjitha këto, Dule Alarupi kërkoi këtë takim ku ndërmjet të tjerave tha:

«... Sipas marrëveshjes që kam bërë me zotin Rrahman, ajo zonë më është lënë vetëm mua dhe nuk dua të përzihet as me partizanët e as me ballistët».

Ky «bandill», që fliste sikur zona e Malit të Thatë të ishte çifliku i tij personal e kërkonte të hiqej si «zot» i asaj krahine, u përkrah nga Rrahman Zvarishti, i cili, me qëndrimin e tij prej oportunisti, e quante të drejtë këtë pretendim. Kur këta dy kri-

1. Dule Alarupi — komandant i një çete balliste.

2. Rrahman Zvarishti më vonë u bë komandant i një çete balliste.

minelë mbaruan së foluri, Rrahmani, duke e parë Tekiun në sy, e pyeti:

— Si thua ti?

Përbrenda diçka e ndrydhte dhe e shtrëngonte Tekiun, por në fytyrë nuk i dukej asnjë shenjë shqetësimi.

— Në këtë pikë, — iu përgjigj ai, — ne ndahe-
mi si qielli me tokën, o Rrahman. Deri dje, fsha-
tari ka vuajtur nën kamxhikun e beut dhe të agait
dhe është hequr prej kapistre si bagëti, por tani
ka ikur ajo kohë.

Kur e panë se nuk u eci fjala, Dulja e Rrahma-
ni u larguan nga mbledhja. Tekiu u tha shokëve:

— Kush fle me qentë, gdhihet me pleshta.

Edhe në fshatin Babien u bënë takime të tilla
me çetat balliste të komanduara nga Hamit Zboqi,
Hamit Shkoza, Nevruz Dalani e të tjerë, por populli
nuk ua vuri veshin dokrrave të tyre. Ai mbushi ra-
dhët e çetës së Gorës me partizanë të rinj dhe kjo
ishte përgjegjja më e mirë për ta.

Mbledhja e celulës së Partisë, që u bë në fund
të muajit prill, analizoi gjithë punën, bëri kritikë
e autokritikë, caktoi detyra dhe në fund arriti në
këto përfundime: të demaskohej edhe më fort qën-
drimi me dy faqe i «Ballit Kombëtar», të goditej
armiku kudo që të ishte dhe të shtoheshin radhët
e çetës me vullnetarë të rinj.

SULMI MBI LESKOVIKUN

Ato ditë fliste edhe natyra. Bredhat kishin filluar të lëshonin filiza të njomë dhe tufa zogjsh fluturonin në qiellin e kaltër ku nuk dukej asnjë re. Në këtë kohë, thirrja e Partisë gjeti një jehonë të madhe në popull, sidomos në rini për të shtuar radhët e luftëtarëve të lirisë.

Ç'gëzim e ç'lumturi! Tërë vendi u drodh, jo nga gjëmimet e topave, por nga britmat gazmore të njerëzve që këndonin këtë ditë maji se ishte krijuar batalioni «Ali Kelmendi», i pari batalion në qarkun e Korçës, me komandant Teki Kolanecin.

Më 9 maj 1943 në Voskopojën e djegur erdhën mbi 300 të rinj e të reja nga fshatrat dhe qyteti i Korçës, midis tyre edhe nxënës të shkollave të mesme që kishin lënë librat për të kapur pushkën. Pas mitingut të organizuar nga komiteti qarkor i rinisë, filloi regjistrimi i vullnetarëve të rinj, dhe 80 vetë u futën në radhët partizane.

Fytyrat e të rinjve shkëlqenin nga gëzimi. Ata qeshnin e këndonin bashkë me fshatarët e partizanët e çetave të Gorës, Oparit, Rrëzës, Moravës e Gramozit. Me vendim të Qarkorit të Partisë ata do të marshonin drejt Leskovikut, për të goditur armikun në atë nyje të rëndësishme rrugore.

Pas tri ditësh partizanët u larguan nga Voskopoja.

Në mëngjesin e 15 majit, në pyllin e Barmashit, çetat u ndanë në tri grupe e skuadra sulmuese, nga të cilat njëra shkoi me Tekiun dhe në orët e para të agimit të 16 majit Leskoviku u rrethua plotësisht.

Goditja filloi. Siç u duk, fashistët e prisnin një gjë të tillë, sepse u përgjigjën menjëherë me zjarr. Nga krismat e pushkëve, nga kërcëllima e mitra-lozave që prishën qetësinë e atij mëngjesi, banorët, të frikësuar, ishin ngritur nga jatakët dhe qenë mbërthyer pas dritareve për të dëgjuar luftën që ishte përhapur në të gjitha anët.

Luftëtarët kapërcyen rrethimin me tela dhe u drejtuan në tre objektivat ku ndodhej pushtuesi. Tekiu zvarritej përpara e tërhiqte pas vetes partizanët, atje ku plumbat i thyenin gurët si goditjet e qysqive dhe ku ndizej e ashpër lufta.

Karabinierët e ushtarët e rojës së financës, të tmerruar nga përparimi i grupeve të sulmit, lanë ndërtesat e tyre dhe u tërhoqën për në kazermat e ushtrisë. Një partizan u lëshua përpara e doli në një vend të hapur. Tekiu, që edhe gjatë luftës nuk harronte t'i ruante shokët e të ndiqte ndonjë veprim të gabuar që mund të ndodhte nga një trimëri e papjekur, e pa shokun e tij, bëri disa hapa përpara, u kthye anash dhe e qëlloi për vdekje fashistin që kishte marrë në shenjë luftëtarin...

Pushka kërciste ngado. Mitralozat e lehtë hapnin zjarr si në Leskovik ashtu edhe në Çarshovë. ku partizanët, të vendosur në prita, goditën një auto-kolonë armike që vinte nga Përmeti në ndihmë të të rrethuarve, të cilët, megjithëse pësonin goditje të vazhdueshme, mbroheshin mirë, qëndronin me këmbëngulje dhe nuk ishte e mundur të nxirreshin nga strofka e tyre. Fashistët kishin vënë në përdo-

rim të gjitha mjetet që zotëronin. Artileria e avia-
cioni villnin zjarr papushim. Plasjet të shurdhonin
e të verbonin sa nuk mund të ngrije as kokën e të
shënoje. Pas 15 orësh luftimi partizanët u tërhoqën
sipas urdhërit të shtabit të veprimit, duke pasur të
vrrarë vetëm tre luftëtarë.

Të nesërmen, në orën 5 pasdite, u dëgjuan të
shtëna në grykën e Shalësit. Çeta partizane e Kolo-
njës ishte ndeshur me fashistë që tërhoqeshin nga
Leskoviku. Dy orë më vonë vazhdonte rrugën drejt
Korçës një autokolona, por mbi Sanjollas ra i vrrarë
nga plumbi i Tekiut një karabinier që ishte në një
veturë bashkë me disa oficerë. Në këtë kohë auto-
kolona, që kishte arritur pas shumë përpjekjesh të
çante rrugën, u ndal. Asaj i ishte hequr mundësia të
bënte qoftë edhe një hap, pa u rrezikuar të binte në
prita. Në rreshtat e armikut, plasën plumbat parti-
zane.

Pas grushtit që pësoi pushtuesi, çetat u grum-
bulluan në pyjet e Vithkuqit. Shtabi i veprimeve
falënderoi partizanët për trimërinë që treguan në
këto luftime ku armiku pati 200 të vrrarë, shumë të
plagosur, 29 robër, midis të cilëve edhe një nënko-
lonel, 2 autoblanda dhe 25 makina të djegura.

Ushtria italiane, e tmerruar nga këto humbje të
mëdha dhe nga rreziku që e kërcënonte për ushq-
ime, pasi rrugët ishin prerë, u largua nga Leskoviku.
Më 25 maj forcat partizane hynë në qytetin e
çliruar dhe vendosën qetësinë e jetën normale.

TAKIME ME EMISARËT E «BALLIT KOMBËTAR»

Me kërkesën e «Ballit», për të sheshuar disa mosmarrëveshje, në fshatin Shipckë u grumbulluan shumë fshatarë, partizanë e ballistë. Si përfaqësues i «Ballit Kombëtar» për qarkun e Korçës kishte ardhur një bej nga qyteti, i cili ishte ulur në krye të vendit. Pranë tij, një ish-major i xhandarmërisë së satrapit Zog, me emrin Shefqet, një profesor i gjuhës anglishte në Liceun e Korçës, komandantë çetash dhe «paria» e fshatrave të Gorës e të Oparit. Në anën tjetër, rrinin: i deleguari i Komitetit Qarkor, shtabi i batalionit «Ali Kelmendi» me Tekiun në krye dhe disa burra nga «halija».

Biseda filloi. Një nga emisarët, me zë të çjerrë e me ndërprerje, për të bërë efekt, përsëriti fjalët e dëgjua mija herë:

— ... Ne nuk jemi në gjendje të luftojmë. Ç'mund të bëjmë me forcat tona që s'ngrejne asnjë peshë? Asgjë. Prandaj, ata dy plumba që kemi t'i ruajmë për në fund...

Por i dërguari i Komitetit Qarkor të Partisë i hodhi poshtë argumentet e kundërshtarit që mbronin me demagogji politikën e tradhtisë. Fjala e tij u dëgjua me vëmendje e bëri përshtypje. Energjia e serioziteti i tij u imponoi respekt të dërguarve të «Ballit». Ata pëshpëritën me njëri-tjetrin dhe lëvizën

me nervozitet, se s'po u rrihej në vend. Ndërkohë u ngrit Tekiu, hodhi sytë nga ballistët dhe iu drejtua atyre me këto fjalë:

— Ne, partizanët, jemi të sigurtë se midis jush ka patriotë që e duan atdheun, por disa njerëz ju gënjejnë me politikën e tyre «dale të presim» ose «hiqe mos e këput», bëjnë lodrën e armikut dhe s'duan çlirimin e popullit tonë. Mirëpo politika e drejtë e Frontit Nacionalçlirimtar do ta ndajë kashtën nga kokrrat. . .

Fjala e Tekiut ishte grushti i fundit për emisarët e «Ballit». Sytë u lëshuan shkëndija dhe fytyrat iu mbushën me njolla të kuqe. Beu u mat ta kundërshtonte Tekiun, por e kuptoi se po të thoshtë ndonjë fjalë do të ishte njëloj sikur të hidhte benzinë në zjarr. Heshti. Me një shprehje prej sfinksi në fytyrë, u ngrit dhe e peshoi me sy gjendjen. Në shesh bëhej zhurmë. Njerëzit diskutonin dhe u hidhnin romuze krerëve të «Ballit». Të zënë ngushtë, ata më në fund u detyruan të pranonin formalisht propozimin që çetat balliste të futeshin në përpjekje me armikun së bashku me forcat partizane. Mirëpo koha e provoi se ata nuk e mbajtën premtimin, sepse s'ishin burra të fjalës, as burra të pushkës, por njerëz të tradhtisë. . .

Ato ditë të muajit qershor, i deleguari i Komitetit Qarkor të Partisë zhvilloi një konferencë të gjerë me partizanët e batalionit «Ali Kelmendi». Midis të tjerave ai tha se, sipas udhëzimeve të Komitetit Qendror të PKSH, në Voskopojë ishte formuar Shtabi i qarkut të Korçës, i cili, nën drejtimin e Partisë do të organizonte e do të drejtonte veprimet e armatosura të çetave e të batalioneve partizane në krahinat e tija. Ky lajm u përhap edhe në krahinat e Gorës e të Oparit. . .

LUFTA KUNDËR GARNIZONIT ARMIK TË PËRMETIT E TË KUÇARIT

Për të kaluar në goditje më të mëdha kundër armikut, me porosi të Sekretarit të Përgjithshëm të PKSH shokut Enver Hoxha, forcat partizane të qar-kut të Korçës, Beratit e Gjirokastrës, u ngarkuan të sulmonin garnizonin fashist të Përmetit e të çliro-nin qytetin.

Pas një udhëtimi të gjatë më shumë natën se ditën, forcat partizane mbërritën më 28 qershor në fshatin Lupçkë. Atje u grumbulluan komandantët e komisarët e batalioneve e të çetave që do të merr-nin pjesë në aksion dhe nga udhëheqësit e të tri qarqeve u formua shtabi operativ, i cili, pasi shqyr-toi pozitën e armikut e mundësitë e luftimit, hartoi planin e operacionit. Si objektiv kryesor u caktua Kuçari dhe, deri në asgjësimin e kësaj qendre, u vendos të mbahej i rrethuar Përmeti; pritat parti-zane të kapnin të gjitha shtigjet e rrugët e komuni-kacionit në grykën e Mezhgoranit, në Qafën e Ki-çokut e afër Barmashit. Ky urdhër u komunikua dhe komandantët vunë në lëvizje forcat drejt objekti-vave. Për Kuçarin batalionet «Ali Kelmendi», «Hak-marrja» e «Themistokli Gërmenji» të shtabit të qar-kut të Korçës dhe përtej lumit të Vjosës çetën e Dëshnicës. Për Përmetin batalionin «Fuat Babani»

me një çetë të batalionit «Riza Cerova» të Skraparit. Në grykën e Mezhgoranit çetën «Koto Hoxhi». Në Qafën e Këçikut batalionin «Riza Cerova».

Në mbrëmjen e datës 1 korrik, filloi sulmi si në Kuqar edhe në Përmet. Partizanët me bomba dore goditën e vranë me dhjetëra fashistë. Duke përfituar nga rrëmuja që u krijua, partizanët bënë thirrje për dorëzim e s'e ndërprejnë për asnjë çast zjarrin. duke marrë në shenjë objektet që paraqiteshin më lehtë për t'u goditur. Nga ndërhyrja e rrufeshme dhe e guximshme, armiku u hutua, u trondit moralisht. shtiu pa rregull dhe nuk pranoi të dorëzohej. Megjithëse me forca të mëdha e mjete të fuqishme, ai nuk mundi të kundërsulmonte, qëndroi në mbrojtje duke përbaluar këtë stuhi që shpërtheu papritur dhe, që nga çasti i goditjes, inisiativa mbeti në dorë të forcave partizane.

Nëpër natën e errët, mitralozat vazhdonin të qëllonin. Fushqetat kërkonin të arrinin qiellin, dredhonnin dhe rrëzoheshin poshtë.

Të nesërmen, më 2 korrik 1943, vazhdonte sulmi rreth kazermave në të dy garnizonet. Megjithëse ai bëhej ngadalë, se fashistët qëndronin me këmbëngulje, unaza e rrethimit bëhej çdo orë e më e ngushtë. Të shtënat e pushkëve e të mitralozave shpërthenin furishëm dhe pas tyre kompanitë mblidhnin krahët e skuadrave, vërsuleshin përpara, shfrytëzonin me mjeshtëri terrenin, tregonin zotësi në zgjedhjen me kujdes të pozicioneve dhe përdornin me ekonomi municionin. Në sektorin ku vepronte batalioni «Ali Kelmendi», mitralozat e rëndë të armikut kishin një fushë qitjeje të gjerë, pengonin ecjen përpara dhe mund ta dëmtonin rëndë, në qoftë se komunistët me Tekiun në krye nuk do të tregonin moral të lartë, disiplinë e trimëri.

Në Mezhgoran, partizanët u penguan nga «Balli Kombëtar» e Ali Këlcyra dhe pozicionet nuk u zunë me kohë. Kjo vonesë shkaktoi që një pjesë e autokolonës që vinte për ndihmë nga Tepelena, të kalonte për në Kuqar. Pjesa tjetër e saj u godit ashpër dhe u detyrua të kthehej prapa. Fashistët, për të çarë rrugën, dërguan forca më të mëdha dhe në kohën kur ato mbërritën në grykën e Mezhgoranit, çetës së Zagorisë e forcave vullnetare të fshatrave fqinje, u erdhi në ndihmë çeta e Kurveleshit «Hajredin Tremishti» me komisarin trim Asim Zeneli, i cili ra heroikisht në vijën e parë të zjarrit, duke udhëhequr luftën dhe duke mos i lënë armiqtë të kalonin.

Ngado goditje. Edhe në Qafën e Këçokut u ndalua një autokolonë fashiste që vinte nga Berati në ndihmë të të rrethuarve të Përmetit. Një tjetër, që erdhi pas saj, u mundua të përqëndronte në drejtim të partizanëve një zjarr të dendur për t'i shtyrë sa më larg rrugës automobilistike, por pas një lufte të rreptë u dëmtua rëndë nga forcat e batalionit «Riza Cerova», megjithëse prapa krahëve kontrollohej nga «Balli Kombëtar».

Me mbërritjen e forcave armike në garnizonin e Kuqarit, shtabi operativ diti t'i bënte ballë situatës që u krijua. Forcat i kaloi menjëherë në veprime mbiojtëse, mbasi edhe aviacioni armik bombardonte e mitralonte pozicionet partizane. Vetëm një kompani e batalionit «Ali Kelmendi» nuk mundi të tërhiqej në pozicione të tjera, sepse një breshëri plumbash i kalonte mbi krye dhe e gozhdonte gjithnjë e më fort në vend. Komandanti i kompanisë disa herë me radhë u mundua të zvarritej duke tërhequr pas vetes shokët, por nuk vendoste të shkonte më tej dhe përsëri kthehej tek të tjerët. Përballë tyre qëndronte

një armik shumë herë më i madh në numër, i mbrojtur nga muret e kazermave dhe i sigurt në epërsinë e vet.

Në këto çaste tepër të acaruara, kur çdo sekondë ishte e shtrenjtë, Tekiu qëndronte në një vend duke vështruar me kujdes veprimet e kompanisë dhe vendet nga qëllonte armiku. Për të përballuar këtë situatë të dëshpëruar, duhej të merrte vendime të përshtatshme e të realizonte shpejt e me saktësi atë që kishte ndër mend. Dhe ai, si pjesëtar i shtabit operativ e komandant batalioni, mori një vendim të arsyeshëm: përqëndroi të gjithë zjarrin në dritaret dhe në çdo vrimë, nga e cila mund të dallohej e të vërehej, duke mos u dhënë mundësi fashistëve të qëllonin.

— Shokë, qitni me të dhënë urdhër! Gati, — u tha me gjakftohtësi partizanëve që qëndronin në pozicione nën rrezet përvëluese të diellit. Vetëm zbehësia e tij tregonte se sa përpjekje të mëdha të vullnetit i kushtonte kjo gjakftohtësi.

— Zjarr! — Të gjithë automatikët, mitralozat e pushkët u përgjigjën me një zë. Bataretë çorrën ajrin e nxehur dhe tërë vendi gumëzhiti nga krismat. Italianët e vendosur pranë dritareve nuk qëllonin, kishin frikë të nxirrnin kokën. Zjarri i tyre ishte paralizuar. Ndërkohë kompania u shkund, u përtërit, lëvizi shpejt dhe me lehtësi doli nga rreziku pothuajse pa humbje.

Kjo përleshje ishte e shkurtër, por e vështirë dhe mjaft e rrezikshme.

U err. Artileria villte zjarr papushim...

Për pesë ditë e pesë net fashistët u rezistuan sulmeve të partizanëve. Në orët e mesditës luftimet vazhdonin në pozicione, se bënte nxehtë si në fu-

rrë. Dielli digjte dhe përvëlonte. Mbyteshe në djersë, të piquej goja e digjeshe për ujë. Por edhe fashistët luftonin me dëshpërim e me shpirt në dhëmbë, duke përqëndruar zjarrin mbi çdo luftëtar që shkëputej nga pozicioni e bënte përpara. Në ndihmë u vinin aeroplanët, të cilët që nga mëngjesi e deri në mbrëmje bombardonin e mitralonin ulët. Por grykat e pushkëve partizane nxirrnin flakë pareshtur, zhvendosnin zjarrin nga një shenjë në tjetrën, zgjidhnin me saktësi pikat më të dobëta të kundërshtarit, shtinin me kujdes dhe mbanin me ngulm çdo pëllëmbë tokë. Më tej s'kishte mundësi të qëndrohej pa pësuar humbje të rënda. Municioni pothuajse ishte mbaruar krejt, ndërsa zjarri fashist kishte arritur kulmin e intensitetit të tij. Në këto kushte, shtabi operativ mori vendimin të shkëputej kontakti me armikun dhe të kryhej tërheqja e forcave.

Kur lufta kishte hyrë në fazën përfundimtare dhe në ditën e gjashtë tërheqja u bë në rregull të plotë, batalioni «Tomorri» e çetat vullnetare nga Kolonja, Panariti e Skrapari, që kishin zënë prita pranë fshatit Barmash për të ndaluar forcat italiane që mund t'i vinin për ndihmë Përmetit të rrethuar, sulmuan befasisht një mori makinash me trupa gjermanë që kalonin nga Korça për në Janinë. Lufta filloi e vazhdoi e rreptë për më se 6 orë. Për të parën herë bisha naziste u sakatua e u përgjak nga pushka partizane në grykat e Barmashit. Për hakmarrje, ajo u vërsul si e tërbuar mbi fshatin Borovë, të cilin e rrafshoi për tokë. Dogji mbi 100 shtëpi dhe vrau 107 vetë, aq sa gjeti. Dhe këtë lojë të përgjakur e vazhdoi fshat më fshat deri në Leskovik, sepse masakra ishte ligji i rendit hitlerian. Por popullin që kishte në zemër Partinë, nuk do ta mposhte dot.

Në kuadrin e veprimeve luftarake për çlirimin e Përmetit, gjermanët patën mbi 60 të vrarë, ndërsa fashistët italianë mbi 500, përveç të plagosurve, robërve e dëmeve në makina të djegura e materiale të tjera. Një humbje e tillë e tronditi aq shumë ushtrinë italiane, sa pas disa ditësh u detyrua të tërhiqej nga zona e Përmetit. Kjo ishte një fitore e rëndësishme ushtarake e politike e Luftës Nacionalçlirimtare. Populli e dhjetëfishoi urrejtjen e tij dhe, me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, zjarri i kryengritjes u ndez në çdo anë për të mos u shuar më kurrë.

*
* *
*

Më 20 korrik një grup partizanësh nga batalioni «Ali Kelmendi» u nis për t'u inkuadruar në radhët e Brigadës I Sulmuese. Midis tyre ishin shokët më të vjetër: Maqi Mita, Mefail Rozani dhe të tjerë.

— Nuk jua fsheh, shokë, se ndahem me hidhërim, se do të më zerë malli për ju... — u tha Tekiu duke mos qëndruar dot në një vend. Shtrëngoi rripin, kërkoi diçka nëpër xhepa... Ndoshta të gjitha këto ishin shenja të një hutimi të madh, apo mundohet ta zgjaste kohën e largimit të tyre. — Më në fund iu afrua, i përqafoi dhe i puthi.

Sa e rëndë është të ndahesh nga njerëz që i do! Sot partizanët ndaheshin nga batalioni i tyre. Atje ata lanë një pjesë të zemrës. Kujtime, shokë, shpresa, vuajtje e gëzime — një jetë e tërë dhe e plotë mbeti prapa krahëve. Po edhe përpara u çelëj një jetë si e para. Midis tyre, si qëllim i jetës qëndronte lufta për liri...

KAPITULLIMI I ITALISË FASHISTE

Njerëzit mblidheshin grupe-grupe dhe bisedonin. Asnieri nuk rrinte vetëm, të gjithë kishin dëshirë të flisnin, të pyesnin, të dëgjonin. Shumë prej tyre besonin se lufta nuk do të ishte e gjatë. E ndjenin afrimin e fitores dhe prisnin të ndodhnin ngjarje të mëdha.

— Po, në fund të fundit, lufta do të mbarojë, apo jo?

— C'është e vërteta, asgjë nuk dihet, — përgjigjeshin të tjerët me drojtje dhe jo me bindje të plotë.

Më 8 shtator Italia fashiste kapitulloi pa kushte. Ky lajm u përhap me shpejtësi dhe gëzimi qe shumë i madh. Fshatarët morën armët, dolën nga pragu i shtëpisë e bashkë me forcat partizane rrethuan fashistët në Maliq, për t'i marrë hakun Voskopojës së zhuritur, Bellovodës, Pojanit, Polenës, Gjonomadhit, **Vinçanit, Voskopit, Borovës, Vithkuqit si dhe 59 të** vrarëve e 120 të plagosurve të popullit të Korçës, që para një dite ishte qëlluar me hekur e zjarr.

Kishte ardhur koha për të larë hesapet e fundit me fashizmin italian, që bënte orvatje të dëshpëruara për të dalë nga rrethimi dhe kërkonte me çdo kusht të shkonte përpara, duke vënë në përdorim të gjitha llojet e artillerisë. Ajri bubullonte nga krismat e topave, tundej dheu nga shpërthimet, dhe përlesh-

ja ditën e tretë u bë më e egër, më e tmerrshme. Italianët sulmonin dendur dhe me nxitim, tamam sikur të kishin frikë se, po të mos kalonin atë ditë, nuk do të mundnin dot të nesërmen. Batalionet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, midis të cilëve dhe batalioni «Ali Kelmendi», nuk e lanë armikun të pykëzohej thellë. Kështu, mbasi la më tepër se 200 të vrarë, armiku u detyrua të kthehej prapë në Korçë. Pjesa tjetër iu përgjigj thirrjes që të dorëzonte armët e të bashkohej me partizanët.

Voskopoja u mbush me ushtarë e oficerë italianë, me pushkë, mitraloza, bomba, arka me fishekë, material telefonik, veshmbathje etj., për të vazhduar luftën më me vrull kundër një pushtuesi më të egër dhe më barbar. Trupat italiane, të hutuara, çuditëshin kur shikonin partizanët plot energji, të lumtur dhe të shkathët në kryerjen e detyrave. Ata në mbrëmje këndonin himnin «Bandiera Rossa», ndërsa më tej dëgjohej kënga e partizanëve:

*Kuq është ku lind dhe perëndon,
Kuq është në jug dhe në veri,
Toka nën hapat sulmuese ushton,
Para, o shokë, me trimëri.*

Gjithë nata kaloi me biseda gazmore rreth zjarreve partizane. Të nesërmen batalioni ishte mbledhur dhe priste se ç'do të thoshte komandanti, i cili kishte qenë delegat në Konferencën e Labinotit.

— Konferenca II Nacionalçlirimtare vendosi të mos njihet asnjë forcë ose lloj pushteti tjetër në Shqipëri, përveç këshillave nacionalçlirimtare, — tha Tekiu me zë të lartë që ta dëgjonin të gjithë. — Ajo dënoi tradhtinë e Mukjes dhe na vuri detyrë që tani-

më të mbajmë një qëndrim të prerë ndaj «Ballit Kombëtar», i cili po del sheshit si shkaktar i një lufte vëllavrasëse... — Mandej atij iu desh t'u përgjigjej shumë pyetjeve të partizanëve dhe më në fund shpërtheu një stuhi duartrokitjesh, midis të cilave ndihe-
shin të shara kundër bandave balliste.

— Eh, o vëlla! Tani filloi vallja me ata që na silleshin prapa krahëve, — tha një partizan.

— Dhe çeta e Xhelal Kurtesit na vrau dy shokë në pritë kur ktheheshim të lodhur e pa bukë nga lufta e Përmetit..., — ia priti një tjetër.

— S'mund të vazhdonte më gjatë kjo gjendje, — foli përsëri i pari. — Kupa u mbush. U erdhi fundi ballistëve bashkë me Italinë fashiste, se na çanë veshët me patriotizmin e tyre.

— Të gjitha ishin dëngla. Për hesapin tim, qysh me kohë duhej folur ndryshe me ta, por Partia ka qenë e duruar... — ndërhyri një partizan.

RIORGANIZIMI I BATALIONIT

Në ditët e para të muajit tetor Voskopoja ishte në festë. Malet e pyjet oshëtinin nga këngët e partizanëve.

Në këtë qendër të Lëvizjes Nacionalçlirimtare rrinin krah për krah të pesë repartet që ishin bashkuar në një të vetëm duke marrë emrin batalioni «Gorë-Opar» me komandant Teki Kolanecin dhe komisar Skënder Çaçin.

— Shokë! — u dëgjua zëri i të deleguarit të Komitetit Qarkor. — Me gishta numëroheshin dikur luftëtarët e lirisë, me mijëra vullnetarë të rinj nga fshati dhe qyteti mbushin sot radhët tona. Lëvizja Nacionalçlirimtare shkon përpara, zhvillohet e rritet, ndërsa ne me grupe të vogla të izoluara, nuk mund t'u përshtatemi kërkesave të luftës sonë në ngritje si dhe porosive të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare për të rritur forcën goditëse të formacioneve partizane. Përvoja e aksioneve të Voskopojës, Snosmit, Leskovikut e Përmetit, tregoi se bashkimi i forcave i shtoi aftësitë tona për luftë dhe garnizonet armike i sulmuam me rreptësi të madhe. Prandaj sot erdhi koha të bashkohemi në një batalion të madh që ka në radhët e tija luftëtarë të sprovuar dhe një fuqi zjarri të mirë për t'i dhënë goditje serioze armikut...

Partizanët e përshëndetën me duartrokitje dhe brohoritje këtë lajm.

Në Voskopojë, shtabi i batalionit «Gorë-Opar» plotësoi kompanitë me armatime, sqaroi partizanët për detyrat luftarake dhe, ditën e largimit, komandanti i tyre u foli për rëndësinë e aksionit të parë kundër armikut në krahinën e Gorës.

— Shokë partizanë! — filloi të fliste Tekiu. — Vetë zhvillimi i ngjarjeve po tregonte se bashkëpunimi i «Ballit Kombëtar» me pushtuesin do të na çonte në mënyrë të pashmangshme deri në përpjekje me armë. Ne i dolëm borxhit, por ai ishte i përgatitur për këtë dhe tani e çorri maskën. Kudo në Shqipëri u duk qartë se pushka e tij ka vetëm një drejtim: të shtjerë mbi djemtë e popullit. Por ne nuk do të lejojmë në asnjë mënyrë të na godasë në kushte të favorshme për të, prandaj sot po nisemi për ta...

«T'i shpartallojmë!» — thirrën partizanët të pushtuar nga zemërimi dhe urrejtja për tradhtarët.

LUFTA E PARË KUNDËR «BALLIT KOMBËTAR» NË ZONËN GORË-OPAR

Atë natë të thatë tetori, me yje të paktë që shkëlqenin në qiell, kudo ishte qetësi e madhe, asgjë nuk paralajmëronte afrimin e luftës që do të zhvillohej. Partizanët rrinin të heshtur. Rrallë, shumë rrallë, dikush shkëmbente ndonjë fjalë.

— Sikur të mundja ta ndizja një tani! — tha njëri që po rrinte pas një guri të madh.

— Armiku s'është larg. Ja tek e ke afër, fare afër, — iu përgjigj me zë të ulët një tjetër.

Lart ngriheshin shkëmbinjtë dhe maja e «Gurit të Bletës» qëndronte sipër tyre si streha e fundit. Ndër ta, përgjonin me çarkun e ngrehur gjashtëqind tradhtarë, që nuk u mungonte as ushqimi as municioni. Tekiu nuk i dallonte, por me mend i shikonte tytat e pushkëve, mitralozave e granatat e vendosura pranë tyre dhe kishte besim në vetvete, në shokët e në fitoren mbi armikun.

Po zbardhte mëngjesi i 16 tetorit 1943. Çasti vendimtar po afrohej. Nga kodra e Gurit të Çezmës mbi Grybec u dha shenja e sulmit pa zë, me tymin e një dëllinje dhe grykat e armëve dërguan një bre-shëri plumbash e predhash mortaje në të trija anët e «Gurit të Bletës», në veriperëndim të Grybecit e mbi vargmalin që shtrihej në lindje, gjer në Bubuq.

Qetësia u prish. Mëngjesi gjëmoi. Jehona e pushkëve u përhap në të çarat e shkëmbinjve dhe u fut brenda në male. Batalioni «Gorë-Opar» nga perëndimi në lindje, batalioni «Tomorri» nga jugu dhe batalioni «Reshit Çollaku» nga veriu i vargmalit, sulmuan nga poshtë-lart pozicionet e bandave xhandaroballiste, me në krye Maliq Dusharin, Demir Stara-veckën, Ethem bej Frashërin dhe Jani Dilon.

Ky ishte fillimi. Lufta u ndez. Nga lart, plumbat e pushkëve të mbuluara nga oshëtimat e mitralozave të veçuar në vendet më të favorshme të mbrojtjes, binin si breshër shumë afër partizanëve, të cilët me grupe të vogla e të shkëputura, me skuadra ose edhe një e nga një lëviznin me kërcime të shpejta e të shkurtëra, shfrytëzonin tokën dhe me duar e me këmbë ngjiteshin përherë më lart. Por ishte shumë vështirë të kaloje rrugë pa rrugë nëpër shkëmbinj të thikë dhe ku përpara të vërtiteshin papushim plumbat...

Nga të tri batalionet zjarri sa vinte ndizej. Ballistët mundoheshin të mbaheshin kudo. Formonin grupe sulmi, hidheshin herë në një sektor, herë në një tjetër, kundërsulmonin në pikat më të kërcënuara dhe si të tërbuar e shtonin qëndresën sa më tepër t'i afroheshe majës së «Gurit të Bletës». Po partizanët i shmangeshin asaj maje, kalonin me shpejtësi drejt shkëmbinjve, bëheshin kruspull prapa tyre, ngjisheshin pas gurëve, fshiheshin pas shkurreve dhe me përpjekje të vogla e të veçuara, mundoheshin të hynin në formë pyke në pika të ndryshme të pozicioneve të kundërshtarit, për t'u shtyrë më përpara. Në çdo sektor ata mundoheshin të asgjësonin çdo qëndresë, sepse ishte marrëzi të shkoje me gjoks përpara

e të sulmoje, pa zhdukur çerdhet e zjarrit, shpirtin e qëndresës.

Tekiu, që tanimë kishte përvojë në luftërat me armiqtë, zbulonte nga zëri vendosjen e çdo grupi armik. Ai u tregonte partizanëve cilat pika duhej t'i zinin e t'i mbanin me çdo kusht.

Lufta ishte në kulm. Shpeshherë, si njëra palë edhe tjetra nuk kishin një vijë mbrojtëse të vazhdueshme. Të shtënat e pushkëve këmbëshin njëra me tjetrën aq afër sa askush nuk mund të tregonte se ku kalonin plumbat. Tekiu kapërceu një shkëmb dhe në çastin kur u shtri pranë një guri të zi, një plumb i fërshëlleu mbi kokë. Vështroi me vëmendje nga ajo anë dhe me bishtin e syrit dalloj profilin e Demir Staraveckës, me faqe të fryra, me mustaqe deri te veshët. Në çast iu përgjigj zjarrit me zjarr. Plumbi i tij kaloi pak mbi majën e gurit e mend e goditi për vdekje atë trup të madh, të ngarkuar me shumë takëme, zinxhirë e revole me këllëf lustre. Banditi e njohu kundërshtarin që kishte përballë dhe me zë të ngjirur filloi nga të sharat... Fërshëlleu një plumb i dytë, pastaj një i tretë... Të dy kishin maliherë dhe ishin aq të përqëndruar në këtë ndeshje sa i numëronin edhe fishekët që harxhonte secili. Kur kryebanditi e harxhoi plumbin e fundit dhe po e mbushte pushkën përsëri, Tekiu me qëllim shtiu fishekun e pestë e, pa e ulur armën, qëndroi i gatshëm që, kur Demiri të ngrinte kokën për t'u orientuar në marrjen e shenjës, atëherë të qëllonte mbi të. E priti atë çast dhe me plot besim tërhoqi këmbëzën. E shtëna ishte e saktë. U dëgjua një britmë e tërbuar... Plumbi i gjashtë kishte goditur në shenjë. Si mjeshtër i luftës, Tekiu e mbante maliherin me pesë fishekë në kasë dhe me një në gojë...

Në të tria anët batalionet ishin hedhur në sulm drejt majave. Nga e djathta, dy kompani të batalionit «Tomorri», pasi kishin bërë të hehtrnin mitralozat e rëndë të kundërshtarit, iu afruan majës së mallit mbi Grybec e Manastirec. Po ashtu, edhe në veri skuadrat e sulmit të batalionit «Reshit Çollaku» depërtuan me bomba, hapën një shteg dhe dobësuan qëndresën e ballistëve, të cilët i rralluan qitjet e më kot mundoheshin të thyenin hovin partizan.

Maja e «Gurit të Bletës» gjëmonte e lëshonte tym. Partizanët, të kërrusur gjer në mes, u vërsulën për të arritur pikën më të lartë, në mes të gurëve që i preknin plumbat duke kërcitur.

— Po ku është mitralozi? Pse hesht mitralozi? — pyeste Tekiu shokët. Pse forcat e batalionit të tij s'po lëviznin nga vendi? Por papritmas... mitralozi hapi zjarr të furishëm dhe kositi qëndresën e armiqve që ishin afruar duke shtënë. Partizanët, që e njihnin nga krismat mitralozin e Hasan Pirgut, vështruan për një çast djaloshin me flokë të rënë mbi ballë, pa xhaketë e me mëngë të përveshura që kishte zënë vend mbi një gur të madh dhe luftonte më këmbë me mitraloz.

— Bombat! — thirri Tekiu. Hodhi i pari bombën e tij duke e ndjekur me sy fluturimin e saj dhe me shpejtësi bëri përpara bashkë me partizanët e tjerë.

Tradhtarët, që u sulmuan edhe nga drejtime të tjera, u detyruan të linin pozitat njëren pas tjetrës. Në orën 4 të mbrëmjes, kur «Guri i Bletës» gjëmoi nga thirrjet e zjarra «Para partizanë!», Skënder Çaçi, komisar i batalionit «Gorë-Opar», u hodh në ballë e drejtpërdrejt për të kapur me duar grykën e

mitralozit armik. Por plumbat e flaka i copëtuan nofullat kur lufta ishte afër fundit të saj.

Beteja po përfundonte. E vetmja rrugë shpëtimi për tradhtarët ishte ikja. Të shpartalluar, tradhtarët u tërhoqën nga rruga e vetme që u kishte mbetur.

— Aha-a, po ikin! — bërtisnin rreth e rrotull partizanët.

— Të gjithë në sulm! Të mos kalojë asnjë! — thërriste Tekiu.

— Vrajini! Vrajini! Të marrim hakun e komisarit, — dëgjo Tekiu një zë që thirri në mes të britmave.

«Domethënë, Skënderi qenka vrarë!» — tha me vete Tekiu, por kjo nuk ia ndali vrapin. Përkundrazi, ajo i dha energji dhe nuk çuditej kur dëgjonte që gjëmonte si një britmë lufte: «Të marrim hakun e komisarit...»

... Dita po mbaronte dhe zëri i pushkës po shtyhej përherë më thellë në brendinë e maleve, derisa u shua fare. Bandat xhandaro-balliste lanë shumë të vrarë, por humbja e Skënder Çaçit ishte e madhe për batalionin «Gorë-Opar». Ishte i pari komisar batalioni që vritej në qarkun e Korçës. Ballistët që u kapën të gjallë u gjykuan dhe një pjesë e tyre u pushkatuan në vend.

Kështu mbaroi kjo luftë që ishte fillimi i shpartallimit të «Ballit Kombëtar» në zonën e Gorë-Oparit.

*
* *
*

Tekiu u kërrus përmbi Skënderin, u ul në gju-një, u përkul edhe më poshtë mbi fytyrën e tij dhe, duke i rregulluar mbi ballë flokët e njomur që i ishin ngjitur, i tha:

— Skënder...

Skënderi nuk u përgjigj, vetëm çeli dhe mbylli përsëri sytë.

Këta njerëz kështu vdesin. Në kohën e sulmit ata gjithmonë janë në ballë, në vendin më të rrezikshëm, më të zbuluar.

Tekiu, që e kishte parë shumë herë me sy vdekjen dhe disa herë me radhë kishte arritur gjer në prag të saj, nuk ishte njeri me nerva të dobëta. Por tani vështronte përreth dhe sikur s'po i besohej se Skënderi s'ishte më gjallë. I dukej sikur ia dëgjonte ende zërin. Bënte ç'bënte, ngrihej nga vendi ku ishte ulur, ndizte e shuante cigaret njëren pas tjetrës me gishtrinjte që i dridheshin nga dhembja për shokun.

Të nesërmen, seriozë e të menduar partizanët qëndronin rreth varrit dhe dëgjonin fjalimin e fundit:

— ... Fytyra e tij e ndritur do të mbetet përgjithmonë në zemrat tona, sepse njerëz të tillë si komisar y në nuk vdesin. Mbi varrin e tij, sot s'derdhet lot, por merret guxim për të luftuar dhe për të kërkuar gjer në fund hakmarrjen kundër tradhtarëve...

Partizanët ngritën armët që i kishin marrë armikut, shtinë përpyetë, një, dy, tri batore dhe jehona humbi diku larg, si e rrëmbyer nga era. Mandej melodja e këngës «Hakmarrje» ushtoi për një kohë të gjatë në ajër.

Në shenjë respekti për punën e palodhur, për meritat dhe për trimërinë e këtij biri besnik të saj, Partia i dha batalionit «Gorë-Opar» emrin «Skënder Çaçi». Kur vdes një trim, emri i tij përmendet, kujtohet, shkruhet dhe kurrë nuk harrohet.

GODITJA E POSTBLOQEVE DHE LUFTA NË KURTES

Që në ditët e para të tetorit, hordhitë naziste, me reparte të vogla e të shpejta, herë këtu e herë atje hynin në zonat e çliruara, futnin panik në popull, terrorizonin dhe digjnin fshatrat si Voskopojën, Voskopin e Gjonomadhin. Me përpjekje të lehta e sulme të pjesshme, ato depërtonin befasisht natën dhe, duke përfutuar nga pakujdesia, u shkakttonin dëme të ndjeshme forcave partizane në ato rajone ku nuk ishin marrë masa të plota sigurimi.

Nga këto gabime, shtabi i qarkut nxori mësim.

Më 9 nëntor, pushtuesi u vërsul përsëri për të plaçkitur dhe për të djegur në Gjonomadh, Voskop e Polenë, por e pagoi shtrenjtë metodën e sulmit që kishte përdorur më parë.

— Ne duhet të mos e lëmë armikun të marrë frymë, — thoshte Tekiu në mbledhjen e celulës, e cila merrte në shqyrtim çështjet e ngritjes së aftësisë dhe të gatishmërisë luftarake. Edhe të tjerët që e morën fjalën, e përqëndruan vëmendjen në ngjalljen e rrënjosjen e shpirtit sulmues në zemrën e çdo luftëtari. Në fund celula vendosi të zbatonte plotësisht vendimet e udhëzimet e Partisë, sipas të cilave armiku në çdo orë duhet të priste sulme të reja, të

befasishme dhe të mos dinte se ç'është gjumi e qe-tësia.

Shtabi i qarkut të Korçës, për t'i çuar deri në fund porositë e Partisë, urdhëroi batalionet «Skënder Çaçi» e «Shqiponja» që në mbrëmjen e 10 nëntorit të godisnin të gjitha postbolloqet e Korçës.

Aty nga orët e fundit të mesditës, Tekiu zgjodhi dyzet vetë me në krye komunistët, të cilët e konsideronin marrjen pjesë në mësymje si një nder të veçantë. Ai u caktoi detyrat, përcaktoi sinjalet dhe tregoi nga ç'rrugë do të shkonin. Në çastin që do të niseshin, kur shiu vazhdonte të binte, i radhiti në mes të pyllit dhe u tha:

— Shokë! Godisni pa mëshirë! Grushti të jetë i tillë sa armiku të mendojë se ka përballë dy batalione...

Në atë errësirë të madhe, ku hynin në punë më fort veshët se sytë, partizanët kalonin nëpër fshatra ku qentë lehnin me zë të ngjirur e të lodhur, si të trembur.

Kishte kaluar mesnata, kur ata mbërritën në qytetin që flinte. Dritat ishin shuar.

Kuçedra u qëllua mu në strofkën e saj. Plumbi dhe zjarri u përhap, futi panik të madh dhe bëri që armiku për 45 minuta të mos dilte nga fortinat, por të tmerrohej e të shikonte qartë se para tij ka gjokse çeliku që nuk e njohin frikën.

Qyteti u zgjua. U çelën të gjitha dritaret dhe banorët ndoqën me ankth të shtënëat e armëve. Në sytë e tyre lexohej krenaria e trazuar me dhemshurinë për bijtë e popullit, të cilët u kthyen në bazat e tyre pa asnjë humbje dhe plot gjallëri.

Sipas urdhrit të shtabit të qarkut, më 13 nëntor 1943, partizanët e të dy batalioneve vazhdonin marshimin nën qiellin me re të zeza që kishin zbritur fare ulët e lëshonin një shi të imët e të ftohtë. Pas tetë orësh udhëtimi, në mbrëmje, ata mbërritën në Rehovë të Kolonjës. Ishin bërë qull. Fshatarët i pritën me dashuri dhe të nesërmen i përcollën për në Lubonjë. Atje ata nuk qëndruan, por me shpejtësi kaluan drejt Psarit të Zi për të rrethuar bandat e «Ballit», të cilat kishin mundur të futeshin përkohësisht në disa fshatra në thellësi të zonave të çliruara, ku plaçkitnin, frikësonin e terrorizonin njerëzit.

Batalioni «Skënder Çaçi» mbërriti në qendër të Psarit dhe vuri nën kontroll rrugët nga veriperëndimi. Nga lindja, batalioni «Tomorri» hyri në lagjet e fshatit. Ballistët, të kapur në befasi, u përgjigjën me zjarr nga muret e nga dritaret e shtëpive, të cilat i shndërruan në qendra të fortifikuara. Mirëpo, pas dy orësh, fshati u zbraz. Tradhtarët, duke marrë me vete pothuajse të gjithë burrat e fshatit, që ishin mashtruar nga propaganda balliste, u larguan duke lënë mjaft të vrarë, 15 robër dhe material lufte.

*

* * *

Megjithëse në dhomë kishte pak dritë, Tekiut iu duk i zoti i shtëpisë njeri i mirë. Në kohën kur fshatari doli për të pregatitur darkën, një nga partizanët tha:

— Shumë njerëz i kanë hapur sytë këto kohët e fundit, kurse këta...

— Njerëzit nuk janë të gjithë njësoj, — u përgjigj një tjetër.

— Ashtu është, ndikimi i rrethit është nganjëherë më i fortë se arsyeja dhe se zemra, — ia ktheu një djalosh që rrinte pranë Tekiut.

— Në radhë të parë duhet t'i kesh këmbët në tokë. Kjo ka rëndësi, — tha Tekiu dhe, kur i zoti i shtëpisë hyri në dhomë, ai e pyeti:

— E, more vëlla, ç'kemi këtej, si venë punët? Ku janë burrat e fshatit?

— Disa janë këtu, të tjerët shkuan, po më qafë paçin veten e tyre, — u përgjigj shkurt fshatari dhe vazhdoi të tymoste, të heshte.

— Kanë ikur pas bejlerëve e agallarëve që i tërheqin për hunde, — ia priti një partizan dhe pas pak shtoi: — Po do të vijë dita që të ndahet shapi nga sheqeri.

— Mirë foli ky shoku, more mik, — i tha Tekiu të zotit të shtëpisë. — Fshatarët vetë do t'i hedhin në erë ato të pakta ura të kalbura që i lidhin me Qazim Prodanin, Qemal Burimin e të tjerë tradhtarë.

I turpëruar, i zoti i shtëpisë vështroi si i habitur Tekiun dhe të tjerët. Atij s'i shkonte mendja se do të merrte përgjegje të tilla. Përkundrazi, priste një trajtim të egër dhe ishte i sigurt se ata do ta shtrëngonin të tregonte gjithçka për bashkëfshatarët e tij. Po ja që nuk ndodhi ashtu.

Edhe në shtëpitë e tjera, sjellja e partizanëve bëri efekt të tillë sa që njerëzit nuk u besuan as syve dhe as veshëve të tyre.

Të nesërmen, forcat mbërritën në Luaras dhe aty nga orët e fundit të mesditës së 16 nëntorit, të dy shtabet e batalioneve vendosën të sulmonin Kurtësin, duke i ndarë sektorët në këtë mënyrë: batalioni «Skënder Çaçi» të kalonte lumin Osum dhe të rrethonte fshatin nga veriu e pjesërisht nga lindja, kur-

se batalioni «Tomorri» të merrte urën e Orgockës, të sulmonte nga perëndimi dhe pastaj nga jugu.

Partizanët u futën në errësirën e natës dhe rrëshqitën pa u ndjerë gati fare. Në fillim nuk shikonin asgjë përveç errësirës së zezë të nginjur me lagështi dhe me mjegull të trëshë. Pastaj sytë u mësuuan dhe ata filluan të dallonin format e ngatërruara të botës që i rrethonte. Mbarë toka ishte mbytur në ujë dhe rrëketë i hapnin udhë vetes, duke krijuar shtretër të rinj përrrenjsh.

Vazhdonin të ecnin në heshtje dhe në drejtimet e caktuara. Pas ca kohe batalioni «Skënder Çaçi» mbërriti buzë lumit Osum.

— A thua t'i biem përmes? — e pyetën disa shokë Tekiun, duke vështruar me shqetësim përplasjen e tërbuar të dallgëve.

— Duhet të kalojmë këtu, — u përgjigj i qetë Tekiu.

Të futeshe në mes të dallgëve ishte një gjë e rrezikshme. Po rrugëdalje tjetër s'kishte dhe partizanët ecnin ngadalë e me kujdes nëpër shtratin e pjerrët e tërë gurë të lumit. Sa më shumë i largohehin bregut, aq më fort binte në sy se si ata shtrëngoheshin pas njëri-tjetrit, ktheheshin instiktivisht në drejtim të rrymave të forta, bënin përpara me gjokset e tyre dhe ecnin ashtu si u dukej më lehtë e më mirë, derisa më në fund iu afruan bregut tjetër.

Kishte kaluar mesnata. Shiu vazhdonte të binte dhe bënte shumë ftohtë. Më në fund e kapërcyen këtë natë të lodhshme dhe ndaj të gdhirë mbërritën para lagjeve të shpërndara të fshatit që ende ishte në gjumë. Kurtesi heshte, tamam sikur atje të mos kishte fare jetë.

Në orën 6 të mëngjesit të 17 nëntorit, kur të dy

batalionet kishin zënë pozicionet e caktuara, Tekiu dha sinjalin për fillimin e luftimit. Partizanët, të ndarë në grupe, sulmuan me shpejtësi fshatin. Në fillim goditën nga larg, duke shpresuar se ballistët do të kundërsulmonin e kështu do të zhvendosej qendra e luftimeve nga fshati në periferi dhe do të shmangej lufta shtëpi më shtëpi, e cila kishte pasoja të rrezikshme për gratë e fëmijët. Mirëpo armiqtë, që nuk e prisnin këtë sulm, me dëshpërim e si të tërbuar filluan të hapnin zjarr nga dritaret dhe kamaret e mureve që rrethonin shtëpitë. U pa qartë se ata nuk shkuleshin prej andej. Shtëpitë u jepnin shumë dorë për të organizuar një qëndresë të fortë që sa vinte e rritej, duke marrë tiparet e një lufte pozicionesh.

Në lagjet Muratas, Kojkas e Meçollarë, lufta ishte në kulmin e saj. Tekiu me disa shokë arritën afër një kodre në krye të fshatit, në lagjen Komnas, ku kishte dy shtëpi. Rreth tij fërshëllyen plumbat, por ai e tërhoqi kokën dhe nga lart-poshtë mundi të vështronte në oborr një grua që u mbushte pushkët e ua bënte gati dy burrave që ishin të puthisur pas mureve të avllisë e nuk pushonin së shtëni. Tekiu u mbështet me gjoks në shkëmb dhe me saktësi e gjakftohtësi qëlloi e la në vend Izet Kurtetin, që e hiqte veten nga më trimat e «Ballit» dhe që në atë rreth njihej me pseudonimin «Autoblinda». I vëllai i tij, Dervishi, si dhe gruaja s'pyetën për të vdekurin, por e lanë atë në vend e ikën të tmerruar. Pas pak, partizanët hynë në shtëpi dhe i vunë zjarrin kësaj çerdheje të ndyrë që nuk ishte gjë tjetër veçse një depo hajduti, ku ishin grumbulluar sendet që i ishin vjedhur e rrëmbyer me forcë popullit.

Prej andej, Tekiu me një kompani kaloi me

vrap dhe, kur mbërriti pranë ledheve me gurë të një are, u qëllua me zjarr të dendur nga shtëpitë e përtejme.

— Ne, — u tha ai partizanëve, — jemi larg nga ata një largësi të shtëne e ca. Po të kalojmë shpejt, s'ka asnjë rrezik për të arritur në kurrizin e atij shkëmbi që duket përtej.

Sipas udhëzimeve të tij, katër partizanë u nisën drejt arës, një e nga një, me intervale. Ballistët shtinë kundër tyre pa i kursyer fare municionet, por, kur panë se ata nuk mbroheshin fare, menjëherë e zvogëluan largësinë e qitjes. Ndërkaq Tekiu i urdhëroi shokët e tjerë të shkonin pas tij duke u përkulur, me qëllim që armiku të kujtonte se godiste në shenjë. Kështu, e gjithë kompania kaloi pa u prekur nga asnjë plumb dhe zuri një pikë të fortë.

Në këtë kohë, grupe partizanësh nga 3, nga 5, nga 10 vetë, kishin hyrë në mes të lagjeve të fshatit dhe herë këtu, herë atje, me shkëmbime të furishme të shtënash u afroheshin shtëpive nga anë të ndryshme dhe i mbulonin dritaret me plumba. Dara e rrethimit sa vinte e ngushtohej. Zhurma e luftës dëgjohej herë e dobët dhe herë e furishme. Duke ndjekur me vëmendje zhvillimin e ngjarjeve, Tekiu e kuptoi se kundërshtari nuk do të qëndronte për një kohë të gjatë. Mirëpo koha nuk priste. Kishin mbetur edhe dy orë ditë. Thirrjes për të dalë nga shtëpitë, ballistët iu përgjigjën me zjarr dhe me kanosje. Atëherë u vendos që mullarëve të barit pranë shtëpive t'u vihej zjarr për të kufizuar pamjen e armikut dhe, atje ku kishte qëndresë të madhe, të godiste mortaja e pushka antitanke, të cilat nuk u përdorën që në fillim për të mos dëmtuar gratë e fëmijët.

Mullarët lëshuan shtëlunga tymi. Flaka mori

qiellin. Filloi qitja. Predhat goditën çatitë e shtëpive dhe pëlcitën brenda në dhoma. Tërë fshati buçiti nga krismat shurdhuese. Ballistët u shkëputën nga dritaret dhe zbritën me tmerr në katet e poshtme. Gjysmë ore kishte mjaftuar. Pas shkatërrimit të qëndresës së parë, partizanët mundën të shtinin në dorë një pjesë të fshatit, duke marrë shtëpitë njëren pas tjetrës. Në këto kushte, forcat e të dy batalioneve u bënë thirrje edhe një herë kriminelëve që të dilnin jashtë, por ata, me shpresë se do të tërhiqeshin kur të binte nata, përsëri nuk pranuan. Por flakët e zjarrit e bënë punën e tyre. Ato i detyruan kriminelët të linin shtëpitë. Më në fund, me përpjekje të dëshpëruara, ata çanë rrethimin dhe, nga sytë këmbët, u drejtuan nëpër një shteg të ngushtë për t'u fshehur në pyll e në mal të Rodomit që binte nga juglindja e fshatit, duke lënë në pragjet e dyerve e të oborreve mjaft të vrarë e të plagosur. Nga forcat partizane u plagos rëndë vetëm një luftëtar.

Me disfatën në Psar të Zi e në Kurtës, «Balli» humbi bazat e tija përtej lumit Osum dhe prej asaj kohe ai nuk mundi të ndërmernte luftime kundër forcave partizane, pa pasur mbështetjen e pushtuesit.

Në kthim për në Gorë, batalioni «Skënder Çaçi» bëri mbledhje në një luadh të Selenicës së Pishës, ku komisari lavdëroi partizanët dhe kuadrot që kishin treguar zgjuarësi e trimëri në luftime. Pas tij, Tekiu bëri vlerësimin e aksionit nga ana ushtarake, paraqiti praktikisht disa çaste të luftës dhe, për ndonjë të metë që u vu re, fajin e mbajti për vete. Vënia në dukje e gabimeve bëri të mundur fitimin e përvojës dhe ngriti autoritetin e komandës. Mandej filluan diskutimet. Batalioni bëri bilancin e gjithë punës së kryer.

GURI I KAMJES

Hitlerianët, duke shfrytëzuar tradhtarët, bënë goditje të vogla e të mëdha, të shkurtra e të ashpra me karakter lokal në të gjithë qarkun e Korçës. Si dukej, ata kishin për qëllim të zbulonin numrin e aftësitë luftarake të forcave partizane, t'i lodhnin ato, t'i bënë që të harxhonin atë pak municion që u kishte mbetur dhe t'i largonin nga vijat e komunikacionit e objektet e tyre, nga kishin frikë se mos i sulmonin.

Në vazhdim të këtij plani, nga mesi i nëntorit, një fuqi e madhe gjermano-balliste filloi sulmin në zonën e Mokrës. Pas dy javë luftimesh, — në disa raste të ashpra e me humbje të ndijshme nga të dyja palët, — forcat partizane, për mungesë municioni dhe për të mos rënë në grackën e rrethimit, u tërhoqën në drejtim të Qafës së Panjës e prej andej për në Gorë.

Pushtuesit e tradhtarët, të inkurajuar nga kjo tërheqje, e përshkuan me zjarr e terror tërë krahinën e Mokrës. Vranë, dogjën e dëmtuan fshatrat e lidhura me Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Në Llëngë masakruan 60 burra e gra.

Në Gorë, partizanët e batalioneve «Reshit Çollaku» e «Shqiponja» zunë pozicione mbrojtëse në vargun e kodrave Dërsmirë-Kronisht dhe e ndalën për

katër ditë rresht përparimin e kundërshtarit. Por gjendja për ta ishte bërë shumë e vështirë. Mosbarazia e forcave ndjehej gjithnjë e më tepër. Duke parë se luftimet e përditshme jepnin shenja të dukshme të një sulmi të përgatitur mirë të forcave gjermano-balliste, komanda e shtabit e qarkut të Korçës urdhëroi batalionin «Skënder Çaçi» të nisej më 9 dhjetor për t'i dalë përpara armikut që ndodhej në zonën e krahut të djathtë të lumit Devoll.

Gryka e Lozhanit nuk dukej nga tufani. Era e përhapte borën mbi çatitë, e rrotullonte dhe e vërtiste nëpër rrugët e fshatit...

Pas pak do të ngrysej. Në dhomë ishte qetësi. Tekiu rrinte i mbështetur pas murit pranë dritares dhe vështronte i mërzhitur tufanin që frynte me tërbim. Ai mendohej të shihte tej Devollit, nga Babieni, nga Mokra, por nuk dallonte dot gjë. Larg, lumi i Devollit shfrynte i egërsuar. Në disa vende, valët e tija të shkumëzuara rrokulliseshin duke buçitur edhe mbi xhade.

— Vështirë e kemi, — u tha shokëve Tekiu, — por do ta kalojmë...

Mesnatë. U dha urdhri për përgatitje dhe partizanët dolën jashtë në rrugë. Gjilpëra të holla e të akullta shponin veshjen e hollë të partizanëve dhe u futeshin deri brenda në mish. Rrënqetheshin, dridheshin, kërcisnin dhëmbët, sytë u lëshonin lot, faqet u mpiheshin dhe nuk dinin se ku të futnin fytyrën. Mirëpo asgjë s'i ndalonte të bënin përpara...

— Kini kujdes, mos u shkëputni nga shoku! Në goftë se nuk e shikoni, bëni zë. — Këto fjalë kalonin gojë më gojë me një zë të mbytur sikur vinte nga

fundi i dheut. Njëri pas tjetrit, duke shkuar përpara, u hodhën përtej lumit Devoll dhe, kur agimi i 11 dhjetorit hodhi me zor një dritë të zbetë, kompania e batalionit «Fuat Babani» u diktua nga një patrullë armike. Kjo bëri që të humbiste befasia. U hap zjarr. Ndërkohë forcat balliste brenda në fshat u ngritën të alarmuara dhe zunë brigjet. Nga ana e djathtë e Babienit erdhën fuqi të tjera, të cilat e zgjeruan goditjen. Por Tekiu me batalionin e tij u doli përpara dhe i goditi tradhtarët në pozicionet ku qenë ngulur. Luftimet nuk zgjatën shumë, sepse kundërshtari u thye dhe u tërhoq në Bubuj-Zboq.

Të rësërmën, batalionet ndanë zonat e veprimit. Në qendër u vendos batalioni «Reshit Çollaku» për të ndjekur drejtimin Zvarisht-Moçan, në të djathtë batalioni «Shqiponja» nga ana e Zboqërisë, ndërsa në të majtë batalioni «Skënder Çaçi» me kompaninë «Fuat Babani», për Babien-Grybec-Guri i Kamjes.

Moti i errët vazhdoi deri në drekë dhe dukej sikur ende s'kishte zbardhur mirë. Mbasdite u bë pothuaj natë. Në kodrat më të majtë të Grybecit, Tekiu me batalionin e tij u ndesh me një forcë gjermano-balliste që kishte ardhur nga Mokra. Lufta filloi. Partizanët, me lëvizje të shpejta i morën inisiativën taktike armikut, nuk e lanë të shfrytëzonte tokën plotësisht dhe, kur filluan të hapnin zjarr nga të dy krahët e tij, Tekiu u tregoi shokëve kodrinat që ishin përpara.

— Ato duhet t'i zëmë me çdo kusht, — u thoshte ai. — Të mbahemi atje dhe pastaj të hidhemi në sulm.

Si la disa partizanë në vendin ku ishin, Tekiu u shkëput me një skuadër kaloi përpara dhe u përlësh me forcat e armikut. Në këtë kohë, diku fare afër

u dëgjua një mitraloz që filloi të kërciste gjithnjë e më fort. Në çdo krismë dëgjohej një fishkëllimë e mprehtë, pastaj zhurmat e plumbave që binin me vrull mbi tokë. Tekiu i thirri shokët pas tij dhe u bëri shenjë të shtriheshin. Pasi priti dhe një qitje mitralozi, vërejti me kujdes vendin nga i cili po qëllonin dhe tha:

— Këtu jemi të pasigurtë. Ky mitraloz duhet asgjësuar patjetër. — Heshti pak, pastaj shtoi:

— Ju qëndroni në vend dhe mos bëni as lëvizjen më të vogël.

I përkulur, vrapoi drejt shkëmbit që ishte më të djathtë të tij. E qëlluan dy herë, por me vonesë, sepse ai arriti në një vend ku nuk e hante plumbi. U mbështet në trungun e një plepi, nxori kapelen, fshiu fytyrën e lagur e të ngrirë, mori frymë dhe priti. Nuk qëndroi gjatë, por rrëshqiti anash dhe pa u diktuar iu afrua mitralozit fare pranë. Pastaj u ngrit pak, mori vrull dhe hodhi dy granata njëërën pas tjetrës. Gjithçka gjëmoi. U dëgjua të thirrura të egra dhe, kur u duk një tym i dendur, Tekiu u shtri, por nuk u ndal. U hodh përpara, kërcëu në atë çerdhe zjarri dhe pa aty të shtrirë dy gjermanë.

Nga të gjitha anët grupet e sulmit asgjësonin qendrat e zjarrit dhe dora-dorës mësymjet e partizanëve u bënë më të furishme. Qëndresa u dobësua. Në orën 4 pasdite, kundërshtari e pati të pamundur kontrollin e gjendjes. Sulmi guximtar i batalionit «Skënder Çaçi» e i kompanisë së Devollit i shkuli gjermanët nga pozicionet e Gurit me Veshë dhe batalioni «Shqiponja» i detyroi tradhtarët të tërhiqeshin prej Gurit të Bletës. Mirëpo, në këtë luftë, gjatë sulmit dhe në vijën e parë të zjarrit, u vra zëvendëskomandanti i batalionit «Shqiponja», Elez

Braha. Figura e këtij djali trim nga Bicaj i Kukësit mbeti thellë në kujtesën e partizanëve, e shëndoshë, e pastër dhe krenare.

Të tri batalionet dhe kompania e Devollit, pasi spastruan krejt Gorën, u turrën drejt Mokrës dhe afër drekës së 13 dhjetorit mbërritën te Guri i Kamjes. Shtabi i veprimeve u vendos në Osnat. Të nesërmen në mëngjes, zëri i luftës gjëmoi në të katër anët rreth pozicioneve partizane: nga varret e grekëve në Rrëzhan, Guri i Kamjes dhe gjer te Gurët e Bardhë mbi Vërçun.

Forca të mëdha gjermano-balliste, të ardhura nga Pogradeci, u hodhën në sulm për të zënë me çdo kusht lartësinë e Kamjes. Pas disa orësh luftimi, qitja e mitralozave u bë më e shpejtë e më e tërbuar. Shtabi i veprimeve, duke pranuar ndeshjen e pabarabartë, ndiqte me kujdes zhvillimin e situatës e jepte udhëzimet e nevojshme për të mënjanuar çdo kurth që mund të shkaktonte dëmtimin e madh të forcave. Kur forcat armike sulmuan dhe gati dolën në Qafën e Gurit të Kamjes, kompania e Devollit arriti në ndihmë të batalionit «Reshit Çollaku». Me dhjetëra nazistë e tradhtarë gjetën vdekjen në atë luftim trup me trup.

Në mesditë, Tekiu mbërriti në Gurin e Kamjes, nga ku lajmëroi shokët e shtabeve të krahut të djathtë dhe të majtë që në orën 14 të shpërthente sulmi në të gjithë vijën e mbrojtjes.

Në mes të zhurmës së luftës shpërtheu për të tretën herë thirrja «Përpara, partizanë!».

Partizanët, me Tekiun në krye, zbritën me shpejtësi pyllin. Të mbrojtur prapa trungjeve të ahut, e detyruan armikun të kthehej prapa, por, kur dolën në një vend me drurë të rrallë, filluan të ngadalëso-

nin hapin, sepse kundërshtari hapi zjarr të pandërprerë. Të shkohej më përpara nuk kishte mundësi. Çdo lëvizje kontrollohej. Në këto kushte Tekiu urdhëroi që luftimet të vazhdonin në pozicione, për të mos e lejuar armikun të tërhiqte trupa nga qendra ku kishte përqëndruar forca të shumta.

Edhe nga të dy krahët partizanët u munduan të dilnin në shpinë të nazistëve, por përparimi i tyre u ndal dhe, megjithëse sulmet u përsëritën disa herë, ato nuk patën rezultate. Rreth orës 15 gjendja u bë shumë e vështirë. Partizanët nuk mund t'i qëndronin për shumë kohë zjarrit me zjarr. Rezistenca e mëtejshme ishte e dëmshme. Tekiu, në kundërshtim me dëshirën e tij, vendosi tërheqjen në pozitat e para, por edhe kjo nuk ishte e lehtë, sepse armiku e shtoi presionin e zjarrit.

— Pas meje! — thirri Tekiu kur mitralozi gjerman e kaloi zjarrin më të majtë dhe qëllonte me hamendje, sepse një mjegull e dendur filloi të mbulonte vendin. Partizanët vrapuan përpara dhe u shtrinë pas komandantit. Atje ai caktoi dy shenjues të mirë që të hapnin zjarr kundër mitralozit që nxirrte flakë të gjata. Kur Tekiu u duk prapë, mitralozi heshti për një çast. Bashkë me të tjerët, Tekiu kaloi atë hapësirë të vdekur, por në çastin kur po hidhej në një vend tjetër, një plumb e goditi në thembrën e këmbës së majtë. Nuk u ndal, luftoi. Më tej, duke ecur nëpër një monopat dredha-dredha, forcat e lanë, u përkul, ra mbi njërin gju dhe me fytyrë të zbetë nga dhimbja, nxori përpara këmbën e plagosur. Partizanët rendën për t'i vajtur në ndihmë.

— Teki! — thirri i trembur Qendroja. — Ç'ke?

— Nuk është gjë, këmba... — tha Tekiu.

— Pa tregoma, — mërmëriti nëpër dhëmbë Qendroja dhe ia rroku këmbën. Tekiu ia largoi dorën dhe u mundua të ngrihej, por partizani i vjetër në moshë nuk e la. Me një zë të prerë, urdhëroi të tjerët ta ndihmonin. E mori në shpinë dhe, ashtu i mbytur në djersë, vrapoi derisa mbërriti në një lëndinë afër buzës së Gurit të Kamjes. Për një çast u bë një heshtje e madhe dhe e rëndë. Një mërmëritje e thellë dhe e papritur kalonte gojë më gojë:

«Na u plagos komandanti...»

Ky lajm ra si rrufe. Të gjithë u bënë pikë e vrer. Disa hidhnin te Tekiu një vështrim të qetë dhe me besim, ndërsa të tjerët fshihnin në bebet e syve të tyre një ankth të madh. Të plagosurit që ishin shtrirë në atë shesh, i përmbajtën rënkimet, heshtën. Tekiu i vështroi ato fytyra aq të dashura për të dhe, megjithëse vuante shumë, kërkoi që më parë t'u vihej në ndihmë atyre që ishin në një gjendje të rëndë. Kur më në fund infermieri nisi t'i shqyente çizmen dhe çorapin që i ishte ngjitur në plagë, gjaku i kuq rrodhi në këmbën e tij e mbi borën e bardhë.

Pas gjysmë ore, Tekiun e vunë në një vig dhe Qendroja bashkë me tre shokë të tjerë morën rrugën për në fshatin Dërdushë. Udhëtimi sa vinte bëhej më i vështirë. Pllakosi nata dhe ata nuk shikonin se ku i hidhnin këmbët.

Në qiellin e errët ngriheshin njëra pas tjetrës raketa të kuqe e të gjelbëra. Partizanët qëndronin në pozicione gjatë Gurit të Kamjes. Mjaft prej tyre, pa marrë parasysh shiun e përzier me borë, u shtrinë për të fjetur në tokën e lagur. Zjarr s'mund të ndiznin se armiku nuk i kursente predhat dhe municionet.

Nata dukej e gjatë, tepër e gjatë. Të copëtohej zemra kur shihje këta djem, disa pa i mbushur të

tetëmbëdhjetë vjetët, që pas një luftimi kaq të gjatë dhe pa ngrënë që prej dy ditësh, të qëndronin përballë këtij të ftohti. Por jeta partizane kërkonte përpjekje mbinjerëzore, të kaloje netët e dimrit jashtë, në baltë, në borë, në tufan dhe në shi, të duroje pagjumësinë, ecjen, urinë, dhe të përballoje vështirësi të mëdha fizike. Kjo ishte një luftë e dytë, madje më e rëndë se lufta vetë.

*

* *

Tekiu vështronte rreth e rrotull dhomës, ku flaka e kandilit hidhte një dritë të zbetë. Në fytyrën e tij vështoi re gjurmët e lodhjes së madhe. Qepallat i ishin varur si njeriut që nuk ka fjetur për një kohë të gjatë. Dukej se kishte shumë net pa gjumë, por, nga tensioni i madh fizik e shpirtëror që kishte pasur atë ditë, gjumi s'po e zinte. Balli i ishte mbuluar me djersë të ftohta. Një peshë i rëndonte në krahëror. Më e rëndë se pagjumësia dhe lufta e paprerë, ishte përgjegjësia që mbante mbi vete. Por, nga ana tjetër, ai ishte i lumtur për shpirtin luftarak, për vendosmërinë dhe forcën e karakterit të partizanëve, të cilët ishin të pregatitur për të përballuar çdo vështirësi e mungesë.

Në agimin e ditës tjetër, shtabi i veprimeve, duke parë se pothuaj të gjitha batalionet nuk kishin municion për të vazhduar luftimin, urdhëroi këmbësorët e pozitave të Gurit të Kamjes dhe, për të ndaluar përparimin e armikut, dërgoi batalionin «Tomorri» i cili, pas një udhëtimi shumë të lodhshëm, në mën-

gjesin e datës 17 dhjetor, mbërriti në fshatin Moçan të Gorës.

Ndërkohë, fuqitë gjermano-balliste po marshonin nga Osnati në dy kolona me drejtime të ndryshme. Njëra prej tyre, pasi zuri Dërdushën e Grybecin, sulmoi në befasi batalionin «Tomorri» në Moçan, por partizanët u përhapën në pozicione luftimi, ndërprenë sulmet e tyre dhe u hodhën në kundërsulm, duke i shtyrë ata deri në afërsi të Grybecit e të Marianit.

Kjo përpjekje e armikut për të asgjësuar forcat partizane në Mokër dhe Gorë, i kushtoi atij shumë të vrarë e të plagosur.

Një heshtje e thellë sundonte në spitalin e Krushovës dhe në tërë fshatin, heshtje që prishej vetëm nga gjëmimi i mbytur i luftës që vinte prapa kodrave.

«Çfarë bëhet te Rizai¹ tani?» Kjo pyetje e shqetësonte Tekiun. Me duar të lidhura prapa kokës, ai i kishte ngulur sytë në flakën e llambës me vajguri. S'kishte dyshim se në këtë sektor forcat gjermano-balliste ishin thyer. Të plagosurit që dergjeshin nëpër shtretërit e tjerë, e vështronin Tekiun me bishitin e syrit dhe ndjenin një gëzim të madh që Partia e kishte emëruar komandant të shtabit të qarkut të Korçës. Nderi që i bëhej atij, ishte edhe nderi i batalionit «Skënder Çaçi». Partizanët interesoheshin dhe kujdeseshin për të shumë më tepër se për veten e tyre.

1. Riza Kodheli — komandant i batalionit «Tomorri».

Në fshatin Osojë, ditët e shkurtra të dimrit zvarriseshin njëra pas tjetrës dhe Tekiu dalëngadalë po e merrte veten. Po këmba ende i dhimbte dhe sidomos kur bënte ndonjë lëvizje të tepërt. Sidoqoftë, kishte filluar ta përdorte nga pak. Kur nuk e shikonte njeri, e ushtronte këmbën me këmbëngulje duke rënkuar nga dhimbja dhe inati. As plaga dhe as vuajtjet nuk e ndalnin në vend Tekiun dhe nuk e shkëpusnin nga zhvillimi i luftimeve. Ai orë e çast pyeste për veprimtarinë e armikut, për moralin dhe municionin e partizanëve. Kjo lidhje e vazhdueshme ishte për të shumë e vlefshme dhe e domosdoshme. E ndjente veten në mes të luftës, i shihte të gjitha dhe dinte se ç'ndodhte atje, në krahun e majtë të lumit Devoll, që nga Tresova gjer te Ura e Verbës, ku kishte zënë vend batalioni «Tomorri».

Ishin ditët e fundit të vitit 1943, kur korrieri i solli Tekiut një letër. Ai ia rrëmbeu nga dora, u kthye në bri, se kështu i vinte më rehat, dhe filloi ta lexonte me etje. Fytyra i shkëlqeu nga gëzimi. Në Voskopojë formohej Brigada IV Sulmuese, një formacion i fuqishëm partizanësh që do t'i jepte goditje serioze armikut. Por si mund të rrinte i gozhduar në vend e larg forcave në luftim, kur në këto ditë situata ishte shumë e vështirë dhe zhvilloheshin ngjarje kaq të rëndësishme? Papritur e ndjeu veten të shëndoshë, gati për të braktisur shtratin dhe për të marrë pjesë në luftë. Ky lajm ishte ilaçi më i mirë për të cillin tani kishte aq nevojë Tekiu...

OPERACIONI I MADH I DIMRIT

Vrojtimet dhe sulmet lokale të gjermanëve në drejtim të Gjergjevicës e Voskopojës u shtuan. Kundër këtyre fshatrave armiku kishte ndërmarrë dhe veprime të tjera shtrëngimi e terrori. Ai kishte bllokuar rrugët për në qytet dhe në zonat e fushës, me qëllim që fshatarët e krahinave malore të mos merrnin dot bërëqet e të gjunjëzoheshin nga uria.

Lajmet që vinin nuk ishin aspak të mira. Komanda gjermane po grumbullonte në Korçë trupa të shumtë alpinë dhe një numër të madh xhandaro-balistësh, të cilët do t'i lëshonte në drejtime të ndryshme për të larë hesapet me forcat partizane të Brigadës IV Sulmuese e të shtabit të qarkut të Korçës. Për t'ia arritur këtij objekti, ajo bazohej në epërsinë e forcave e të teknikës së saj luftarake, në mungesat e shumta që kishin partizanët dhe në stinën e dimrit. Dhe planin e vuri në zbatim. Ajo marshoi në tri kolona me drejtim: Senisht-Krushovë-Osojë, Lavdar i Korçës — kullat e Gjergjevicës dhe Vithkuq-Shtyllë. Një kolonë tjetër me bazë Ersekën mori për Qafëzez-Selenicë e Pishës-Qafë Martë.

Shtabi i Brigadës IV dhe ai i qarkut të Korçës, duke parë se pushtuesi po fillonte një operacion të madh, urdhëruan forcat e tyre të zinin majat e ma-

leve: Kullat e Gjergjevicës, Voskopojës, Lozhanit, Vithkuqit dhe Selenicës së Pishës.

Ditë të vështira... Përpjesëtimi i forcave dhe i teknikës luftarake ishte shumë i madh në dobi të shkelësve të huaj e tradhtarëve të vendit. Megjithatë, partizanët, sipas detyrave që kishin marrë, nuk ngurruan të hidheshin mbi ta. Më 8 e 10 janar, ata me komunistët në krye, nuk u tundën nga vendi, por me plagë në trup vazhduan të luftonin si heronj dhe, në një të ftohtë që të ngrinte pushka në dorë, mbrojtën tokën, nderin, jetën e nuk i lanë pushtuesit të bënin përpara. Mirëpo qëndresa kishte kufi. Kundërshtarët e shtuan presionin e zjarrit dhe me sulme të vazhdueshme në mbrëmjen e 10 janarit u futën në fshatrat e Rrëzës së Korçës.

... Netët kalonin me shqetësime dhe orët e çlodhjes qenë të pakta. Ishte nata e tretë që partizanët nuk po bënë asnjë sy gjumë.

Në agimin e 11 janarit, në një heshtje të plotë e nëpër mjegull, pa pregatitje artilerie, një ushtri gjermane e maskuar me uniformë dimri rrëshqiti si një zinxhir i shtrembër dhe qëlloi pa pushim për të shfarosur me hekur e zjarr partizanët. Si e çmendur ajo u turr përpara e u hodh nga një sektor në tjetrin për të hapur një vijë kalimi përmes një muri, i cili si me sustë u mbyll përsëri dhe e flaku nga pas. Qëndroi në vend, u mblodh dhe nuk mundi t'i kërcente në fyt brigadës së re që nuk lëvizi asnjë hap. Më vonë, për partizanët, gjendja u bë shumë e rëndë. Vijat e tyre u rrahën vazhdimisht nga një zjarr i pandërprerë dhe qëndresa e gjatë në rrugë frontale i detyronte të bënë gjithnjë një hap prapa. Fundi i kësaj dite ishte i tmerrshëm. Luftimet morën karakterin e sulmeve dhe të kundërsulmeve nga të

dyja anët. Në krahun e majtë, sulmet gjermane për të marrë Osojën u thyen tri herë, ndërsa në krahun e djathtë në drejtim të Gurit të Bardhë, u thyen katër herë me radhë. Pozicionet e zëna u mbajtën deri natën vonë dhe u lanë vetëm me urdhër, sepse qëndresa përpara trupave të mëdha të armikut do të sillte humbje.

Dita mbaroi. Larg, prapa majave të maleve të mbuluara me re të rënda e të ftohta, dëgjoheshin krisma e gjëmime të dobëta... Hitlerianët futeshin në Krushovë, Voskopojë, Shipckë, Gjergjevicë, Vithkuq dhe, sipas «rendit të ri», rrënonin çdo gjë që gjenin përpara.

Fjala mbi terrorin nazist mori dhenë. Fshatarët përcillnin kafshët e bagëtisë dhe braktisnin shtëpitë. Me qindra njerëz, me fytyra të mavijosura nga të ftohtit dhe me dhëmbë të shtrënguar zvarrisnin me mundim këmbët përpjetë maleve për të kërkuar strehë të farë e fisi ose të miqtë. Situata bëhej gjithnjë e më e vështirë. «Meteorët» ngjyra-ngjyra kryqëzoheshin nga ana e Shkozanjit dhe e Lekasit.

Shokët e shtabit të brigadës dhe ata të qarkut të Korçës, të mbledhur në një dhomë të vogël në Lavdar-Opar, bisedonin e shkëmbenin mendime, mbase një forcë e madhe armike, e ardhur nga Berati, kishte dalë prapa krahëve në Opar e Mazrek dhe rrezikonte të mbyllej rrethimi.

— Kjo situatë na vë përpara përgjegjësive të mëdha, — tha njëri prej tyre, — prandaj duhet ta kuptojmë mirë se, për të dalë nga kjo gjendje, puna do të varet kryesisht nga zotësia jonë e manevrimit.

— Nuk duhet një ndërrim i thjeshtë vendi, po një lëvizje, aty ku s'e pret kundërshtari, — plotësoi një tjetër.

— Kjo është e drejtë, — shtoi një shok që rrinte pranë Tekiut, — po nganjëherë është më mirë të mos tërhiqesh, por t'i thyesh hundët armikut, t'i humbasësh nga sytë dhe t'i hidhesh përsëri...

— E si mund të veprojmë kështu, — u hodh i pari, — kur partizanët i kemi të lodhur, të pangrënë, vazhdimisht në përpjekje e në të ftohtë, pa gjumë dhe, ajo që është më e keqja, shumica kanë nga 5-10 fishekë e mitralozat nga 2-3 karikatorë?

— M'gjithatë, moralin e kanë të lartë...

— Ashtu vërtet, po në këto kushte dhe me të tilla të dhëna rreth armikut si këto që kemi ne, nuk mund të qëndrojmë gjatë. Ai do të na dërmojë...

— Unë mendoj, — e mori fjalën Tekiu pa e ngritur zërin, — se duhet t'i grumbullojmë batalionet dhe të çajmë rrugën duke luftuar me forca plotësisht të përqëndruara...

Më në fund ata arritën në përfundimin që të këputej kontakti me armikun dhe partizanët të drejtoshin për në Qafën e Beçit.

Urdhri u dha, mirëpo të dhënat rreth armikut nuk qenë verifikuar plotësisht. Batalioni «Tomorri», që ishte në Kuç të Skraparit, ende nuk kishte njoftuar se ku ndodheshin trupat gjermane dhe nga lëviznin. Pra, përse i përkiste drejtimin të manevrimit, dolën mendime të ndryshme. Pasi i peshuan të gjitha rrethanat, ata arritën në përfundimin se ishte ende shpejt.

Vazhdonte nata e 11 janarit. Nga «Barrakat e Raqit» dhe nga depot qendrore të «Bakullit», dilte tym e flakë. Asgjë në dorë të armikut nuk la grupi i fundit që ishte për zbulim. Ai u tërhoq me dhimbje në shpirt, sepse në to digjej pasuria e bereqeti i popullit, vuajtja e sakrificat....

Aty nga ora katër e mëngjesit të 12 janarit, partizanët ngjithnin të përpjetën e vështirë të Lavdar-Oparit. Kjo rrugë u dukej sikur i shpinte në qiell, sepse ajo ngjitej gjithmonë dhe shkonte e humbiste në retë. Fshati nuk dukej. As qielli. Mjegulla mbulonte gjithçka. Ata e merrnin me mend se matanë ngrihej e përpjeta dhe Qafa e Beçit, të cilën, edhe sikur ta ngjithnin me barkun plot, ishte e pamundur të mos mallëkonin me mijëra herë. Kurse partizanët kishin katër ditë pa bukë dhe pa gjumë, pa i zënë në gojë përpjekjet me gjermanët.

Më në fund mbërritën mbi Brozdovec, drejt shpatit verior të Ostrovicës dhe qëndruan në kurrizin e saj, në pyllin që shtrihej deri në krye të Beçit, me lartësi mbi 2000 metra.

Kurrë ndonjëherë ky pyll shekullor, i paprekur e i humbur në thellësi të Oparit, nuk kishte parë kaq shumë mysafirë.

Vazhdimisht vinin e vinin partizanë, popull dhe kafshë. Tekiu, që kishte qëndruar pak mënjane, ishte kthyer majë shalës së kalit dhe vështronte sa njerëz kishte prapa. Në fytyrat e enjtura nga pagjumësia dukej një buzëqeshje e lehtë. Të tjerët, që ecnin pas, kur shikonin kurrizin e tij pak si të përkulur që e njihnin shumë mirë, e ndjenin veten të qetë se kishin atë në krye.

Mbasdite të gjitha forcat u përqëndruan në pyllin e Beçit dhe prisnin të binte nata. Papandehur një aeroplan vëzhgues armik u vërtit disa herë lart në qiell e hodhi trakte. Partizanët nuk u tundën nga vendi, madje disa përtuan edhe ta vështronin. Asnjë përshtypje. Kërcënimet nuk trembën njeri. Ndaj të ngrysur, kur malet po errësoheshin, mbërriti batalioni i 1-rë i Brigadës IV Sulmuese, i cili ishte gjii-

thë ditën roje në Qafën e Tudasit. Pak më vonë batalioni «Tomorri» dërgoi këtë letër: «Në qoftë se keni vendosur të delni në Skrapar, për mendimin tonë, duhet të kaloni sa pa e zënë armiku Faqekuqin». Me këto të dhëna u largua mjegulla që fshihte enigmat e situatës. Shokët udhëheqës, të vendosur për të kryer deri në fund detyrën e ngarkuar nga Partia, u tërhoqën mënjanë, çmuan drejt situatën dhe morën vendim: «Me shpejtësi e vendosmëri të përfitohet nga errësira dhe të gjitha forcat të tërhiqen në drejtim të Qafës së Beçit, të dalin nga ana e Skraparit e të godasin në krah armikun».

Menjëherë filluan përgatitjet për udhë dhe nëpër batalionet u bënë mbledhjet e Partisë e të rinisë. Mandej, kur toka filloi të grinte dhe borë nuk binte, komandantët e komisarët i ndanë shokët në mënyrë të tillë që në çdo kompani të kishte komunistë, të cilët do të ishin shembull vendosmërie, guximi e trimërie. Para se të niseshin për marshim, komisarët u bënë thirrje luftëtarëve që të vinin tërë forcat për të mundur pagjumësinë, të ftohtit, urinë, lodhjen e të ishin të gatshëm në çdo çast për të goditur armikun. Situata që e qartë. Partizanët dëgjonin në heshtje dhe të përqëndruar. Në fytyrat e lodhura e të ashpra shprehej besimi dhe bindja se shtabet do t'i nxirrnin nga kjo grackë, prandaj s'kishte asnjë arsye për t'u vonuar. Duhej të niseshin pa humbur kohë. Të gjithë u ngritën në këmbë. Të plagosurit i duruan dhimbjet, hipën në kuaj dhe në errësirën e natës u vunë në ecje. Në pararojë që batalioni i 2-të, ndërsa në pararojë batalioni i 4-t. Bashkë me forcat e Brigadës IV Sulmuese ishin partizanët e shtabit të qarkut, të sëmuret e të plagosurit, anëtarët e këshillave nacionalçlirimtare, aktivistët që punonin në

terren, partizanë e robër italianë si dhe fshatarë nga Rreza, Gora e Opari që kishin rrëmbyer armët. Gjithsejt mbi 2500 vetë.

Në heshtje të madhe kolona filloi të lëvizte.

Partizanët zvarrisnin këmbët dhe me sy të përgjumur ecnin nëpër terr. Dalëngadalë gjymtyrët, që u ishin paralizuar nga të ftohtit, zunë t'u shpiheshin. Duke shkeiur mbi gjurmët e shokëve, ata mbanin një largësi të vogël nga njëri-tjetri dhe ngjithnin një të përpjetë pambarim drejt pyllit që i përpinte.

— Ta marrë djalli! Sa rrugë e gjatë! Kjo s'ka të mbaruar, — tha një partizan që mezi çapitej.

— Sa gjumë që kam! Si i bëhet halli? — u dëgjua një zë vajze që nga prapa.

— Hajt, shtyni këmbët, — u përgjigj tjetri. — Nuk do të rrimë këtu, de!

— Eh, sa mirë do të ishte sikur të ecja pas kalit, me duar të mbështetura në bisht dhe të dremisja ndonjë minutë! — tha një tjetër.

Ecnin e ecnin pa pushim, po në çdo hap u pritej fuqia dhe e ngadalësonin marshimin. Vargu shumë herë këputej dhe kolona detyrohej të qëndronte sa të vendosej lidhja. Aty-këtu, partizanët me këmbë të gjakosura e të enjtura, mbeteshin prapa dhe lëshoheshin mbi borë.

«Përpara! Çohuni! Ngrehuni!» Këto fjalë kalonin gojë më gojë dhe pastaj kolona gjallërohej përsëri. Por përsëri këputej. Sa keq! Vende-vende disa shtriheshin përdhe, përqafonin tokën dhe binin në gjumë të ëmbël. «Ngrehu, ngrehu, o shok! O shok, mos fli!». Dhe ata përmendeshin, ngriheshin, tendosnin nervat, shtrëngonin trupin. Kokat i kishin të rënda dhe tëmthat u rrihnin. Vetëm një mendim qëndronte vazhdimisht i gjallë tek ata: të ecnin, të

duroin, të mos flinin. Megjithatë, dukej sikur e kishin lënë fatin e tyre në duart e komunistëve, të cilët ishin shndërruar në një forcë që qëndronte lart mbi të tjerët.

Sa kishin që po marshonin? Ndoshta një vit... Dhe rruga s'kishte të sosur.

Edhe Tekiu e ndjente veten aq të lodhur sa që i dukej se s'ishte në gjendje as të ngrinte dorën që shtrëngonte rripin e pushkës së hedhur mbi sup. Kishte kaq net pa gjumë... Disa herë ai u rrëqeth dhe u tendos në yzengjitë, sepse këmbët i qenë bërë akull dhe plaga i dhimbte shumë, por këtyre torturave u qëndronte me këmbëngulje. Kujt mund t'i shkonte ndër mend se Tekiu ishte i lodhur ashtu si dhe të tjerët dhe se donte të flinte?.. Askujt. Ai të jepte gjithmonë përshtypjen e një njeriu plot gjallëri...

Më në fund pararoja, duke çarë borën që ishte më tepër se dy metra e trashë, mbërriti në krye të Qafës së Beçit, në të vetmin shteg që kishte mbetur i hapur nga çizmjat naziste. Menjëherë në të dyja anët e saj u vendosën mitralozat. Një kompani zuri pozicion luftimi. Pjesa tjetër zbriti poshtë dhe u fut në pyllin e dendur me ahe për të pritur forcat e tjera që do të vinin. Shpëtimi ishte vetëm shpejtësia. Vonesa më e vogël do të qe vdekje, mbasi atje ku qafat takoheshin për të krijuar kalimin e Beçit, partizanët lanë prapa kufomën e njërit prej pararojës gjermane që shpejtonte të priste të vetmen rrugë tërheqjeje.

Matanë qafës, vargu i pambaruar zbriti tatëpjetën nëpër borën e pashkelur dhe kaloi përmes pritave plot rreziqe, pa ditur se nga mund t'i vinte ndonjë breshëri plumbash.

Armiku heshtte dhe nuk qëllonte. Siç dukej,

flinte i shkujdesur, pa sigurime dhe patrulla vëzhguese. Ai ishte në çdo fshat dhe nuk i shkonte ndër mend se disa qindra hapa larg tij, partizanët kalonin si hije në luginën e lumit të Kapinovës dhe kapërcenin zallin në një heshtje varri.

Befas tri krisma pushke u dëgjuan njëra pas tjetrës. Pastaj... heshtje e thellë. Të gjithë u çuditën nga këto buçitje të papritura. Dhe, megjithëse lodhja i kishte dehur e këmbët u shkonin sa andej-këndej, ata i shumëfishuan përpjekjet.

Më në fund zbardhi dita e 13 janarit. Përpara syve të përgjumur u doli fshati i mbuluar me borë. Ndoshta ky fshat ishte i zbrazur... Megjithatë, ata shpresonin se diku do të kishte mbetur ndonjë që do t'i ftonte pranë zjarrit, ku do të kishte pa dyshim ndonjë kusi ose poçe që valonte, mos më mirë, të paktën me fasule. Por edhe sikur të kishte vetëm zjarr, do të kënaqeshin.

Mbërritën në fshat. Fshatarët e Potomit i pritën me gëzim. Por shtëpitë e fshatit ishin të pamjaftueshme për t'i strehuar, dhe një pjesë e forcave u drejtuan për në Gjergjovë. Bukë s'kishte, por ata nuk u dëshpëruan. Atje ku kalonin gjermanët dhe tradhtarët, një gjëmë mallëkimi rëndonte mbi tokë. Magjet dhe pusët ishin shkretuar. Edhe kovat i kishin rrëmbyer.

Tërheqja e organizuar përfundoi pa ndonjë përpjekje serioze. Manevrimi i shpejtë bëri që plani të realizohej, veçse me sakrifica të shumta. Asnjë njeri nuk mbeti në rrugë. Pas kaq ditësh luftimi, pagjumësie, urie e lodhjeje, partizanët u shtrinë për tokë, se s'duronin dot më. Njëri pas tjetrit, humbën në gjumë. Përveç rojeve që ndjenin vështirësi në shër-

bimin e tyre, të gjithë flinin ashtu siç ishin me rroba të qullura dhe me gjunjët të mbledhur në bark.

... Kaloi mjaft kohë dhe partizanët u zgjuan. Gjumi po ia linte vendin urisë. Kjo ishte një betejë e ashpër, sepse edhe durimi kishte kufi. Por ja, shokët e intendencës sollën misra të zier, të cilat i ndanë drejtësisht, me numër, nga dhjetë kokrra për shoq. Kishin uri të madhe.

Mandej, megjithëse të kapitur, s'menduan për asgjë. Veçse të ishe e të shikoje: vendi buçiti nga këngët e vallet. Disa partizanë, të magjepsur nga kënga, qëndronin me kurriz të mbështetur pas gardhit dhe, të zhytur në ëndërrime, shikonin degët që përpiheshin nga flakët e rrëmbyera. Të tjerë pinin duhan, pastronin armët dhe, duke e ndjerë veten kryelartë që i kishin kaluar pengesat e vuajtjet, bisedonin.

— Nuk më besohet kur mendoj se nga kemi kaluar. Po e vërteta është se ishim të qetë, me besim në fitoren, në të ardhshmen, në Partinë...

— Ne do të jetojmë dhe do të tregojmë për këto ditë lufte kundër armikut e dimrit të ashpër e të pamëshirshëm.

— Këto ditë do të mbeten të skalitura në kujtesën tonë dhe në atë të popullit, more shok!

Tekiu, që ishte hequr imënjatë, dëgjonte duke vështruar në hapësirën midis veshëve të kalit, përtej përroit, ku të tjerët kërcenin dhe këndonin:

*Apo zënë ta dëgjova, moj,
Kur më ngjitje shkallët... ëëë...*
.....

— Kur shikon sy që xixëllojnë plot gëzim e hare dhe kur dëgjon këngë e biseda të tilla, — i tha Tekiu

shokut që kishte pranë. — kushdo që të jetë do të thotë se me njerëz të tillë s'ka se si të mos fitohet...

Fshatarët e Potomit, të Gjergjovës, të Koprencës e të Grabockës, megjithëse të vobektë, e ndanë kafshatën e fundit të bukës me partizanët, të cilët qenë përhapur majë maleve dhe në mes tufanit bënin roje. Gjysmat e forcave pushonin, të tjerët ruanin.

Në mbrëmjen e 19 janarit, forcat kryesore të Brigadës IV Sulmuese dhe batalionet e shtabit të qarkut të Korçës, që ndodheshin në Panarit, u vunë në lëvizje në drejtim: Panarit-Shtyllë-Tudas për të goditur armikun. Në këtë kohë, trupat gjermane largoheshin nga zonat që përkohësisht i kishin pushtuar dhe në to linin bashibozukët e «Ballit», sepse, sa më thellë futeshin në male, aq më shumë i ndjenin vështirësitë dhe mossukseset për të realizuar qëllimet e tyre.

Në mëngjesin e 20 janarit, praparoja e kolonës naziste u sulmua në Shtyllë nga forcat partizane, të cilat, pasi hynë në Vithkuq dhe në Selenicë të Pishës, vepruan në drejtim të Lubonjës e të Qafëzezit. Të tjerët u futën në krahinën e Oparit dhe goditën tradhtarët në Marjan e Gurrë-Mujas. Në Tudas kapën disa robër dhe në Lavdar-Opari gjetën mishra të pjekura, bagëti të gjalla e bereqet, që tradhtarët ia kishin grabitur popullit.

Ballistët, të shtyrë në thellësi, mbaheshin në Dushar, Moglicë e gjetkë nga ku kanoseshin përsëri duke vjellë zjarr si të tërbuar. Në këtë kohë, meqenëse ndërlihdja ishte ndërprerë, një numër partizanësh u tërhoqën nga Lavdar-Opari për të kaluar në Backë, mbasi informata jo e saktë, që kishte mbërritur, njoftonte se forca të shumta armike ndodheshin

në Shtyllë, Gjergjevicë e vende të tjera dhe do të sulmonin përsëri në Opar. Në mesditën e 25 janarit, partizanët ngjithnin të përpjetën që fillonte nga Çëmërica për në Qafën e Martës, ku bora kalonte belin. Në çdo pesë minuta skuadrat shkëmbeheshin njëra pas tjetrës, ndërsa kafshët e ngarkuara rëndë ecnin me vështirësi të madhe, sepse tufani, që vinte nga maja e Ostrovicës, ua rrihte kokën si me çekan dhe i bënte të hingëllinin herë pas here plot dhimbje. Afër qafës, disa kafshëve u ngelën këmbët në vend dhe s'bënin dot asnjë hap përpara. Partizanët ua hoqën ngarkesat e i ndanë midis tyre. E përpjeta mëndt i mbyti, po më në fund e ngjithën.

Në qafë qe tufan i madh. Dukej si e pamundur të kalohej edhe duke fluturuar. Ishte e shkurtër, vetëm pesëdhjetë metra, po s'kishte të mbaruar. Të ftohtit të thante. Era që vinte rrotull me tërbim, kërcënonte t'i kthente njerëzit në cingërima të akullta. Rrugë s'kishte. Këmbët shkelnin plot dhe bosh. Atje ku pandehje se shkelje plot, këmbët fundosehin thellë. Madje dhe trupi bashkë me to. Duhej të ngriheshe vetë. Shoku që ishte përpara, s'të shihte. As ai i prapmi nuk të shihte. Vargu vazhdonte rrugën.

Kuajt me shumë mundime u hodhën përtej. Katër mushka të mëdha ngordhën nga të ftohtit. Dy të tjera i harxhuan forcat e fundit dhe u zhytën në borë deri në gjoks. Mbetën.

Por sa i fortë ishte njeriu me yll në ballë! Asnjë nuk mungoi!

Fshatarët e Backës pandehën se partizanët zbritën nga qielli. Ata, megjithëse ishin lindur e rritur në këtë vend, ia kishin frikën Qafës së Martës me

lartësi mbi 2300 metra, të cilën nuk e kalonin dot as kur binte shi në tetor.

Të tilla qenë vështirësitë dhe vuajtjet e pambarruara në mes të një dimri jashtëzakonisht të egër.

*
* *
*

Faza e parë dhe më e rëndë kishte kaluar. Tani që ishte faza e dytë, spastrimi i territorit nga pushuesit e tradhtarët, Partia dha kushtrimin: «Mos e lini armikun të marrë frymë asnjë minutë. Ndiqeni këmba-këmbës natë e ditë! Asgjësojeni...!»

Ofensiva naziste duhej të thyhej e pastaj forcat tona të kalonin në kundërmësymje. Përbindshi duhej të goditej për vdekje.

Të gjitha forcat partizane të qarkut të Korçës u vunë në sulm. Ato nuk ecnin, por fluturonin për Kolonjë, Vithkuq, Opar e Gorë, duke e ndjekur armikun hap pas hapi. Ngado që shkelnin këmbët e tyre, shpëtonin popullin nga tmerrri i vdekjes, masakrat dhe djegiet.

Fshatarët, të fshehur dhe të përhapur nëpër pyje e male, nuk kuptonin se ç'po ndodhte. Kur mësonin se fshati ishte plot me partizanë, ktheheshin në shtëpitë e tyre. Me duar e me sy i përgëzonin, dridheshin dhe me zor i mbanin lotët e gëzimit. Sipas armiqve, ata ishin të shfarosur dhe të asgjësuar krejtësisht, mbasi gjermanët e veglat e tyre kishin trumbetuar me gojë e me shtyp se s'ka mbetur këmbë partizani. Kështu llogotishin mbarë e mbrapsht, mundoheshin t'ia kalonin njëri-tjetrit dhe i paraqitnin si të vërteta «faktet» e supozimet e tyre, se çdo gjë ishte

përlarë nga themeli. Këtyre fjalëve populli nuk u zinte besë dhe pyeste:

— A është e mundur t'i kenë vrrarë të gjithë gjer te i fundit?

Dhe të tjerët, që s'trembeshin lehtë e nuk e humbisnin toruan, sepse komunistët e aktivistët e Frontit nuk lejonin të binte morali i tyre, përgjigjeshin:

— Ata flasin kot. Të gjithë partizanët nuk i hedhin dot në dorë.

— Nuk e zhdukin dot Partinë.

— Jo, i kanë duart e shkurtëra.


— Ju lumtë goja, — e merrnin fjalën të parët, — po kemi kohë që s'dëgjojmë më pushkë dhe s'i shohim djemtë tanë. Le të vinë një herë pa edhe sikur të na djegë dushmani, s'do na vinte keq. Më mirë ashtu se kështu.

— Në kanë shkuar larg, prapë do të afrohen. Puna është që të mos e humbasim besimin, — ua kthenin duke tundur kokën e të menduar ata që ishin lidhur më ngushtë me luftën e Partinë Komuniste.

Fshati ziente nga gjallëria. Ngado shikoje grupe-grupe partizanë e popull. Bisedonin gojë më gojë dhe sytë u shkrepëtinin nga gëzimi. Mëma të drithëruara pushtonin e shtrëngonin në krahë djemtë e tyre. I puthnin e lotët e gëzimit u derdheshin çurk. Belbëzonin me zë të prerë diçka të mbytur, fjalë të zemrës. Ata buzëqeshnin. Skena që të mallëngjejnë. Baballarët nuk u ndaheshin djemve e nipërve. U rrinin për bri e s'kishin të çmallur.

Më tej, në mes të një lëmi, të tjerët ia thoshin këngës:

*Ato maja rripa-rripa se ç'gjëmojnë,
Ndizet lufta për liri e dërdhet gjak,
Janë trimat partizanë që luftojnë,
Janë bijtë e Shqipërisë që marrin hak.*



Në mbrëmje, shtëpitë u mbushën plot e përplot me partizanë. Gëzimi i madh që ndjehej kudo, largonte zinë, brengën dhe helmin që kishte çdo vatër. Gratë e vajzat nxirrnin për të ngrënë gjithçka kishte mbetur nga ato që armiku nuk kishte mundur t'i merrte me vete. Dhe në çdo bazë dëgjoheshin këto fjalë:

— Ta dini, more djem, se ç'lemerira ka parë ky fshati ynë! Ta dini sa jemi tronditur... Lere, lere. Zanati i tyre ishte të rrëmbenin, të digjnin dhe të vrisnin. Ditë e natë nuk mbyllëm sy dhe vdekjen e prisnim orë e çast. S'mundnim të ndiznim as zjarr që të ngroheshim e të thaheshim, se të ndizje zjarr do të thoshte t'i bëje shenjë të paudhit që të qëllonte qorrazi dhe papushim, sa malet dridheshin nga zhurma e batareve. Në ato çaste mendonim për ju dhe kishim besim se do të vinit të na shpëtonit.

Në drejtim nga lindja vinin e vinin papushim njerëz të lodhur, të cilët ktheheshin në fshatrat e çliaruara, po në vend që të gjenin fshatin e dashur, shikonin përpara tyre gërmadha.

Të tjerët që shkonin poshtë e lart për të gjetur ato që kishin fshehur ndër shpella ose pyje, ndalnin në këto vende dhe ia fillonin bisedës:

— Nga ata, — thoshin, — priti të gjitha. E thaj-në vendin kudo që shkelin...

— Hë, po andej nga ju? — i pyesnin.

— Si kudo, — përgjigjeshin ata duke shkundur
krahun.

— Kanë bërë dëme?

— E ç'pyet?!

— Ashtu ë, po qenat e thyen qafën...

— Vetëm të fitojmë lirinë, pa shtëpitë do t'i
ngrehim përsëri, ashtu siç i kemi ngritur edhe më
parë, apo jo?

*
*
*

Deri në fund të muajit shkurt partizanët arritën të çlironin të gjitha krahinat që kishte shkëlur push-
tuesi dhe vazhduan goditjet kundër pozitave të tija
në dyert e Korçës, Pogradecit, Ersekës e Bilishtit.

Në këtë mënyrë, Operacioni i madh i Dimrit
dështoi plotësisht përpara heroizmit e patriotizmit që
Partia kishte ngjallur në zemrën e partizanëve, të
cilët u provuan në vuajtjet mbinjerëzore e në luftë-
rat e përgjakshme, ku aktet e trimërisë e të vetëmo-
himit qenë ngjarje të ditës. Gjatë kësaj kohe, radhët
e Partisë si dhe ato të batalioneve u shtuan e u for-
cuan me djem të rinj nga populli, i cili jo vetëm e
thelloi më tepër hendekun ndërmjet tij e tradhtarëve
të vendit, por e forcoi edhe më shumë qëndresën
kundër armikut, u bë më i ndërgjegjshëm, u lidh më
ngushtë me Luftën Nacionalçlirimtare dhe me Par-
tinë Komuniste që e udhëhoqi besnikërisht drejt
çlirimit.

NË NDIHMË TË POPULLIT

Krahinat malore të varfëra e të dëmtuara rëndë kishin marrë shumë plagë nga pushtuesit e tradhtarët, të cilët, duke mos bërë dallim midis popullit e ushtrisë, bënë një luftë totale dhe përdorën taktikën e tokës së djegur. Propaganda e tyre helmuese, vrasjet, terrori, kërcënimet e barbarizmat i kishin tronditur deri diku disa njerëz, të cilët, për të shpëtuar nga djegia, ishin larguar bashkë me familjet e tyre për në qytet.

S'ka gjë më të llahtarshme se kur di që të gjithë në familje janë të uritur, duan të hanë, dhe në shtëpi s'gjejnë asnjë krodhe bukë. Për të dalë nga kjo krizë e thellë ushqimore, kur gjendja e furnizimit ishte vështirësuar së tepërmi si për forcat partizane ashtu edhe për popullin, celula e Partisë e shtabit të qarikut vendosi të organizohej një kundërmësymje e fuqishme dhe e befasishme në drejtim të Rrëzës e fushës së Korçës, që ishte pushtuar nga armiku, të çliroheshin ato qoftë edhe përkohësisht, të merrej bereqet e të silllej në krahinat që vuanin nga uria. Për zbatimin e këtij vendimi u ngarkua Tekiu, i cili e kreu siç duhej këtë detyrë. Brenda pak ditëve natën e me shpejtësi, mbërritën në thellësi të krahinave të çliuara karvanë të ngarkuar me qindra kuintalë bereqet të eksponentëve tradhtarë dhe të

blera me fondet e Këshillit Nacionalçlirimtar të qytetit të Korçës.

Ndarja e drejtë e bërëqetit familjeve nevojtare çuditi fshatarët.

*
4 *

Bora kishte filluar të shkrinte mëpër fusha e lugina, por filladi i rrëmbyer i asaj pranvere mbante erë tym e zjarr. Gjatë muajit mars e prill, repartet e Brigadës IV Sulmuese dhe batalionet e shtabit të çarkut kryen një varg goditjesh kundër pushtuesve gjermanë e tradhtarëve në Biranj, Goçë, Koianec, Lumalas, Melçan, Dërsnik. Për të zbatuar urdhrin e Shtabit të Përgjithshëm të datës 5 prill 1944 për t'u hedhur në mësymje kundër pushtuesve gjermanë dhe tradhtarëve të vendit, ata hodhën në erë ura, prishën rrugën Korçë-Pogradec, Zvarrisht-Voskopojë, Vithkuq e Shtyllë. Çdo natë gjendeshin në portat e Korçës, Bilishtit, Ersekës dhe e mbanin armikun në gjendje alarmi të përhershëm. Nga vrulli i tyre luftarak, armiku dilte herë pas here nga strofka e tij, krijonte situata operative të favorshme, ndërmernte operacione lokale në afërsi të fshatrave rreth Korçës, në rrugën Korçë-Pogradec dhe me forca të mëdha sulmonte repartet partizane, të cilat rrallë tërhiqeshin në thellësi e kalonin në kundërmësymje, duke i dhënë armikut grushte të ndjeshme në Devoll, në Fushë të Korçës e në Mokër. Në dhjetëditëshin e dytë të prillit forcat e Brigadës I Sulmuese dhe të Brigadës IV Sulmuese zhvilluan me sukses operacionin e Pogradecit, çliruan qytetin dhe prenë komunika-

cionet e gruparmatës «E» midis Greqisë, Maqedonisë e Shqipërisë së Jugut. Kjo situatë e favorshme ngri-
ti më tepër moralin e popullit. Forcat partizane vazh-
duan punën për forcimin e pushtetit, të komandave
të vendit dhe për shtimin e radhëve partizane me
vullnetarë të rinj. Në këto veprime, Tekiu përherë
ndodhej pranë batalioneve për t'i udhëzuar dhe për
t'i prirë në luftë. Interesohej për stërvitjen taktike
të tyre, ndihmonte përgjegjësat, i mësonte ata prak-
tikisht si të goditnin armikun në rrugët automobilis-
tike dhe si të përdornin në stil të gjerë veprimet e
natës me njësi të vogla deri në Korçë.

Pas këtyre ngjarjeve, u mbledh celula e Partisë
e shtabit të qarkut dhe komunistët, sipas rendit të
ditës, morën në shqyrtim tri çështje:

Së pari, diskutuan për gjendjen e brendshme
dhe për luftën e pandërprerë që duhej të bënin kun-
dër armikut. Një vend të rëndësishëm zuri sqarimi i
situatës ndërkombëtare dhe punimi i komunikatave
nga Fronti i Lindjes. Ushtria e Kuqe kishte çliruar
Odesën, ishte në kufijtë sovjetikë dhe kishte filluar
ofensivën drejt Ballkanit.

Së dyti, pranuan në Parti dy shokë të sprovuar
në luftë.

Së treti, punuan udhëzimin e Shtabit të Për-
gjithshëm të datës 16 prill, i cili porosiste shtabet e
qarqeve të lajmëronin komandat e qarkut që të ur-
dhëronin komandat e vendit t'u jepnin ndihmë këshi-
llave nacionalçlirimtare kurdoherë që t'u kërkohej
për zbatimin e vendimeve të tyre ashtu si ishte për-
caktuar në direktivën e Këshillit të Përgjithshëm
Nacionalçlirimtar, që asnjë tokë e punueshme të mos
mbetej pa mbjellë. Nga ana tjetër, u vendos të ndih-
mohej populli në punët bujqësore, sidomos familjet

e dëshmorëve, të partizanëve, të fshatarëve të vobek-
të dhe të atyre që u ishin djegur shtëpitë.

Në lidhje me këtë pikë, pasi diskutuan të gjithë,
Tekiu tha:

— Në kohën e lirë, kur nuk jemi në luftë, ne kemi një fushë të gjerë veprimi për të ndihmuar këshillat nacionalçlirimtare të fshatrave, të cilat në rradhë të parë duhet të merren vesh me njëri-tjetrin në këmbimin e farërave dhe, në rast se ato nuk gjenden, të mbliidhen e t'u jepen bujqërve nevojtarë. Përveç kësaj, pjesëmarrja e çdo partizani në ndihmë të atyre që u mungojnë krahët e punës, do të krijojë lidhje të shëndosha dhe do t'u japë rast njerëzve, ashtu si na porositi Partia dhe Shtabi i Përgjithshëm, që të zhvillohet ndjenja e solidaritetit dhe të njihet karakteri popullor i ushtrisë.

*

*

*

Nga fillimi i majit, forcat partizane kishin rënë në hall se armiku nuk dilte hapur, bllokonte herë pas here qytetin, përforconte postbloqet dhe qëllonte me artileri Polenën, Voskopin e fshatra të tjera. Në rradhët e «Ballit» e të ermenëve¹) filluan dezertimet, u zgjuan të lëkundurit, të mashtruarit. Për të dalë nga kjo gjendje, armiku kishte filluar të grumbullonte forca në Korçë e të mbliidhte kafshë nga fshatarët. Të gjitha të dhënat tregonin se ai po përgatitej për një operacion tjetër të madh. Në një gjendje të

1 — Ermenët ishin robër, të cilët i përdornin gjermanët në punë të ndryshme dhe në luftë.

tillë, u hap lajmi se së shpejti do të mbahej Kongresi I Antifashist Nacionalçlirimtar. Kjo ngjalli te të gjithë gëzim dhe kudo u zhvilluan konferenca mbi rëndësinë historike të tij. Në batalione u caktuan një numër delegatësh, të cilët u zgjodhën njëzëri nga shokët e tyre. Ndër ta ishte edhe komandanti i shtabit të qarkut të Korçës, shoku Teki Kolaneci.

Në këtë kohë, për nevojat e Kongresit, Shtabi i Përgjithshëm i vuri detyrë qarkut të Korçës të dërgonte një sasi bulmeti, sende të tjera si edhe 35 kuintalë bereqet. Për t'i plotësuar këto kërkesa, vetëm populli ishte dhe mbetej hambar i pashtershëm. Po edhe ai që shkundur. Familje që kishin braktisur shtëpitë e djegura, të sëmurë e të plagosur, partizanë, lajmëtarë, të gjithë ushqeheshin e strehoheshin prej fshatarëve. E ç'mund të bënte ai në këto kushte? Maji ishte muaji më i vështirë për të, sidomos atë vit kur të lashtat e kaluara ishin të varfëra. Mirëpo bereqeti duhej mbledhur patjetër. Dhe për këtë kishte vetëm një mënyrë: hiq këtej, shtrydh andej, një dorë në një shtëpi, një okë në disa dyer të tjera, një shinik në Polenë dhe një kuintal në Bulgarec.

Në këtë etapë të vështirë, kur fshatari kalonte një krizë të tmerrshme ekonomike, se çmimet ngriheshin e vlefata e parasë binte vazhdimisht mbasi qeveria e renegatëve kishte derdhur frangat shqiptare me dengje në treg, Partia mori masa që asgjë të mos i shkonte armikut, por të organizonte tregtinë duke çelur tri pazare: në Lozhan të Gorës, në Shtyllë të Vithkuqit dhe në Slabinjë të Mokrës.

Në zonat e çliruara, nevoja e këtyre pazareve ishte shumë e madhe si për shkëmbimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, ashtu edhe për sigurimin e bukës së popullit. Me anën e këshillit nacio-

nalçlirimtar të qytetit, u sollën nga Korça kripë, pël-hurë, basma, penjë e të tjerë artikuj të tillë. Këshillat e krahinave u vunë në aktivitet dhe krijuan komisione për fushata të gjera në lesh e bulmet, me qëllim që të sigurohej veshja dhe ushqimi i partizanëve. Komisione të tjera u caktuan për shitje në ankand të pasurive komunale si pyje, kullota e të tjera dhe për organizimin e fondit nacionalçlirimtar në dobi të ushtrisë e të popullit. Ndërsa këshillat e komuneve e të fshatrave lajmëronin dhe ato pak familje që kishin braktisur fshatin e kishin hyrë në qytet që të ktheheshin sa më parë se toka kishte mbetur pa punuar, se luftëtarët e lirisë duheshin strehuar e furnizuar dhe se në qytet armiku, i tërbuar nga grushtet që hante, kishte filluar të arrestonte e të merrte masa edhe më të tmerrshme kundër popullit. Nga ana tjetër, ato u dhanë përkrahje të madhe reparteve partizane, duke u siguruar ushqime, veshmbathje, mjete transporti dhe të dhëna të dobishme mbi armiqtë. Veçanërisht, shtuan radhët me luftëtarë të rinj, ndihmuan të dëmtuarit nga lufta dhe mbajtën lart moralin e popullit.

Nga fundi i majit komunistët punuan traktin e shtabit të çarkut, i cili njoftonte mbi vendimet e Kongresit të Përmetit, ku populli këputi të gjitha lidhjet me të kaluarën e zezë, dënoi për jetë tradhtinë e doli përpara botës ashtu si sikishte qenë kurrë ndonjëherë. Formimi i Komitetit Antifashist Nacionalçlirimtar me Komandant të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shokun Enver Hoxha, birin më të dashur të popullit, që kishte drejtuar e qëndruar në ballë të luftës për liri, forcoi edhe më shumë qëndresën e vullnetit për luftë kundër pushuesve e tradhtarëve.

OPERACIONI I QERSHORIT

Armiku, i mbyllur në një darë të fortë brenda qyteteve, ishte nën zjarrin e vazhdueshëm të forcave partizane, të cilat nga dita në ditë vështirësonin në mënyrë serioze furnizimet dhe lëvizjet e tija në vijat më të rëndësishme të komunikacionit.

Përpara kësaj gjendjeje, komanda gjermane e forcave në Ballkan që shihte situatën në Lindje dhe rrezikun e mbylljes së rrugëve në rast tërheqjeje nëpër Shqipëri, u detyrua të grumbullonte përveç trupave të zgjedhur nga gruparmata edhe bashibozukë të «Ballit», «Legalitetit», xhandarë e të tjerë. Siç dukej, ajo po ndërmernte përsëri veprime luftarake në një shkallë më të gjerë kundër Ushtrisë Nacionalçlirimtare, të cilën shpresonte që, me veprime të rrufeshme dhe me goditje të përqëndruara, ta asgjësonte brenda 10-15 ditëve.

Ndërsa në Përmet po zhvillonte punimet Kongresi I Antifashist Nacionalçlirimtar, populli rrinte në çdo kohë në përgjim. Nga të gjitha anët vinin lajme për përgatitjet e gjata e sistematike të armikut. Pas disa ditësh, presioni u shtua dhe shtabet nuk kishin të bënin me disa luftime të rastit, por me një operacion të përgatitur me kujdes.

Në ditët e fundit të majit, fuqi të mëdha gjermane e mercenare, të përqëndruara në vende të

ndryshme, me të gjitha llojet e armëve më moderne, goditën batalionin «Fuat Babani» dhe mundën të shkelnin krahinën e lirë të Devollit. Mandej ato sulmuan nga Struga e Korça në drejtim të Pogradecit dhe të krahinës së Mokrës. Atje u ndeshën në qëndresën e ashpër të Brigadës IV Sulmuese, e cila mbronte një zonë shumë të gjerë. Megjithëse armiku hodhi trupa të shumtë dhe pas dy ditësh, pa llogaritur humbjet, kapi Gurin e Kamjes e pozita të tjera, ai nuk mundi të përparonte më tej e të bashkohej me kolonën që kishte ardhur nga Shpati në Moglicë, e cila u godit e u dërrmua nga një batalion i Brigadës I Sulmuese.

Në agimin e 5 qershorit, vendi u tund nga gjëmimi i topave prej Dërsniku gjer në Melçan. Kur zjarri u bë më i ashpër, një kolonë shumë e madhe armike u lëshua nga Korça e mori drejtimin Voskopojë, Vithkuq e gjatë lumit Devoll, për të mbytur në gjak repartet e shtabit të qarkut, të vendosura në pozicionet: batalioni «Skënder Çaçi» prej teqesë së Melçanit deri në Goskovë; batalioni «Tomorri» Voskop-Vithkuq dhe batalioni «Hakmarrja» nga Rehova në Psar të Zi.

Një ushtri e tërë e shoqëruar me autoblanda, zbriti me shpejtësi nga makinat, zuri vend buzë rrugës e hapi zjarr kundër një grushti luftëtarësh që qëndronin të patundur në lartësitë e kodrinave. Me kundërsulme të dendura, të shkurtëra e të furishme, forcat partizane nuk mundën t'i thyenin armiqtë e shumtë. Ato, përballë epërsisë së armikut, pas një ore u detyruan të kalonin në pozicione të tjera. Mirëpo nazistët, që prisnin çastin e volitshëm, shpërthyen sulme të tërbuara e të njëpasnjëshme në krahë të batalioneve «Skënder Çaçi» e «Tomorri» dhe me

forca të tjera bënë pykën e futjes drejt Voskopojës. Të udhëhequr prej tradhtarëve e të mbështetur pëllëmbë për pëllëmbë nga zjarri i artilerisë që rrihte vazhdimisht majat në thellësi të zonave malore, ata u lëshuan me vrap përpara dhe në formacion të hapur për të goditur në befasi. Nga ora 3 pasdite, në heshtje u afruan drejt Tudasit e Lavdar-Oparit, me shpresë që të prisnin e të vrisnin duke përfitur nga rrëmuja që do të shkaktohej. Mirëpo, një ditë më parë, Tekiu, me të mbërritur nga Përmeti, kishte kërkuar largimin e shokëve të plagosur nga spitali i Tudasit. Tani që oshëtimat e predhave jehonte e rrokullisej nëpër male dhe nga Lavdari vinin pleq e gra me fëmijë nëpër duar, me rrangulla e gjënë e gjallë për të mos rënë në dorë të armikut, Tekiu u nis për të vajtur pranë batalioneve. Lajmet që i vinin herë pas here tregonin se situata e tyre nuk duhej të ishte e mirë. Duke kaluar Tudasin, ai u qëllua në rrugë nga një batare plumbash. Kjo goditje rrufe ishte aq e papritur sa që Tekiu, duke e peshuar shpejt gjendjen, zuri pozicion dhe menjëherë filloi të shtinte kundër gjermanëve që vraponin midis shtëpive të fshatit. Ndërkaq arritën shokët dhe me luftë u tërhoqën pas kreshtës së përroit.

Pothuaj në të njëjtën kohë krisma të mbytura automatiku u dëgjuan edhe nga ana e Lavdar-Oparit, veçse përgjegjja u dha menjëherë. Mitrалozat e ngadalësuan përparimin e hitlerianëve që ngjiteshin me këmbëngulje në këto krahina të shkreta malore. Partizanët ua prenë rrugën, kundërsulmuan e rezistuan në të gjithë kufijtë natyralë, duke i mbajtur nën zjarr për derisa shumica të kalonte drejt lartësive nga ana e Brozdovecit dhe e Mazrekës.

Në kushte të tilla, batalioni «Skënder Çaçi», që

vazhdonte të qëndronte në pozitat e para, u tërhoq nga ana e Gorës dhe u bashkua me forcat e Brigadës IV Sulmuese, ndërsa batalioni «Tomorri», pasi rezistoi deri në mbrëmje, u largua në drejtim të Vithkuqit, sepse në shpinë të tij u krijua një darë që e kërcënonte për rrethim e asgjësim.

Të nesërmen, në orët e para të mëngjesit të 6 qershorit, lagjet e Vithkuqit dhe pozicionet e batalionit «Tomorri» u mbuluan nga shtëllunga tymi. Predhat e topave shembnin muret dhe banorët, të tronditur e të hutuar, braktisnin fshatin në flakë për t'iu shmangur rrezikut. Nga kjo pamje, luftëtarëve u copëtohej zemra, por nga ana tjetër u shtoheshin edhe më tepër urrejtja e hakmarrjes për të vazhduar me heroizëm luftën.

Pas goditjes me artileri, nazistët gjermanë, me mëngë të përveshura, me pantallona të shkurtëra dhe me automatikë në duar u vërsulën përpara drejt lagjes Grekas. Luftëtarët i lanë të afroreshin dhe pastaj, me zjarrin e pushkëve e të mitralozave, i kositën e i gozhduan në vend. Pas një ore, me luftime në pozita të zgjedhura e të favorshme, partizanët u derdhën në kundërsulm dhe i rrokullisën armiqtë drejt bregut të lumit, bashkë me rreth 30 të vrarë e të plagosur.

Gjermanët, pasi i paguan me gjak, si gjithnjë, mizoritë e dëmet që i sollën popullit, ndryshuan drejtimin dhe morën rrugën e Shtyllës për të dalë në Mashkullorë. Ndënkohë, artileria e tyre i mbante forcat partizane nën goditje që të mos kishin mundësi manevrimi. Por shtabi i batalionit, në përputhje me gjendjen e krijuar, vendosi të linte sektorin e Vithkuqit dhe të pregatitej për luftimet e ardhshme në thellësi.

Një pjesë e forcave të Divizionit I Sulmues, për të ndaluar fuqitë e mëdha të armikut, më 6 qershor u rreshtua në një vijë të shkëlqyer mbrojtjeje, rreth 3-4 kilometra, nga Qafa e Gurit të Prerë deri në Qafën e Gjarpërit. Në këto dy qafa kyçe, prej orës 12 deri në mbrëmje, u zhvilluan luftime aq të përgjakshme saqë ajri e toka dridheshin nga zjarri i pareshtur dhe dukej sikur çdo gjë, edhe malet, lëkundeshin e përmbyseshin. Atje çdo pëllëmbë tokë u pagua e u la me gjak, sepse çdo majë kodre u bë një kala dhe çdo grykë një varr për nazistët, të cilët lanë jo më pak se 200 të vrarë. Por edhe partizanëve këto luftime u kushtuan shtrenjt: 28 luftëtarë ranë dëshmorë.

Kësaj here pushtuesi nuk po hynte rehat-rehat nëpër fshatrat e çliruara, sepse çdo shkëmb, çdo gur e grykë u bë qendër qëndrese e pathyeshme. Sa më tepër që armiku futej në këto vende, aq më të egra dhe më të ashpra ishin përpjekjet me forcat partizane. Pushka partizane ishte në vendin e saj. Ajo dilte, qëllonte nga gurët, ferrat, vrimat, shpellat, shkëmbinj të dhe rrëpirat e prera thikë, madje dhe aty ku s'ta priste mendja kurrë të ndodhej frymë njeriu.

*
* *
*

Pas një udhëtimi të gjatë, Tekiu u takua në Panarit me shokët e shtabit të batalionit «Tomorri» dhe së bashku vendosën t'i jepnin një goditje dërrmuese pushtuesit. Në mbrëmje lëshuan patrulla dhe pa gdhirë mirë dita e 7 qershorit, krijuan xhepa

zjarrin në shtigjet kryesore prej nga mund të kalonte ai.

Gjermanët, pasi rrahën mirë e mirë me artileri e mortaja çdo kodër, pyll e qafë, marshuan në formacion luftimi në dy kolona drejt Mashkullorës dhe rreth orës 6, mbërritën në pozicionet e mbrojtura nga forcat e batalionit që s'qenë bërë fare të gjalla gjatë qitjeve.

Kur partizanët hapën zjarr pas shenjës së caktuar dhe u hodhën në sulm, kundërshtari u çorodit, por, megjithëse u kap në befasi, nuk u thye. Ai mundi të organizonte sakaq një kundërveprim të fortë, duke u mbështetur nga artileria. Ndërkaq, gryka e Baçesë, Rungaja dhe Qafa e Martës gjëmuar nga buçimat shurdhuese të topave, sokëllimat e mitralozave «shars» e pushkët kundërtanks. Armiku, duke parë se me gjithë mjetet e forcën e tij numerike shumë të madhe nuk mund të bënte përpara, filloi të bombardonte e të mitralonte pozitat partizane me anën e aviacionit. Mirëpo edhe kjo breshëri e pandalshme s'mundi t'i shkulte dot luftëtarët, të cilët qëndronin si shkaba majë shkëmbinjve. Pas dy orësh luftimi, fytyra e Tekiut, nën kapelën pa strehë, ishte skuqur më shumë se kurrë. Ai vërente, kapte çdo gjë e me mprehtësinë e vështrimit të syve të tij bojë hiri dukej se e kishte vënë veten në pozitën e kundërshtarit dhe parashikonte veprimet e tij. Vendimi që mori bashkë me shtabin e batalionit për të ndryshuar taktikën e veprimeve dhe për t'iu shmangur luftës në pozicione, ishte bërë një kërkesë e domosdoshme. Pra, në këto çaste vendimtare, kur gati në të gjithë sektorët largësia ishte shkurtuar vetëm në disa metra, të gjitha forcat e batalionit u ngritën në këmbë dhe u hodhën përpara duke thirrur: «Para,

partizanë!». Ky kundërsulm i fuqishëm i zbrapsi armiqtë, i shtyu edhe më thellë dhe i detyroi të hiqnin dorë nga synimi i tyre për të kaluar me çdo kusht në këtë sektor. Kur ata ndërruan drejtim, forcat partizane, megjithëse ishin të lodhura, të uritura e pa gjumë, u nisën për marshim e mbërritën në Trebickë në kohën që kolonat fashiste të ardhura nga Qafëzezi shkelnin Qesarakën dhe hynin në Kaltanj. Duke i pasur nën vëzhgim këto lëvizje, Tekiu e shokët e shtabit e çmuan rëndësinë e rrezikut dhe e morën me mend logjikën e kundërshtarit që synonte të zinte Qafën e Llopushës, të vazhdonte operationin në thellësi, duke lënë pas vetes forcat partizane në gjendje rrethimi, të cilat t'i shkatërronte më vonë. Para kësaj gjendjeje, ata arritën në përfundim që të mos ecnin paralel me të, por më shpejt. Dhe kështu vepruan. Kaluan lumin Osum, u ngjitën përpjetë pyllit të Koblarës dhe atje Tekiu foli në telefon me shokët e Shtabit të Përgjithshëm.

Komandanti i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, shoku Enver Hoxha dhe Shtabi i Përgjithshëm, me anën e kësaj ndërlidhjeje të vazhdueshme me fije teli të shpërndara në disa drejtime, ndiqnin me kujdes lëvizjet e qëllimet e armikut në këto rrethana tepër të vështira. Ata mbanin lidhje të ngushta me komandat partizane, u jepnin atyre urdhëra e udhëzime për t'i goditur pa ndërprerje armiqtë, për të manevruar me shkathësi, që t'iu shmangeshin grackave të tyre dhe t'i dëmtonin ata sa më rëndë.

Pas këtij bisedimi telefonik, batalioni «Tomorri» u largua për të zënë pozita të përshtatshme në Qafën e Llopushës, ndërsa Tekiu, pasi sistemoi në pyll popullin që ishte shpërngulur nga fshatrat e djegura e udhëtonte pa pasur ndonjë drejtim të caktuar, u

takua me shokët e shtabit të batalionit «Hakmarrja». Ata i raportuan se pas dy ditë luftimesh, kishin kaluar lumin Osum dhe në përfundim të tij kishin zënë pozita të reja për të mbyllur rrugët në thellësi të zonës së Dangëllisë.

— Shokët e Shtabit të Përgjithshëm, — u tha Tekiu, — urdhërojnë forcat partizane që të hidhen në prapavijat e armikut. Ju si thoni, a është i gatshëm batalioni për këtë veprim?

— Po, — iu përgjigj komandanti i batalionit. — Megjithëse jemi hapur në formacion luftimi, mendoj se pas dy orësh e bëjmë grupimin e forcave.

Teki u rrëmbeu menjëherë receptorin e telefonit, bisedoi përsëri dhe kërkesa e tij për t'u larguar bashkë me repartin u aprovua. I gëzuar e i gatshëm për të zbatuar urdhërin, u tha shokëve të batalionit t'i jepnin një kohë të shkurtër për t'u shpjeguar partizanëve detyrën. Të gjithë prisnin se çdo të thoshte komandanti i shtabit të qarkut, i cili me punën e luftës e tij kishte fituar autoritet dhe respekt midis luftëtarëve.

— Partia, — u tha Tekiu, — na ka vënë detyrë ta godasim armikun në shpinë e anash dhe t'ia bëjmë gjendjen të pasigurtë në çdo minutë. Për këtë, unë po ju pyes se cili është mendimi juaj?

Gjithë batalioni u përgjigj me një zë: «Jemi gati!».

Me Tekiun në krye, partizanët u nisën për marshim dhe, kur mbërritën në pyllin e dendur të Radovickës, qëndruan. Ishin shumë të lodhur. Prej tri ditësh s'kishin vënë bukë në gojë, përveç rrënjëve dhe fletëve. Gryka u qe tharë.

Heshtje. Lart ngriheshin raketa sinjali. Dy të gjelbëra, një e verdhë, pastaj dy të gjelbëra dhe.

duke u shpërndarë si shkëndija, fikeshin e zhduke-
shin në ajër. Errësirë dhe përsëri raketa me ato ngjy-
ra. Pa dyshim që gjermanët lajmëronin diçka.

Në pika të ndryshme dukeshin sinjale të ndrit-
shme si përgjegje. Luftëtarët filluan përsëri të lëviz-
nin, kaluan lumin Osum dhe me shumë mundime
mbërritën mbi Stratobërdhë, në stanet e çobenjve.
Atje, pasi pinë qumësht e hëngrën mish pa bukë e
pa kripë, ranë për të marrë një sy gjumë.

Të nesërmen dita ishte e ngrohtë dhe e kthje-
llët. Asgjë përreth nuk të kujtonte luftën. Qetësinë
e pyllit e prishte vetëm zhurma e zogjve që sapo
kishin filluar të zgjoheshin... Një orë pas lindjes së
diellit, partizanët morën vesh nga njerëzit e leme-
ritur që gjetën nëpër pyje se gjermanët ishin lar-
guar dhe kishin lënë mercenarët, të cilët silleshin
nëpër territoret e çliuara si hordhi të uritura, që nuk
ia gjenin dot fundin rakisë e mishit të pjekur. Ata
që kishin mbetur nëpër fshatra jetonin me shpirt në
dhëmbë sa të shpëtonin prej tyre. Duke kaluar nëpër
vendin e shkatërruar e të djegur, partizanët shikonin
drurët e prerë të kopshteve, gardhet e shembur dhe
ato shtëpi të pakta që kishin mbetur më këmbë.

— Duhet të ecim shpejt, më shpejt akoma, —
tha Tekiu. — T'i ndjekim këmba-këmbës, se çdo orë
e fituar është shpëtimi i fshatrave dhe i njerëzve....

Partizanët, të gatshëm për të luftuar deri në
fund, shpejtuan hapin por, si zakonisht, tradhtarët
e ndjenin të keqen dhe largoheshin me nxitim nga
fshatrat, malet e pyjet...

* * *

Tekiu u dëshpërua shumë kur mori vesh vdekjen e të vëllait, Lutfiut, i cili, ato ditë, larg në Lupckën e Përmetit, kishte dalë nga shtëpia-bazë e fshatit dhe kishte takuar në rrugë gjermanët. Ata e qëlluan, por zëri i tij edhe në çastin e fundit oshëtiu i fortë deri tutje: «Vdekje fashizmit!».

Të gjithë e kuptonin se sa vështirë e kishte Tekiu të dukej i qetë nga ana e jashtme. Kur arriti në fshatin e tij, në Kolanec, u hodhi një sy gërmadhavë të shtëpisë së djegur.

Fshatarët e përshëndetën me kokë pa bërë zë dhe askush nuk e pyeti për gjë, nuk e ngushëlloi.

— Do cigare? — i tha një plak dhe i zgjati kurtinë me duhan.

Tekiu drodhi një cigare dhe filloi ta pinte. Ai e kuptoi dhe e vlerësoi atë heshtje të çmueshme të bashkëfshatarëve të tij, që tregojnë në minutat e fatkeqësisë vetëm miqtë që të duan me të vërtetë, me gjithë shpirt.

* * *

Forcat partizane, duke përmbushur urdhrin e 14 qershorit të Komandantit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, shokut Enver Hoxha, kaluan menjëherë në kundërmësymje mbi bishën e tërbuar naziste që u tërhoq me shpejtësi të rrufeshme për të shmangur çdo sulm prapa krahëve. Ata me zjarr e flakë s'bënë gjë tjetër, veçse ngritën në

këmbë një popull të tërë, në zemrën e të cilit vlonte gjithnjë e më tepër urrejtja, zemërimi, poshtërimi, etja për hakmarrje dhe dëshira e zjarrtë që pushtuesi e tradhtari të jepnin llogari për dhunën e grabitjet që kishin bërë.

Dështimi i Operacionit të Qershorit e armatosi Ushtrinë Nacionalçlirimtare me një përvojë të madhe luftarake, me besim në fitore dhe me urrejtje më të madhe për armikun. Në këtë ofensivë u tregua edhe një herë forca e madhe e Partisë, e cila diti të organizonte një mbrojtje aktive e, si rrjedhim, jo vetëm ruajti nga shkatërimi Ushtrinë Nacionalçlirimtare, por njëkohësisht e dërrmoi kundërshtarin me goditje të befasishme në shpinë e në krahë dhe menjëherë u hodh në kundërofensivë, duke e mbyllur përsëri armikun në kazemat e fortifikuara prej betonarmeje nëpër qytete. Në këto luftime anëtarët e saj, komisarët e komandantët dijtën të mbanin lart moralin e shpirtin luftarak të partizanëve, të cilët përballuan lodhjen, urinë, etjen, gjumin dhe pa asnjë ankesë zbatuan të gjitha detyrat e treguan heroizma të pashoqe.

BRIGADA XV SULMUESE

Më 29 qershor në malësinë e Oparit vinin e vinin njerëz për të marrë pjesë në ceremoninë e inaugurimit të Brigadës XV Sulmuese. Në fytyrat e tyre pasqyrohej gëzimi për këtë ngjarje të shënuar historike dhe besimi i patundur në çlirimin e atdheut.

Në pyllin e Protopapës u bënë përgatitjet e duhura. Atje nuk mungonin mishrat e pjekura si dhe pak raki, mbasi grumbullimi i parë i një brigade ishte si një farë dasme. Por dasma ose nuk zgjat aq sa dëshirojnë dasmorët ose s'bëhet fare dhe kthehet në dasmë lufte e gjaku. Kur mishrat në hell posa kishin filluar të kuqërroheshin e të kundërmonin, partizanët u urdhëruan të vendoseshin mbi Qafat e Beçit dhe të Martës, sepse armiku po digjte fshatrat matanë vargut të Ostrovicës flokëthinjur. Do të ishte një fillim i mbarë sikur të shkreheshin ato pushkë, por mercenarët e mallëkuar u kthyen përsëri, kështu që inaugurimi i brigadës së re u bë një dasmë pa krisma.

Forcat partizane që mbërritën nga batalionet «Hakmarrja», «Fuat Babani», «Skënder Çaçi», «Tomorri», «Reshit Çollaku», u ndanë në katër pjesë, duke pasur çdo batalion si bërthamë luftëtarë me stazh të gjatë lufte si dhe kuadro që kishin përvojë drejtimi. Në radhët e tyre ishte edhe batalioni i

«Rinisë» si dhe partizanë e partizane nga organizatat e terrenit. Bashkë me ta, duke iu përgjigjur thirrjes së Partisë, shtuan radhët e kësaj brigade edhe shumë fshatarë që kishin parë me vite varfërinë, pangopësinë e zotërinjve e bajonetat e xhandarëve dhe në shpirtin e të cilëve vlonte urrejtja kundër tyre.

Në zonën ku do të vepronte brigada e re situata paraqitej mjaft e vështirë. Me largimin e Brigadës IV Sulmuese, e cila ishte inkuadruar në Divizionin I Sulmues dhe marshonte për në Shqipërinë e Mesme, forca të mëdha xhandaro-balliste kishin hyrë në krahinën e Mokrës, duke dalë nga fshatrat Shënepremtë, Strelcë, Dolanec e Velçan i Gorës, ndërsa bashibozukët e Dule Alarupit ishin vendosur në Vërgun, Prenisht e Çereshnik. Në fshatrat e Rrëzës si në Voskop, Vinçan, Gjonomadh e gjetkë, patrullonin dendur trupat gjermano-xhandare të ardhura nga Korça.

Në këto kushte, shtabi i brigadës, me në krye komandantin e saj Teki Kolaneci, mori vendim që, pa humbur asnjë minutë, të shfrytëzonte natën dhe në befasi të godiste fashistët e tradhtarët.

Batalionet e brigadës së sapoformuar filluan lëvizjen në drejtime të caktuara dhe humbën përtej grykave. Në Gorë e në Mokër, në Rrëzë e në postbolloqet e Korçës, u dëgjua pushka e tyre që ra si rrufe dhe mbolli panik e tmerr në radhët e armikut, i cili u struk përsëri në qytet. Këto luftime plot sukses zgjidhën një sërë detyrash shumë të rëndësishme luftarake dhe politike, të cilat ndikuan për të ndërmarrë sulme edhe më të vendosura kundër pushtuesve e tradhtarëve.

I pari luftim në shkallë të gjerë i brigadës ishte goditja mbi Pogradec. Në orën 2,30 të mëngjesit të

21 korrikut luftëtarët sulmuan objektivat: Piloçë-Pogradec, Çervenakë e Qafë-Thanë. Pushtuesit e xhandaro-ballistët, megjithëse të armatosur mirë dhe të mbrojtur në llogore e fortifikata, nuk mundën të rezistonin. Pozitat e tyre me rëndësi, Kalaja e rajoni i gështenjave, u pushtuan nga partizanët e Brigadës XV Sulmuese dhe të batalionit «Reshit Çollaku», të cilët pas një luftimi prej disa orësh, u tërhoqën për mungesë municioni. Në këtë aksion armiku pati përveç të plagosurve edhe 38 të vrarë. Partizanët patën 4 të vrarë dhe 9 të plagosur lehtë.

Pas kësaj lufte, më 25 korrik brigada u grumbullua në Qafën e Panjës për të plotësuar inaugurimin e saj. Buçiste kënga e vallja. Kënga ishte kurdoherë shoqja e tyre e pandarë. Me këngë luftonin, me këngë prisnin lajmet e mira nga brigadat partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, nga Fronti i Lindjes dhe me këngë përcillnin shokun që ikte nga gjiri i tyre. Ç'forcë të çuditshme kishte kënga në zemrat e trimave!

Atje, në Qafën e Panjës, ngado binte në sy entuziazmi i luftëtarëve dhe lidhja e ngushtë e komandantëve me ta. Shokët e shtabit ishin futur në mes të tyre. Tekiu kalonte nga një batalion tek tjetri, bisedonte me të gjithë duke u kërkuar atyre t'i tregonin diçka nga lufta, ngjarje që u kishin lënë mbresë më shumë. Kjo atmosferë e shëndoshë ishte një nga burimet e fitores mbi armiqtë.

Pas ndonjë ore u dha urdhri për rreshtimin e brigadës. Pasi u mbajt një minutë heshtje për nder të shokëve të rënë në luftë, filloi riorganizimi i batalioneve. Midis të tjerave u vu re se shërbimi sanitar mungonte krejtësisht. Nuk kishte asnjë infermier, asnjë ilaç. Në një gjendje të tillë, nga dhimbjet e

plagëve, shumë shokë do të luftonin me vdekjen, sepse sektori ku do të vepronte brigada ishte mjaft i gjerë dhe vonesa e ndihmës së parë do të sillte keqsimin e plagës, zgjatjen e kohës së shërbimit e, në mjaft raste, edhe vdekjen. Për këtë, kompanitë u urdhëruan të dërgonin një partizan ose partizane në kursin njëmuji në infermierinë e Strelcës ku ishte një doktor italian. Pastaj edhe të tjerë për një kurs të dytë, në mënyrë që çdo kompani të kishte nga dy sanitarë.

Mandej komisari i brigadës bëri sqarimin mbi gjendjen politike të brendshme e të jashtme dhe vuri detyrë për të zhvilluar një punë propagandistike edhe më të dendur me popullin, sepse në Mokër brigada kishte gjetur një gjendje mjaft të nderë, të shkakuar nga veprimtaria minuese e «Ballit Kombëtar». Pastaj fjalën e mori Tekiu, i cili vuri në dukje se partizanët në luftën e Pogradecit ishin dalluar për disiplinë, qëndrim heroik dhe për moral të lartë.

— Përvoja e fituar, — tha ai, — duhet të shërbejë për të kryer veprime luftarake në përmasa më të mëdha e më të frytshme, sepse zona e re që na është caktuar paraqet një rëndësi të posaçme strategjike. Brigada ka për detyrë të forcojë më tej luftën kundër pushtuesve, të çorganizojë vijat e komunikacionit të tij, të shkatërrojë bandat e armatosura balliste, të spastrojë zonat e çliruara nga reaksionarët dhe, ashtu siç tha komisari, të ndihmojë popullin që të forcojë luftën e armatosur e pushtetin popullor.

Pas komandantit të brigadës folën edhe shumë të tjerë, të cilët vunë në pah trimërinë e zotësinë e luftëtarëve e të komandave, po nuk lanë pa kritikuar të metat. Në fund ceremonia u mbyll me parakalimin e brigadës.

Fill pas riorganizimit, dy batalione morën drej-

timin e Qafë-Thanës, kurse dy të tjerët shkuan për nga fshatrat e fushës së Korçës.

Në ditët e para të muajit gusht, forcat e brigadës goditën në befasi trupat gjermano-xhandare në Katiel-Rashtanj-Korkovec, Prrenjas dhe Qukës. Në këto luftime armiqtë patën 40 të vrarë dhe shumë të plagosur. Ndërkohë ato ndërmorën edhe disa sulme kundër ballistëve të Dule Alarupit, hynë në Podgorie në çerdhen e grumbullimit të tyre dhe vendosën në këtë zonë pushtetin e këshillave nacionalçlirimtare. Në këto krahina, ku reaksioni zhvillonte prej kohësh një propagandë të tërbuar antikomuniste, populli në përgjithësi i priti mirë luftëtarët dhe ndau me ta bukën e strehën, sepse ai kishte parë me svtë e vet partizanë të tjerë, të cilët nuk vrisnin e nuk prisnin, nuk shnderonin e nuk plaçkitnin ashtu si u kishin thënë tradhtarët.

Brigada edhe luftonte edhe punonte për sqarimin politik të popullit, për forcimin e këshillave nacionalçlirimtare, për ngritjen e këshillave të reja, për zhdukjen e grindjeve dhe të hasmërive midis fshatarëve. Por krahas agjitacionit e propagandës, ajo çdo ditë zhvillonte diskutime politike dhe ushtrimet taktike me partizanët. Mësimet në grupe për njohjen e mitralozit të lehtë e të rëndë si dhe të mortajave luftëtarët i ndiqnin me plot dëshirë. Së bashku me popullin, partizanët në kohën e lirë merreshin me punë bujqësore.

Një ditë Tekiu iu afrua vendit ku rrinin disa partizanë.

I pritur me dashuri, ai u ul dhe i vështroi të gjithë ata që ishin rreth ziarrit.

— Mos u shqetësoni për mua, — tha ai. — Vazhdoni leximin.

Me sy të mbërthyer mbi shokun e tyre dhe me gojë hapur partizanët dëgjonin vendimet e Kongresit I të Bashkimit të Rinisë Antifashiste, që ishte zhvilluar në Helmës të Skraparit prej 8 deri më 17 gusht. Kur leximi mbaroi. Tekiu u dha lajmin për formimin e Korparmatës I të Ushtrisë Nacionalclirimtare, në të cilën përfshiheshin Divizioni I dhe Divizioni II Sulmues, që ishte krijuar më 4 gusht.

Midis të tjerave ai tha:

— Formimi i Korparmatës I përbën një hap tjetër të madh drejt shndërrimit të plotë të Ushtrisë Nacionalclirimtare në një ushtri të rregullt që ditë-ditës plotëson detyrat e saja, të cilat lehtësohen shumë nga fitoret që po korr njerën pas tjetrës Ushtria e Kuqe kundër hordhive hitleriane në Lindje.

Të nesërmen, këto lajme u pritën me brohoritje nga partizanët, fytyrat e të cilëve shkëlqenin nga gëzimi dhe krenaria. Në këtë atmosferë entuziazmi, shtabi i brigadës i përqëndroi forcat kryesore mbi nyjet e rrugës Qafë-Thanë-Qukës, për të goditur kolonat gjermane dhe për të asgjësuar qendrat e fortifikuara që ruanin këtë rrugë.

Tekiu që bënte jetën e batalioneve, interesohej për shtabet e tyre dhe i ndihmonte ato konkretisht që ta kryenin detyrën që u ishte ngarkuar.

— Për të futur në pritë gjithë kolonën, të urdhërohen partizanët të mos hapin zjarr pa u goditur makina e parë në vendin e caktuar, — u thoshte ai kuadrove. — Në qoftë se gjermanët do të mundin të shpojnë në një vend, ata do të ndalen në një pikë tjetër... Dhe kështu, nga një pengesë në tjetrën, mund të ngecin edhe më shumë në baltë, duke hu-

mbur njerëz dhe materiale, duke derdhur rrëke gjaku. Në orën 10 të natës së 24 gushtit, nga rruga e Strugës u dukën së largu disa drita makine, pastaj dhe të tjera.

Partizanët e batalionit të 4-t, që ishin në pritë, e lanë autokolonën të kalonte dhe, kur kreu i saj arriti në afërsi të Qukësit, u dëgjua një plasje shurdhuese. Kamioni i parë u hodh në erë, të tjerët u ndalën. Breshëri zjarri u derdhën mbi armikun, i cili u godit befasisht, për vdekje. Pas një përpjekjeje të ashpër që vazhdoi disa orë, arriti një autokolonë tjetër që shkante nga Elbasani për në Strugë. Ajo qëndroi në vend dhe nuk hyri në pritë, se kishte parë flakët e kuqe të zjarrit që pasqyroheshin në horizont. Gjermanët që ndodheshin në makinat zbritën dhe zunë pozicione nëpër shkëmbinjtë buzë xhadesë. Lufta u ndez aq e ashpër, sa që armiqtë, të futur në hendeqe e prapa gurëve, shtinin vetëm për t'u mbrojtur. Kur e panë punën keq, ata u lëshuan duke ulëritur drejt kamionave. Luftëtarët vazhduan ndjekjen dhe, kur u kthyen, mbledhën shumë armë e materiale, në mes të tyre edhe postën ushtarake me mjaft dokumente. Në këto dy përpjekje mbetën të vrarë 30 nazistë dhe 22 makina të djegura. Nga ana e batalionit s'pati humbje.

Deri në fund të muajit gusht nuk kaloi asnjë ditë pa luftë në sektorin e Bërzeshtës, në fortifikatat e Prrenjasit dhe të Urakës. Në këto vende, armiku la 47 të vrarë të tjerë dhe 6 makina të djegura. Si rrjedhim i këtyre goditjeve, forcat gjermano-balliste u larguan nga Pogradeci natën në panik.

Më 30 gusht, shtabi i brigadës dhe disa partizanë

hynë në Pogradecin e lirë pa pushtues e tradhtarë. Çdonjerit i dukej sikur shikonte për herë të parë një qytet. Çudi! Një botë tjetër. Kinema, hotel, kafe-ne, shtëpi të mëdha, rrugë të shtruara, dyqane me tesha e këpucë të varura në vitrina, cigare, karamele, sapun për t'u larë, bereqet e kripë që shiten si edhe shumë e shumë sende të tjera.

Luftëtarët, që e vërenin qytetin nga larg, i vazhduan luftimet. Brenda njëzet ditëve të muajit shtator ata spastruan fshatrat nga mbeturinat e «Ballit Kombëtar» gjatë rrugës automobilistike prej Linit deri në Zvezdë. Ata goditën kolonat naziste, sulmuan vendqëndrimet e tyre në Prrenjas, Qukës, në grykën e Cangonjit dhe shpartalluan forcat balliste-xhandare të përbëra prej 700-800 vetësh, të cilat, në pjesën më të madhe të tyre, u kthyen në shtëpitë e veta, ndërsa të tjerët u hodhën në radhët partizane. Dule Alarupi mbeti me pak shokë. Këtë kapadai nuk e ndoqi dhe nuk e dëgjoi njeri. Tani ai jetonte i fshehur si bishë, i shkëputur nga kopeja, por prapëseprapë i gatshëm për të kafshuar.

Nga rrethi i Pogradecit dhe sektori i Podgories vazhdimisht vinin njerëz të gënjyer nga reaksioni që nuk kishin përgjegjësira, të cilët kërkonin me dëshirë të futeshin në rreshtat e brigadës. Në një situatë të tillë, seksioni politik dhe komunistët, që ishin truri e zemra e brigadës, luftonin me vendosmëri e pa pushim për të zbatuar plotësisht vijën e Partisë, udhëzimin e Shtabit të Përgjithshëm të datës 1 qershor 1944 «Mbi qëndrimin ndaj tradhtarëve e robërve». Partizanët i prisnin miqësisht të pafajshmit, nuk tallëshin me ta, u jepnin të kuptonin se i pranonin si shokë, se nuk kishin asnjë urrejtje, kurse për orga-

nizatorët, spiunët dhe ata që kishin masakruar, djegur e vrarë popullin, u treguan të pamëshirshëm.

Vjeshhtë. Kishte dy ditë e dy net që binte shi pareshtur. Horizonti dhe liqeni dukeshin të zymtë, të errët. Valët përplaseshin me zhurmë në breg dhe sillnin një thëllim të ftohtë. Rrugët ishin mbytur në ujë. Një errësi e dendur kishte mbuluar qytetin e vogël dhe të bukur.

Ato ditë Brigada XV Sulmuese ishte ngarkuar nga Shtabi i Përgjithshëm të vepronte në qarkun e Elbasanit për të mbuluar shpinën e Divizionit I Sulmues dhe për t'u angazhuar në goditjen e rrugëve e të qytetit. Në çdo batalion mbaheshin konferenca. Pregatitjet për udhëtim u kryen në një kohë fare të shkurtër. Më 20 shtator dy batalione u nisën nga ana e Velçanit të Mokrës për në Polis dhe dy të tjerët nga Bërzeshta me drejtim në Xhyrë. Lëvizja e tyre u bë me intervale dhe sipas planit që hartoi komanda e brigadës. Marshimi kishte për qëllim jo vetëm të kontrollohej rruga Qafë-Thanë-Qukës deri në mbërritjen e forcave të Brigadës XX Sulmuese, por edhe futjen në pritë të kolonave armike që mund të kalonin në pjesën e rrugës Qukës-Librashd.

Afër mbrëmjes, kur batalioni i 4-t mbërriti në malin e Breshkës, një aeroplan fluturoi mbi pyll dhe hodhi trakte. Partizanët, që s'kishin asnjë fletë cigare, u lëshuan dhe rrëmbyen ato fletushka... Dikush, duke dredhur me kënaqësi një cigare të trashë, tha me të qeshur:

— Ndoshta është e para herë që Hitleri bën një të mirë. Dhe kujt, se? Partizanëve që do t'ia hanë kokën.

Natën e 24 shtatorit, një autokolonë e gjatë që kalonte nga Elbasani për në Strugë, u godit nën

Spatharë nga tri skuadra të batalionit të 2-të. Nazistët, megjithëse patën një ushtar të vrarë, 4 italianë robër dhe 6 makina të djegura me materiale, nuk u bënë fare të gjallë, por në errësirën e natës vazhduan rrugën drejt pritës së batalionit të 3-të, i cili kishte më se 40 orë që rrinte në afërsi të Xhyrës.

Në orën 11 të natës u dukën dritat e fenerëve, të cilat shponin qiellin e errët, rrëshqisnin poshtë e lart, ndriçonin pyjet, kodrinat dhe shkurtoheshin në kthesat e rrugës. Më në fund autokolona u afrua, u fut në darën e pritës dhe luftëtarët, të vendosur në të dyja anët e xhadesë e pranë kthesave të forta ku ngriheshin shkëmbinj të thepisur, qëndronin pranë tyre duke mbajtur frymën pezull, gishtin në këmbëzë e sytë të mbërthyer te makinat që u kalonin përpara. Kur ata mbërritën në vendin e caktuar, u dëgjua krisma e parë. Lufta u ndez. Partizanët hapën zjarr të përqëndruar dhe plumbat vërshëllyen me zë të ashpër e të mprehtë. Me breshëri të shkurtëra e të shpejta, mitralozat nuk u linin rast gjermanëve të përgjigjeshin. Zjarri sa vinte e bëhej më i dendur. Batalioni u hodh si një trup i vetëm në një sulm të rrufeshëm. Plasja e granatave u dëgjua në të majtë e në të djathtë. Kjo përleshje trup me trup i hutoi nazistët, të cilët kaluan me vrap në mbrójtjen më të afërt. Ata pak që mbetën, duke përfitur nga errësira, mundën të tërhiqeshin të dërrmuar.

Atje çdo gjë digjej dhe mbulohej me tym e flakë. Në mes të një zhurme të tmerrshme, u tund vendi nga gjëmimi dhe toka u drodh nga pëlcitja e predhave të ngarkuara në kamiona. Nga gryka e lumit doli një oshëtimë dhe u ndie era e gjërave të shkrumbosura. Luftëtarët u urdhëruan të largoheshin, të ecnin përpjetë malit, sepse gjithçka kishte marrë

fund. Nga të 75 makinat që kishte autokolona, as edhe një s'kaloi përtej pritës. Armiku la 30 të vrarë, 2 robër, material luftarak dhe shumë veshmbathje.

Në agimin e 25 shtatorit, u duk të vinte nga Struga një tjetër autokolonë gjermane. Komanda e batalionit vendosi t'i jepte edhe kësaj një goditje. Mbi të u hap zjarr nga pozicionet dhe pas një lufte të rreptë armiqtë u detyruan të ktheheshin prapa, duke lënë në vend dy autoblanda të shkatërruara dhe dy makina të nxjerra jashtë përdorimit.

Në të dy këto luftime, partizanët patën një të vrarë dhe tre të plagosur lehtë. Rruga Elbasan-Strugë mbeti për 5 ditë e prerë, pa lëvizje.

Pas këtyre aksioneve, shtabi i brigadës grumbulloi batalionet në Polis të Madh, në Polis të Vogël e në Fushë Buall. Mori masa të rrepta maskimi për të ruajtur me çdo kusht fshehtësinë dhe bashkë me Brigadën VII Sulmuese organizoi radhën e kalimit në lumin Shkumbin.

Urdhëri u dha. Së shpejti do të fillonte marshimi. Të gjithë nxitonin të mbaronin punët. Tekiu kontrollonte batalionet dhe jepte një varg porosish për kryerjen me sukses të marshimit drejt ujërave të ftohta të Shkumbinit. Pas valëve të tija të shkumëzuara ruanin nazistët gjermanë, të cilët, megjithëse kishin në dorë urën e Xibrakës e shkallën e Mirakës, nuk duhej të shihnin asgjë e të dinin se atë natë dhe të nesërmen në mbrëmje pranë tyre do të kalonin forcat partizane.

Në mesnatën e errët me shi e tufan, batalionet filluan të lëviznin drejt pikëkalimeve të caktuara, duke qenë të siguruar nga një pararojë, nga një praparojë dhe nga anëroje. Në rrapat, në vendin e urës së Haxhi Beqarit, kaloi tutje pa u diktuar pararoja,

kurse shumica, që kishte hyrë në ujin brisk, dëgjoï komandime të shkurtëra e të prera. Siç dukej, vargu qe këputur, sepse bashkë me të, ishin edhe më shumë se 200 kafshë, të cilat, kur iu afruan buzës së lumit që shfrynte i egërsuar, nuk deshën të futeshin në ujë, ktheheshin prapsht, mblidheshin tok e hidhnin shqelma të frikësuar. Partizanët me kapistra ndër duar, i tërhiqnin nga pas dhe ato hynin me pahir duke turfulluar e duke i marrë erë ujit.

Pasi grupet e para kaluan matanë, ato u ngjitën mbi kodrat dhe zunë pozicione përballë xhadesë derisa të gjithë kapërcyen rrugën e asfaltuar e morën drejt të përjetës.

Më 30 shtator e gjithë brigada u ndodh e grumbulluar në Labinotin e Sipërm. Atje, komandanti i Divizionit I Sulmues mori kontakt me shokët e shtabit të brigadës, të cilët, pasi i raportuan gjendjen, morën detyra të reja. Të nesërmen, ai inspektoi forcat e Brigadës XV Sulmuese, të cilat përkohësisht do të varehin nga ai divizion.

Në Labinot brigada nuk u çlodh. Ajo, para se të zinte pozicionet që kishte Brigada IV Sulmuese, e cila do të largohej nga qarku i Elbasanit, dëgjoï fjalën e komandantit të saj:

— Shokë! Detyra e parë e kryesore që na është ngarkuar është prerja e vijave të komunikacionit. Veç kësaj, do të veprojmë edhe kundër përqëndrimeve të forcave gjermano-balliste në qytet e përqark. Për këtë, ritmi i sulmit tonë nuk duhet të ngadalësohet për asnjë çast. Ja ç'detyra na ka vënë përpara Partia. Tani çdo gjë varet nga zotësia jonë, sidomos në këtë kohë kur nazizmi po i numëron ditët dhe është në përpëlitjet e fundit...

Pas këtij fjalimi, ai dha urdhër për nisje dhe

batalionet u larguan për të zënë pozicionet nga Qafa e Kërrabës deri në Librazhd. Komandat e tyre u porositën që terrenin ku do të vepronin ta studjonin imtësisht dhe ai të njihej nga të gjithë luftëtarët.

Partizanët rrinin në prita dhe nuk u durohej sa t'u vinte gjahu në shteg. Kompanitë ndërroheshin çdo gjashtë orë dhe, duke zëvendësuar njëra-tjetrën, ktheheshin në fshat të ngrira e të lagura, sepse kishte ditë që shiu s'donte të pushonte. Mirëpo ky mundim nuk shkoi kot. Më 4 tetor, afër mesit të ditës, kompania e 2-të e batalionit të 4-t, që ishte vendosur te Shkëmbi i Prapanikut, priti një autokolonë armike. Pas gjysmë ore luftë, një pjesë e saj mundi të kthehej në Elbasan, ndërsa pjesa tjetër u shkatërrua. Në ndihmë të partizanëve erdhi kompania e 4-t dhe të dyja së bashku u hodhën në xhade e kapën të gjallë disa nazistë. Gjermanët e tjerë u fshehën nën urë. Këtyre iu bë thirrje të dorëzoheshin. Ata në fillim nuk pranuan dhe u përgjigjën me zjarr. Kishin shpresë, duket, t'u vinin në ndihmë forca të tjera, mirëpo plumbat e pushkëve e bombat e dorës nuk pushuan. Ata, të mbledhur si krimba toke, i hodhën armët në lumë dhe u dorëzuan.

Si rrjedhim i kësaj ndeshjeje, u zunë 18 robër, pëti 45 të vrarë, u kapën 2 mitralozë të rëndë «brëda», 3 mortaja të lehta gjermane me 140 predha, automatikë, pushkë, revole, bomba dore, municion, 150 kostume e ndërresa, këpucë, çizme si dhe ushqime. Materialit tjetër, që s'kishte mundësi të ngrihej, iu vu zjarri së bashku me dy makina. Pasdite erdhën në ndihmë dy autoblanda, njëra prej të cilave, pasi u godit nga zjarri i antitanksit, mori zjarr, ndërsa tjetra, e dëmtuar rëndë, u kthye për në Elbasan.

Po atë mbrëmje kompania e 2-të e batalionit të

2-të sulmoi brenda në Elbasan komandën naziste, burgun, përqëndrimet armike në Shkollën Normale, në spitalin pranë Shën-Thanasit dhe në Milet-bahçe. Nga armiku nuk u ndie asnjë kundërveprim. Siç dukej, ai ishte çoroditur krejt.

Atë ditë, nazistët u goditën edhe në Librazhd nga batalioni i 3-të, i cili kishte dërguar një pjesë të forcave të tija për të vazhduar veprimet e spastrimit në fshatrat e Çermenikës, ku kishin çerdhen ballistët e kriminelët Azis Biçaku e Isak Alla. Aty qenë futur disa banda të tyre, të cilat, me të marrë vesh se po afroreshin partizanët, ikën me vrap nga fshatrat Dorëz e Letmi. Në Zgosht u bë çarmatimi dhe mobilizimi i disa fshatarëve të mashtruar, por një pjesë e burrave qëndronte ende në pyjet e dendura me dushqe e shkurre.

Në një letër që u dërgonte Tekiu shtabeve të batalioneve, shkruante:

«Të hidheni në goditje të rrepta e të vazhdueshme në afërsi të komunikacionit armik dhe shtëpitë e para të qytetit të jenë pozicione partizane»¹.

S'kishte natë që pushtuesi të mos e llamburiste qytetin me raketa e të mos qëllonte me mitraloz e mortaja vendin përqark, sepse partizanët, me njësirë të vogla, e mbanin të mbërthyer në fortifikatat e llogoret e rrethuara me tel e mina dhe përherë në alarm. Në lagjet e periferisë, populli i ftonte për darkë bijtë e tij. Pas goditjeve të objektivave të caktuara, ata me këngë në gojë ktheheshin në pozitat e tyre.

Më 7 tetor doli nga Elbasani një bateri artilerie

1. — Dokument në arkivën e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore.

me tre topa dhe u drejtua nga Qafa e Kërrabës për t'u vendosur në pozicionet që kishte përgatitur që më parë. Në afërsi të Petreshës, ajo u godit nga kompania e 2-të e batalionit të 1-rë, e cila vrau 18 gjermanë dhe zuri 11 robër, 3 mitralozë, 17 pushkë, 200 predha të kalibrit 86/24, municione e materiale të ndryshme si edhe 5 mushka. Topat nuk u tërhoqën dot, sepse arriti një autokolonë e shoqëruar me autoblanda, kështu që partizanët u morën atyre vetëm shënjestrat, goniometrat, dylbitë dhe u larguan pa asnjë humbje.

Ditët që pasuan ishin ditë humbjeje të mëdha për nazizmin gjerman jo vetëm në qytet dhe në pikat e përqëndrimit të tij si në Librazhd, Mirakë, Labinotin e Poshtëm, por edhe në rrugët Librazhd-Elbasan-Peqin, ku vazhdimisht goditeshin autokolonat e shoqëruara me tanke e autoblanda. Për të dalë nga kjo hallkë që sa vinte ngushtohej, komanda gjermane filloi të merrte masa përforcimi në disa pika të ndryshme të qytetit dhe rrëzë xhadesë, për të mbrojtur kolonat e tij në rrugën Elbasan-Tiranë.

Më 19 tetor dolën nga qyteti pesë makina me ushtarë të armatosur mirë dhe u drejtuan për në Qafën e Kërrabës për të fortifikuar ndonjë pikë mbrojtjeje. Njësitet e batalionit të 2-të, që ishin në pritë, i lanë të afroreshin dhe në befasi flakën mbi kryet e tyre bombat e para të dorës. Gjendja u bë lëmsh. Filluan përpjekjet trup me trup derisa nazistët lanë 18 të vrarë, 17 robër, 5 makina të djegur, 34 pushkë, 5 mitraloza, 2 arka me municione dhe shumë material luftarak. Pjesa tjetër bashkë me të plagosurit mori arratinë nëpër pyll. Kjo luftë u dëgjua në Elbasan. Një forcë tjetër gjermane u mundua t'u vinte në ndihmë atyre të Kërrabës, por nuk mundi. Bata-

lioni i 1-rë e goditi me një breshëri plumbash duke rrëzuar përdhe 12 të vrarë dhe duke i detyruar të tjerët të ktheheshin përsëri në qytet.

Të nesërmen armiku nisi përsëri për në Qafë të Kërrabës një fuqi tjetër të shoqëruar me një auto-blindë, por u sulmua nga forcat e batalionit të 2-të.

Ndërsa në Berat zhvillonte punimet Plenumi II i Komitetit Qendror të Partisë dhe forcat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare ndodheshin në ofensivën vendimtare për çlirimin e plotë të Shqipërisë, shtabi i Brigadës XV Sulmuese përgatiste planin për sulmin përfundimtar mbi qytetin e Elbasanit.

Tekiut, që mbante lidhje të ngushta me batalionet, me komitetin qarkor të Elbasanit, ishte në dijeni të gjendjes, studjonte objektivat e armikut, propozonte planet e veprimit dhe i bisedonte bashkë me shokët e shtabit. Për të zbatuar më mirë detyrat e planin ushtarak, ai shkonte vetë nga një batalion tek tjetri. Shtabet e batalioneve i raportonin me hollësi Tekiut gjithçka që u kishte ngjarë, dhe ai i dëgjonte me vëmendje, i udhëzonte si të vepronin, të mos harronin se çdo manevër duhej të ishte e thjeshtë e konspirative, të zbatohesh me shpejtësi e në mënyrë të befasishme për armikun.

Ora për çlirimin e Elbasanit po afrohej. Push-tuesi e shërbëtorët e tij po kalonin ditët e fundit. Tradhtarët po ngrinin bagazhet dhe po iknin pa e ditur as vetë se ku po shkonin. Për ta nuk kishte asnjë shpresë shpëtimi. Disa, ndonëse vonë, po paraqiteshin në brigadë. Shumica prej tyre xhandarë e pak reaksionarë.

Dita ishte më të thyer. Shtabi i brigadës dhe shtabet e batalioneve filluan mbledhjen.

— Sot u takuam të gjithë, — u tha Tekiut. —

Siç e dini, këto ditë në Elbasan janë grumbulluar fuqi të mëdha gjermane, të cilat vazhdimisht tërhiqen për në Tiranë e Durrës. Komanda fashiste e ktheu qytetin në një qendër të fortifikuar, për të pasur të lirë komunikacionin, se Korça, Gjirokastra, e gjithë Shqipëria e Jugut, janë krejtësisht të çliruara dhe ajo nuk ka trupa të tjera, përveç gjatë rrugës Qafë-Thanë e këtej. Në këtë fazë të vështirë, forcat e brigadës kanë për detyrë t'u presin rrugën armiqve që të mos hyjnë në krveqytet. Ato duhet të bëjnë presione të vazhdueshme deri në pritje të urdhrimit për sulmin vendimtar në Elbasan, mbasi Shtabi i Përgjithshëm e vlerëson shumë çlirimin e tij. Për të gjitha këto, shtabet e batalioneve e komandat e kompanive duhet të jenë në krye të forcave për të drejtuar me guxim veprimet e reparteve të tyre dhe të jenë shembull heroizmi...

Pas tij folën shumë shokë të tjerë. Në fund u çua komisar, i cili tha:

— Epërsia numerike e armikut dhe superioriteti i zjarrit i humbasin vlerat e tyre para entuziazmit të madh në fitoren dhe në të ardhshmen që ka e gjithë brigada. Prandaj ne kemi rezerva shumë më të mëdha nga të kundërshtarit dhe kjo është më e rëndësishmja.

Nga mesi i natës, Tekiu u ngrit dhe tha:

— E po, mirë, shokë, është koha për t'u shpërndarë. Në mëngjes na pret lufta...

Shokët u çuan dhe Tekiu u shtrëngoi dorën të gjithëve me radhë...

Pregatitjet për çlirimin e qytetit bëheshin me shpejtësi. Askush nuk flinte. Netët afroheshin po aq të paqeta, sic kishin qenë të paqeta edhe ditët. Në pozicione luftëtarët, kur gjenin ndonjëherë pak

duhan ose ndonjë cigare, uleshin në gjunjë dhe e hiqnin nga një herë të gjithë me radhë. Dukej sikur dëshira e ethshme për të luftuar i kishte pushtuar të gjithë, që nga partizanët deri te komandanti i brigadës.

Në mëngjesin e 8 nëntorit filloi mësvmja për çlirimin e Elbasanit. Objektivi i forcave të batalionit të 1-rë dhe të 3-të ishte Ura e Zaranikës, lagjia e kishës dhe kazermat e Krastës. Batalioni i 4-t do të ruante krahët e forcave krvesore, duke sulmuar njëkohësisht trupat armike në Xibrakë dhe në Labinot. kurse batalionit të 2-të iu ngarkua detyra të priste rrugën automobilistike Elbasan-Tiranë.

Pas dy ditësh luftime të përgjakshme, batalioni i 4-t shkatërroi forcat fashiste të vendosura në Xibrakë e Labinot dhe shpëtoi nga shkatërrimi urat e kazermat që ishin të minuara. Në të njëjtën kohë, partizanët e batalionit të 1-rë dhe të 3-të, pasi thyen qëndresën e armikut në rajonin e Ullishtave, iu afruan qytetit dhe zhvilluan luftime në rrugët e tija. Të tierët, që kishin zbritur deri tek Ura e Zaranikës, bënë që Elbasani të rrethohej plotësisht.

Sulmet vazhdonin. Përpara partizanëve shembej cdo vijë qëndrese sado e fortifikuar që të ishte. Secili dëshironte të hidhej në sulm e të hapte ziarr mbi gjermanët. Fashistët, duke mos i bërë dot ballë sulmit të tyre, u detyruan të linin pjesën më të madhe të qytetit dhe të strukeshin në ndërtesat e Shkollës Normale e të lagjes Shënkoll. Ndërsa po merrnin masa për tërheqjen e të vrarëve e të plagosurve të shumtë, kompania e 3-të e batalionit të 3-të, që ishte futur thellë, i goditi rreptë ata dhe u shkaktoi 30 të vrarë.

Në palacinat nazistët bënë një qëndresë të fortë

e të vendosur për gjithë natën e gjithë ditën, por nuk i mbajtën dot. Shumë prej tyre u vranë, ndërsa të tjerët u detyruan të dilnin më parë se të kuptonin se ç'po ndodhte.

Më 11 nëntor filloi sulmi vendimtar për çlirimin e gjithë qytetit. Gjermanët shtinin pa rregull sulmonin me nxitim dhe me qëndrimin e tyre sikur e kishin bërë me fjalë të vërtetonin parandjenjen e Tekiut se atë ditë ata do të tërhiqeshin. Pas një sulmi të shpejtë, partizanët shpartalluan edhe qëndresën e fundit, shpëtuan qytetarët nga masakrimi dhe qytetin nga shkatërrimi i pjesës kryesore të tij. Duke marrë shumë plagë, fashistët u tërhoqën me shpejtësi në drejtim të Tiranës dhe të Durrësit. Por partizanët nuk mund t'i linin të lirë kriminelët që kishin djegur e shkretuar vendin tonë. Ata duhej të jepnin llogari para popullit për krimet që kishin bërë. Gjatë rrugës, luftëtarët që ishin vendosur në prita, u shkaktuan dëme të mëdha, dhe në rajonin Mushqetës kolona u shpartallua krejtësisht nga forcat partizane të brigadave të tjera.

Fitore! Atë ditë Elbasani ishte në hare, buçiste, këndonte, festonte fitoren. Urimet dhe gëzimi s'kishin fund. Njerëzit gëlltisnin lotët, përqaфонin partizanët e brigadës dhe nga zemra përshëndesnin Partinë. frymëzuesen e organizuesen e të gjitha fitoreve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Brigada XV Sulmuese shënoi në aktivin e vet. gjatë katër muaj e gjysmë nga dita e krijimit të saj, një varg përpjekjesh të ashpra, duke i shkaktuar armikut dëme të mëdha në njerëz e në materiale. Pa përmendur humbjet që pësuan tradhtarët e vendit. gjermanët lanë mbi 520 të vranë, 80 robër, 132 makina të djegura, 4 autoblinda e tanke të shkatërruara,

përveç të vrrarëve e të plagosurve brenda fortinave e gjatë rrugës që ata i mblidhnin dhe i merrnin me vete. Kjo brigadë i fali atdheut dhe lirisë 50 partizanë e kuadro nga luftëtarët e saj më të mirë, midis të cilëve dhe dy shoqe: Thomaidha Laçka e Shaniko Starja. Gjaku i dëshmorëve dhe i 73 të plagosurve të kësaj brigade skuqën viset e shenjta të atdheut ku ajo luftoi. Nëse dëmet e saj kanë qenë shumë më të vogla nga ato që i shkaktoi pushtuesit, kjo i detyrohet, ashtu si për gjithë Ushtrinë Nacionalçlirimtare, vijës së drejtë revolucionare të Partisë, mbështetjes së madhe morale e materiale të popullit, celulave të Partisë e të rinisë, komisarëve e zëvendëskomisarëve, qëndresës heroike të partizanëve dhe aftësisë drejtuese e manevruese të guximshme të kuadrove udhëheqës të brigadës, në krye të së cilës ishte shoku Teki Kolaneci, komandanti i saj.

Më 21 nëntor, partizanët e Brigadës XV Sulmuese i linin lamtumirën Elbasanit që skuqte i tëri nga flamujt kombëtarë. Atë ditë s'kishte mbetur njeri pa dalë për të përshëndetur çlirimtarët.

Më 28 Nëntor, ditën e shpalljes së pavarësisë kombëtare, në Tiranë hyri Qeveria Demokratike e Shqipërisë. Në këtë gëzim pa kufi mori pjesë edhe Brigada XV Sulmuese së bashku me Brigadat I, IV, VIII, X, XII që çliruan qytetin e Tiranës. Pas fjalimit historik të shokut Enver filloi parakalimi i reparteve të Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Partizanët ecnin me ballin lart, me hapin burrëror, me armët në krah dhe me gjerdanët në brez. Ata kalonin me fytyra të ashpra nga lufta, të regjura nga të ftohtit dhe me sytë të mbërthyer te tribuna. Nga të dyja anët shpërthenin duartrokitjet: «Rroftë Ushtria Nacionalçlirimtare!» «Lavdi Partisë Komu-

niste!». Kjo paradë kishte diçka emocionante e madhështore. Qytetarët e Tiranës, që kishin dëgjuar e ndjekur me ankth në zemër heroizmat e partizanëve dhe kishin parë me sy katastrofën gjermane gjatë 19 ditësh luftimesh të pareshtura e të përgjakshme për çlirimin e qytetit të tyre, kishin të drejtë të shfaqnin habinë për gjithë ato që shikonin më 28 Nëntor 1944.

Të nesërmen, nëpër rrugët e sheshet shpërthyen manifestime madhështore, se çlirimi i Shkodrës kishte mbyllur epopenë e lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare.

PASTHËNIE

Çdo njeri lë gjurma në jetë, lë pas një kujtim të mirë a të keq. Ky kujtim ruhet nga malet, nga gurët, nga lumenjtë e nga zerrrat e njerëzve. Koha nuk shlyen asgjë kur është fjala për një shok lufte, për një fytyrë që ka mbetur thellë në kujtesën e secilit, e shëndoshë, e pastër, krenare.

Sigurisht, të tillë shokë ka pasur shumë, por unë në këtë shkrim vë në dukje njërin prej tyre, një njeri të urtë, të sinqertë, një komunist të thjeshtë, të drejtë, pa pretendime, një komandant të fortë si shkëmbi, që, qysh në urdhrin e parë, filloi qëndresën si ushtar besnik i popullit dhe i Partisë.

U mundova të sillja ndër mend të gjitha ato që dija për shokun Teki Kolaneci, hollësitë më të vogla të karakterit dhe më doli se tipari më tërheqës i tij ishte pastërtia e shpirtit dhe mirësia e pafund. Ai vetëm të mirat u kujtonte njerëzve. S'mbante mëri dhe ishte nga ata që kurrë ndonjëherë nuk dëgjohej të bërtiste. Lëvizjet e fjalët e tija ishin të lidhura ngushtësisht me gjithçka që bënte.

Tekiu ishte ndër ata që dinte ta udhëhiqte luftën dhe ta çonte në fitore. Karakteristikat e tija më të shquara ishin aftësia për të kuptuar gjendjen dhe për të marrë vendime të drejta në çast, nuhatja e një

udhëheqësi që gjen menjëherë mjetin për të dalë nga çdo situatë e vështirë, këmbëngulja, kur ajo ishte e nevojshme, trimëria personale dhe vendosmëria e tij në luftë. Edhe në gjendje të jashtëzakonshme, ai ishte krejt i zakonshëm, i fortë si graniti, i palëkundshëm dhe nuk e humbiste as gjakftohtësinë e as sundimin e vetvetes. Prandaj të gjithë i drejtonin sytë tek ai, e dëgjonin me vëmendje dhe urdhri i tij zbatohet me gëzim.

Pas Çlirimit, Tekiu i rriti aftësitë e tija politiko-ushtarake dhe në të gjitha funksionet e rëndësishme komanduesë që pati: komandant divizioni, drejtor e zëvendësministër i punëve të brendshme, u tregua një udhëheqës e organizator i shquar për forcimin e modernizimin e ushtrisë. Tek ai zotëronte ndjenja e sakrificës, e vetëmohimit, ndjenja e interesave të popullit. Për aftësitë e meritat e tija, ai u zgjodh deputet në Kuvendin Popullor të RPSH që nga viti 1950.

Ky bir besnik i popullit dhe ushtar i vendosur i Partisë vdiq më 18 maj 1963. Në nekrologji, ndër të tjera, thuhet: «Me vdekjen e tij Partia humbi një nga militantët e saj të radhëve të para, ushtria një komandant të zotin e trim dhe populli një bir të tij besnik».

Tekiu vdiq. Po ndjenja e sakrificës, thjeshtësia, trimëria dhe qëndrimi i tij kurdoherë revolucionar e konsekuent ndaj atdheut, popullit, Partisë, do të vlejnjë si frymëzim edhe për brezat që do të vijnë.

Në prak të 30-vjetorit të Çlirimit të atdheut dhe triumfit të revolucionit popullor, Teki Kolanecit iu dha titulli i lartë «Hero i Popullit».

P E R M B A J T J A

	Faqe
Dy fjalë lexuesit	3
Shkëndijat e para	5
Çeta e parë partizane e Gorës	20
Çeta e Gorës në aksion	29
Shkëmbi i Bellovodës	45
Këshillat nacionalçlirimtare	51
Çlirimi i krahinës së Gorës	57
Veprimi i parë dhe i madh luftarak në Voskopojë ..	59
Një vit jetë në çetën e Gorës	78
Sulmi mbi Leskovikun	85
Takime me emisarët e «Ballit Kombëtar»	88
Lufta kundër garnizonit armik të Përmetit e të Kuçarit	90
Kapitullimi i Italisë fashiste	96
Riorganizimi i batalionit	99
Lufta e parë kundër «Ballit Kombëtar» në zonën Gorë-Opar	101
Goditja e postbllqeve dhe lufta në Kurtes	107
Guri i Kamjes	115
Operacioni i madh i Dimrit	123
Në ndihmë të popullit	141
Operacioni i Qershorit	147
Brigada XV Sulmuese	158
Pasthënie	179